

“Laboratori i debatit mbi integrimin europian në auditorët universitare”

Përmbledhje e artikujve në Rubrikën BLOG

Kjo renditje e artikujve të Rubrikës BLOG është përgatitur nga stafi i projektit SCiDEV. Renditja është kronologjike dhe jo preferenciale. Mendimet e shprehura në këtë rubrikë Blog janë të autorit/es të secilit artikull dhe nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e SCiDEV/skuadrës së projektit.

Tiranë, Korrik 2020

Projekti “Laboratori i debatit mbi integrimin europian në auditorët universitare”, u zbatuar nga Qendra Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim (SCiDEV) me mbështetjen e Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (OSFA) nga 21 tetor 2019 – 30 Qershor 2020 në Tiranë dhe Durrës.

TABELA E PËRMBAJTJES

<i>SCiDEV dhe komunikimi i kërkimit: Nisma e parë e debatit universitar</i>	7
Mar 4, 2020 Blog-Debati Blerjana Bino	7
<i>Opinionistë a debatues? Një sugjerim për studentët e mi.....</i>	9
Feb 20, 2020 Blog-Debati Nevila Xhindi	9
<i>Le të debatojmë në auditorët universitarë.....</i>	11
Mar 4, 2020 Blog-Debati Dorina Gjipali.....	11
<i>Debati si fuqizim i vetvetes, por vetëm për të mënçurit</i>	13
Mar 4, 2020 Blog-Debati Tea Hodaj	13
<i>Kultura e Debatit – Refleksione</i>	15
Mar 9, 2020 Blog-Debati Eurona Leka.....	15
<i>Debati mbi Integrimin European në auditor</i>	16
Mar 9, 2020 Blog-Debati Meljana Bregu	16
<i>Pse duhet të nxitët kultura e debatit në auditorët universitare.....</i>	18
Mar 9, 2020 Blog-Debati Doris Malaj (Koliqi).....	18
<i>Studentët dhe Debati.....</i>	19
Mar 9, 2020 Blog-Debati Eldian Balla	19
<i>Roli e rëndësia e debatit nën perspektivën e psikologut</i>	21
Mar 14, 2020 Blog-Debati Besmira Lahi.....	21
<i>Të debatosh Metodologjinë e re të Zgjerimit!</i>	23
Mar 14, 2020 Blog-Debati Lutjona Lula	23
<i>Debati studentor dhe mësimet e tij për punën në grup.....</i>	25
Mar 23, 2020 Blog-Debati Nevila Xhindi	25
<i>Pandemia COVID-19 dhe shkencat sociale.....</i>	27
Mar 23, 2020 Blog-Debati Blerjana Bino	27
<i>Debati Universitar për Integrimin dhe rikonceptimi i tij në kohën e koronavirusit.....</i>	29
Mar 23, 2020 Blog-Debati Esmeralda Shehaj.....	29

<i>Aftësitë debatuese, një vlerë e padiskutueshme për studentët</i>	<i>31</i>
Mar 24, 2020 Blog-Debati Petrina Broka.....	31
<i>Disa refleksione në situatë vetë-izolimi</i>	<i>33</i>
Mar 24, 2020 Blog-Debati Renis Bakalli.....	33
<i>Çelja e negociatave për Shqipërinë: Very good but too late my friends!.....</i>	<i>35</i>
Mar 24, 2020 Blog-Debati Klodiana Beshku.....	35
<i>Transformimi digjital i përshpejtuar nga pandemia COVID-19.....</i>	<i>37</i>
Mar 24, 2020 Blog-Debati Erjon Curraj.....	37
<i>Perspektiva e ndryshimit dhe e ardhmja jonë e përbashkët!.....</i>	<i>39</i>
Mar 25, 2020 Blog-Debati Elda Zotaj (Bushati)	39
<i>A po zhvillon aftësi që nuk do të robotizohen?.....</i>	<i>41</i>
Mar 25, 2020 Blog-Debati Përshtatur nga Liburnetik	41
<i>Po me arsimin çdo bëhet?</i>	<i>43</i>
Mar 25, 2020 Blog-Debati Nevila Xhindi	43
<i>Evropianizimi i Ballkanin Perëndimor: – Prespektivat që duhen konsideruar</i>	<i>45</i>
Mar 25, 2020 Blog-Debati Adela Danaj.....	45
<i>Korona Virus në përplasjen e Lindjes me Perëndimin</i>	<i>47</i>
Apr 1, 2020 Blog-Debati Marlin Muça	47
<i>Pak shpresë.....</i>	<i>49</i>
Apr 3, 2020 Blog-Debati Iris Beqiri.....	49
<i>Nacionalizmi dhe Covid-19.....</i>	<i>50</i>
Apr 3, 2020 Blog-Debati Erti Poka	50
<i>Një kthim pas te Shtet-Kombet.....</i>	<i>52</i>
Apr 5, 2020 Blog-Debati Marlin Muça	52
<i>Arsimi në kohërat e Covid-19.....</i>	<i>54</i>
Apr 5, 2020 Blog-Debati Skerdi Kruja.....	54
<i>Një vështrim drejt së ardhmes.....</i>	<i>57</i>
Apr 6, 2020 Blog-Debati Selmina Varfi	57
<i>Ku dallon Kina nga Shtetet e Bashkimit European në menaxhimin e Covid-19.....</i>	<i>60</i>
Apr 8, 2020 Blog-Debati Marlin Muça	60

<i>Distancimi social dhe sfidat me motivimin e studentëve</i>	<i>61</i>
Apr 8, 2020 Blog-Debati Blerjana Bino	61
<i>Studentët shqiptarë sot dhe parabola e së drejtës për arsim</i>	<i>64</i>
Apr 9, 2020 Blog-Debati Laura Skenderas	64
<i>NE jemi VIRUSI shkatërrues i Gjuhës Shqipe!.....</i>	<i>66</i>
Apr 9, 2020 Blog-Debati Ketii Sula.....	66
<i>Mendime rreth racionalitetit të pandemisë.....</i>	<i>69</i>
Apr 10, 2020 Blog-Debati Kriton Kuçi	69
<i>Një këmbanë alarmi ka rënë: Të rinjtë nuk lexojnë sa duhet, as në kohë pandemie.....</i>	<i>70</i>
Apr 12, 2020 Blog-Debati Klodiana Beshku	70
<i>Lufta me dy fronte COVID-19.....</i>	<i>72</i>
Apr 12, 2020 Blog-Debati Ana Lena.....	72
<i>Mundësitë që lindin për biznesin nga pandemia e COVID19.....</i>	<i>74</i>
Apr 12, 2020 Blog-Debati Erjon Curraj	74
<i>Përqasja e faktorëve të diamantit të Porterit në dimenionet e pasaportës tone europiane pas COVID19....</i>	<i>77</i>
Apr 14, 2020 Blog-Debati Av. Erinda Hyska	77
<i>Qasja mbi respektimin e të drejtave të njeriut përgjatë krizës së Koronavirus.....</i>	<i>79</i>
Apr 16, 2020 Blog-Debati Av. Megi Kurti	79
<i>Dobitë e ekonomisë së tregut në shoqërinë shqiptare.....</i>	<i>82</i>
Apr 16, 2020 Blog-Debati Renis Bakalli.....	82
<i>Kriza është EDHE një mundësi e re, mos e lër të ikë!.....</i>	<i>84</i>
Apr 16, 2020 Blog-Debati Nevila Xhindi.....	84
<i>Kriza e neoliberalizmit, sistemit të organizatave ndërkombëtare</i>	<i>86</i>
Apr 21, 2020 Blog-Debati Elvisa Qosja.....	86
<i>Demokracia vs Diktatura: Kush e përballoi më mirë Korona Virusin.....</i>	<i>87</i>
Apr 25, 2020 Blog-Debati Marlin Muça	87
<i>Shoqëria civile, zhvillimi dhe inovacioni.....</i>	<i>90</i>
Apr 25, 2020 Blog-Debati – Nevila Xhindi.....	90
<i>Çfarë llojë inovacioni na duhet për t'ia dalë mbanë në post-krizën COVID19?</i>	<i>91</i>
Apr 25, 2020 Blog-Debati Erjon Curraj	91

<i>Një “vaksinë” për infodeminë me tri pyetje bazike.....</i>	<i>93</i>
Apr 28, 2020 Blog-Debati Dren Gërguri.....	93
<i>Post-Recesioni fitohet nga ato kompani që dinë ta lexojnë mirë Recesionin.....</i>	<i>95</i>
May 18, 2020 Blog-Debati Erida Curraj.....	95
<i>Shën Bartolemeu i Teatrit.....</i>	<i>96</i>
May 18, 2020 Blog-Debati Marlin Muça.....	96
<i>Që zhvillimi i qytetit të mos barazohet me arbitraritetin.....</i>	<i>98</i>
May 20, 2020 Blog-Debati Blerjana Bino.....	98
<i>Fadromisti nga Astiri!.....</i>	<i>100</i>
May 20, 2020 Blog-Debati Nevila Xhindi.....	100
<i>“NE dhe SHQIPJA”.....</i>	<i>102</i>
Jun 3, 2020 Blog-Debati Erida Curraj.....	102
<i>“Të festojmë për sukseset dhe arritjet, të bashkohemi për kapërcimin e sfidave të vajzave dhe grave në Shqipëri”.....</i>	<i>103</i>
Jun 8, 2020 Blog-Debati Erida Curraj.....	103
<i>Projekti “Laboratori i debatit mbi integrimin europian në auditorët universitare – Roli i të rinjve”.....</i>	<i>106</i>
Jun 13, 2020 Blog-Debati Dorina Gjipali.....	106
<i>Disinformimi: Një virus pa kurë në epokën e post-së vërtetës?.....</i>	<i>109</i>
Jul 1, 2020 Blog-Debati Blerjana Bino.....	109
<i>Takimi virtual “Gratë në STEM”.....</i>	<i>112</i>
Jul 8, 2020 Blog-Debati, Teuta Xhindi.....	112
<i>Mësimet e nxjerra nga debatet universitare dhe disa rekomandime nga studentët.....</i>	<i>115</i>
Jul 26, 2020 Blog-Debati SCiDEV.....	115

SCiDEV dhe komunikimi i kërkimit: Nisma e parë e debatit universitar

| Mar 4, 2020 | Blog-Debati | Blerjana Bino

Nevoja për zhvillimin cilësor të arsimit të lartë në Shqipëri është tashmë e mirëpranuar nga të gjithë aktorët. Zhvillimi i aftësive analitike dhe kritike të studentëve e kërkuesve të rinj është pjesë përbërëse e objektivit përfundimtar për një arsim më cilësor. Kultura e debatit, etika e të debatuarit, analiza kritike, aftësitë kërkimore dhe prezantuese janë aftësi dhe kompetenca që u nevojiten studentëve dhe kërkuesve të rinj, jo vetëm në akademi por edhe përtej saj në përgatitje për tregun e punës. Programi i debatit universitar i mbështetur nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë dhe në zbatim nga Qendra “Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim” tashmë ka nisur të jap disa rezultate konkrete në universitetet tona. Natyrisht sfidat janë më të mëdha sesa mund të arrij të cek ky program pilot, megjithatë shfaqja e interesit të lartë si nga studentët/et dhe pedagogët/et është shenjë pozitive për të vazhduar më tej.

Krahas zhvillimit të aftësive analitike dhe kritike të studentëve e kërkuesve të rinj si edhe thellimit të njohurive rreth impaktit të integrimit europian në vend apo sfidave të Bashkimit European sot, ky program ka edhe një ndikim tjetër jo të drejtpërdrejtë, që lidhet me nevojën për të komunikuar kërkimin e pedagogëve apo kërkuesve përtej thjesht auditorëve dhe mjedisit akademik në tërësi. Ndaj projekti në fjalë lancon edhe blog-un si një platformë fillestare ku pedagogët mentorë të projektit, studentët, kërkuesit e rinj dhe të tjerë të interesuar mund të komunikojnë kërkimin e tyre në gjuhë të thjeshtë dhe lehtësisht të aksesueshme nga audienca të gjera përtej akademisë.

Një studim i realizuar nga autorja së bashku me disa kolegë të tjerë në 2017-2018 dhe mbështetur nga PERFORM, argumentonte se në një shoqëri të ndërlidhur dhe të orientuar kah inovacionit, komunikimi i kërkimit shkencor luan një rol thelbësor më shumë se kurrë më parë. Në ditët e sotme, komunikimi i kërkimit shkencor lehtësohet nga përhapja e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit si edhe nga parimet e demokratizimit dhe hapjes së shkencës. Kështu komunikimi i kërkimit është në interes të vetë sistemit të arsimit të lartë dhe shkencës, vendimmarrësve, sektorit privat, shoqërisë civile, medias dhe shoqërisë në tërësi.

Blerjana Bino dhe Irena Myzeqari, të cilat analizuan rastin e Shqipërisë, argumentojnë se komunikimi i shkencës në Shqipëri sikurse edhe në Ballkanin Perëndimor reflekton sfidat më të gjera që shkenca dhe kërkimi hasin. Së pari, komunikimi i shkencës nuk konsiderohet ende si një pjesë integrale e punës akademike. Si kërkuesit edhe institucionet kanë një kuptueshmëri të cunguar sa i takon komunikimit të shkencës, dimensioneve dhe mekanizmave të tij si edhe përfitimeve të mundshme. Studimi tregon që ende mbetet një qasje skeptike ndaj rolit të komunikimit të shkencës. Së dyti, komunikimi i kërkimit në shkencat sociale në Shqipëri e rajon nuk është i integruar me rrjetat më të gjera europiane apo botërore në këtë fushë – kufizime si gjuha apo madhësia e sektorit të shkencave sociale në këto vende. Së treti, sfidat e tjera shoqërore të sotme në Shqipëri ndikojnë gjithashtu edhe mënyrën sesi kuptohet apo realizohet komunikimi i shkencës. Disa nga format më bashkëkohore të komunikimit të shkencës si përmes mediave sociale, blogjeve apo aksesit të hapur në publikime janë ende në faza fillestare zhvillimi në Shqipëri.

Studimi në fjalë del në përfundimmin se komunikimi i kërkimit shkencor nuk është thjesht një prapashtesë e kërkimit: pa të, kërkimi shpesh injorohet dhe mbetet i skajuar. Në mënyrë të veçantë, që shkencat sociale të mbeten ende të vlefshme, është me rëndësi që rezultatet e kërkimit në shkencat sociale të kuptohen e vlerësohen nga kolegët në akademi, nga vendimarrësit, nga sektori privat dhe publiku i gjerë. Komunikimi efektiv i kërkimit nuk ka pse të mbetet ekskluzivitet i institucioneve të mirë-pajisuara dhe mirë-financuara, por në sajë edhe të medieve të reja mund të shërbejë për një impakt më të madh të shkencave sociale në shoqëri. Pikërisht duke kapitalizuar mbi mundësinë që ofron teknologjia, SCiDEV shpreson që ky blog të pasurohet edhe më tej, jo vetëm në kuadër të projektit të debatit universtar.

Opinionistë a debatues? Një sugjerim për studentët e mi

| Feb 20, 2020 | Blog-Debati | Nevila Xhindi

Prej vitesh lektore në auditorët e universiteteve shqiptare jam përpjekur që dija, fenomeni, ngjarja e ditës të debatohej nga studentët e mi jo vetëm si spektatorë, por si pjesëmarrës aktivë të shoqërisë ku jemi pjesë. Në mënyrë modeste jam përpjekur të krijoj në orën time të seminarit atë mikro-studion time të debatit dhe analizës me argumenta. Në fakt nuk ka qene aspak e lehtë, madje vazhdon të jetë e vështirë. Unë kam vënë re që studentët japin opinione, shpesh bazuar mbi ndjesi, tek tuk me ndonjë argument të përsëritur nga leksioni, e ndërsa u kërkon që të debatojnë, kupton që për ta debati është SFIDË, jo vetëm se modeli publik i tij në medime është pështjellues, ngatërrues, zhgënjyes, por mbi të gjitha sepse debati është veprimtaria që sjell artin e të lexuarit, të menduarit dhe të folurit së bashku, dhe kjo nuk është aspak e lehtë!

Për mijëvjeçarë, ligjet, aktet e luftës, vendimet e biznesit, mosmarrëveshjet martesore dhe hapësirat e lojërave janë zgjidhur përmes një lloji betejesh dhe marrëveshjeje verbale. Në Greqinë e lashtë debatet ishin një nga elementët më të rëndësishëm të demokracisë. Qytetarët e Athinës argumentonin për avantazhet dhe disavantazhet e ligjeve të tyre, studentët mësuan të argumentojnë dhe të analizojnë probleme nga këndvështrime të ndryshme për t'i kuptuar ato më mirë.

Dihet që civilizimi kinez kishte një histori të gjatë të përdorimit të debatit në politikën publike dhe jetën publike. Historiani Kuan Ch'en vuri në dukje mbi 1500 vjet më parë se në Kinë debatet konkurruese ishin të zakonshme në një formë të quajtur "Flasim Pastër". Në debatet e mesjetës në Evropë, kurset e të folurit ishin shumë të përhapura. Pastaj ato filluan të zhvillohen në sistemin arsimor. Kur studiuesit mesjetarë u përpoqën të krijojnë kurrikulën e universiteteve të para të botës, ata i konsideruan tre artet liberale thelbësore për lidhshëpin dhe promovimin e ideve më të mira: gramatikën, logjikën dhe retorikën (leximin, të menduarit, të folurit). Kur ata kërkuan të provonin thellësinë në të cilën ishin zhytur këto aftësi, universiteti mesjetar u kërkoi studentëve të marrin pjesë jo vetëm në provime me shkrim, por në ato me gojë, për të sjellë argumenta dhe për t'i mbrojtur ato – me fjalë të tjera, për të debatuar. Që nga senati romak deri në parlamentin britanik, debati është bërë mekanizmi i zgjedhjes për të vendosur rendin e gjërave.

Edhe pse shumë gjëra kanë ndryshuar në botë, studiuesit përherë e më shumë bien dakort që debati kërkon një grup aftësish që përkthehen drejtpërdrejt në dije akademike, sociale dhe profesionale. Ai zhvillon të menduarit krijues, zgjidhjen e problemeve, dëgjimin aktiv, analizën kritike dhe priorizimin, si dhe karakteristikat e karakterit si rezistenca, empatia dhe, më e rëndësishmja, besimi.

Përse u duhet studentëve tanë një program debati dhe përse duhet ta nxitim atë dhe jo thjesht opinione? Unë në mënyrë modeste nga përvoja ime në auditor dhe jashtë tij po rendis disa arsye:

Nga debati mëson shumë: Debatet janë të organizuara në atë mënyrë që të ndihmojnë të fitosh njohuritë dhe aftësitë që duhen për të qënë të suksesshëm në shoqërinë moderne demokratike. Ata fillimisht duhen konceptuar si një veprimtari që pasuron edukimin dhe në të njëjtën kohë jep kënaqësi.

Shkathtësitë e debatit janë thelbësore për jetën publike. Sot në shekullin XXI, aftësia për të krijuar, prezantuar dhe vlerësuar idetë mbetet thelbësore për demokracinë dhe shoqëritë moderne.

Programet e debateve janë përvoja transformuese për studentët. Në një program debati, studentët përfshihen vullnetarisht në një aktivitet shoqëror nga ku përfiton shumë intelektualisht dhe akademikisht: mendim i shpejtë, argument i shëndoshë dhe të folur me besim. Në shoqërinë tonë ka pak hapësira ku qëllimet intelektuale dhe sociale përputhen aq mirë për të edukuar një qytetar të ri. Mua më është dhënë rasti që nëpërmjet realizimit të projekteve të vogla universitare mbi debatin të vëzhgoj debate studentësh, dhe kam parë e ndjerë kënaqësinë tek shih e dëgjon qytetarët e rinj të këtij vendi që arsyetojnë, artikulojnë, dëgjojnë, përgjigjen dhe në fund të fundit respektojnë njëri-tjetrin...krejt ndryshe nga modeli që na shfaqet në mediumet publike.

Programet e debateve krijojnë udhëheqës. Drejtimi kërkon inteligjencë, vizion, empati, efikasitet dhe zgjidhje dhe ndershmëri, dhe pjesëmarrja në debat i kultivon këto aftësi thelbësore udhëheqëse tek të rinjtë. Në një botë në të cilën informacionet e pasakta dhe idetë e pajustificuara janë të bollshme, debati krijon një lloj udhëheqësie të sigurt që mund ta drejtojnë mendimin publik drejt vendimeve inovative, morale dhe zhvilluese.

Aftësia për të konceptuar, artikuluar dhe vlerësuar argumentet mbetet jo vetëm gjaku dhe jeta e demokracisë në një shoqëri, por është thelbësore për zhvillimin e një individi të angazhuar public dhe etik që jeton në shoqërinë moderne, teknologjike, demokratike. Si rrjedhojë logjike do të dëshëroja që në universitetet tona të promovohet fort debati konkurrues, si një element i përhershëm në kalendarët extra-kurrikularë. Shpesh shkollat më të mira krijojnë debatuesit më të mirë dhe anasjelltas, shpesh debatuesit më të mirë janë studentët më të mirë – jo vetëm për sa i përket rezultateve akademike, por edhe në angazhimin e tyre në shoqëri. Janë pikërisht këto arsye të cilat na bënë të jemi pjesë e projektit ‘Laboratori i Debatit mbi Integrimin Europian në Auditorët Universitarë’, zbatuar nga Qendra Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim dhe financuar nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë.

Le të debatojmë në auditorët universitarë

| Mar 4, 2020 | Blog-Debati | Dorina Gjipali

Në një shoqëri, ku ne dëshpërimisht kemi nevojë për debat të shëndetshëm për të sfiduar opinionet me argumenta dhe fakte, nuk ka model më të mirë për të rinjtë, sesa debati brenda auditorit universitar. Sot studentët janë të ekspozuar ndaj lajmeve dhe opinioneve në kohë reale në mediat sociale, ndaj opinioneve të prindërve të tyre, të pedagogëve e të moshatarëve të tyre, prandaj debati u ofron mundësinë të ngrenë pyetje dhe të sfidojnë opinionet e njerëzve që i rrethojnë.

Ndërkohë që një pjesë e mirë e njohurive të marra në leksione janë koncepte abstrakte, debati sjell tematika, ngjarje dhe problematika reale brenda auditorëve universitarë. Debati, si instrument edukues e revolucionalizon mësimdhënien dhe mësimnxënien, rrit mendimin kritik dhe vendimmarrjen si dhe vetbesimin tek studentët.

Debatet si një instrument mësimdhënie gjurmohen në Greqinë e lashtë, me Sofistët, Protagoras dhe Aristotelin^[i], si pionierët më të hershëm, sot, debatet ekzistojnë në forma të panumërta në çdo shoqëri, duke filluar nga debatet e qeverisë, proceset gjyqësore, deri te debatet në media, ku individët paraqesin pikëpamje të kundërta përmes ndërveprimit shoqëror. Strategjitë dhe metodologjitë e mësimdhënies kanë evoluar me kalimin e kohës sipas nevojave të studentëve dhe ndryshimit të mjedisit universitar.

Si një metodë mësimdhënie, debati përfshin studentët në shprehjen e mendimeve të tyre nga dy këndvështrime konkurruese me qëllim kundërshtimin e argumenteve të njëri-tjetrit. Hulumtimi dhe praktika na tregojnë për debate efektive në formate të ndryshme për qëllime edukuese. Shembujt e debateve universitarë përfshijnë ndarjen e studentëve në grupe kundërshtarë që paraqesin me radhë ose diskutojnë në një formë të strukturuar, si dhe simulimin e proceseve gjyqësore.

Një debat që shërben për mësimdhënie dhe mësimnxënie efektive duhet të përfshijë katër komponentë konceptual: (a) zhvillimin e ideve me përshkrim, shpjegim dhe demonstrim, (b) përplasje mendimesh të mbështetura nga arsye dhe prova, (c) shtrirje ose argumente kundër kritikave, të cilat përsëri kundërshtohen nga kundërshtari, dhe (d) perspektiva, bëhet procesi i peshimit të ideve dhe çështjeve për të përfunduar me një vendim logjik, qoftë për çështjen, ose për prezantimin e argumenteve.^[ii]

Në auditorët universitarë është kaq i domosdoshëm debati i strukturuar, me rregulla, etikë komunikimi, ku forcën e ka fjala, ku fiton argumenti. Ky instrument i rëndësishëm, kurrikular apo ekstrakurrikular, inkurajon studentët të thellohen në studim, të mendojnë e të analizojnë më shumë, të fitojnë besim tek vetja, të komunikojnë më mirë në publik etj. Debati, gjithashtu lehtëson pjesëmarrjen verbale në auditor, me të cilën studentët hasin vështirësi, përfshin më shumë studentët në auditor. Në planin afatgjatë, debati ndihmon studentët të fitojnë aftësi dhe vlerësim kritik kur paraqitet një temë komplekse.

Puna më e vështirë për tu realizuar në auditorët universitarë është të menduarit kritik. Një student mund të mbarojë tërësisht studimet universitare pa menduar asnjëherë në mënyrë kritike, pa prodhuar asnjë

mendim original. Sepse të menduarit kritik, konsiston në kërkimin e linjave e rrymave të reja të mendimit, të reja për studentin, jo domosdoshmërisht të reja për të gjithë shoqërinë. Shumë ish debatues, ndoshta sot lidera, drejtues të lartë e akademikë ia atribuojnë aftësitë e tyre të të folurit publik, leximit dhe debatit. Sepse debati, përmirëson ndjeshëm aftësitë e të menduarit kritik, arsyetimit, të komunikimit dhe analitikës para audiencës së madhe, aftësi me të cilat studentët duhet të pajisen gjatë studimeve universitare.

Më shumë sesa thjesht argumentim, debati, jo vetëm që rrit akademikisht dhe intelektualisht studentin, por përbën një platform ku studenti mëson si të prezantojë më së miri veten duke u projektuar në të ardhmen kur do ti duhet të prezantohet e të bind punëdhënësin për aftësitë e tij. Prandaj debati duhet të jetë pjesë e auditoreve universitare, në mënyrë që të zbusi hendekun midis jetës akademike dhe botës së jashtme. Të rinjtë që synojnë të hyjnë në tregun e punës sot, duhet të jenë në gjendje të komunikojnë me qartësi, të artikulojnë ide, të arsyetojnë, të ndajnë faktet nga opinionet.

Asnjë veprimtari akademike apo formë mësimdhënëse, e vetme, nuk mund ta realizojë sa më sipër më mirë sesa debati – aftësia për të menduar, për të formuluar përfundime me shpejtësi, për t’u përgjigjur pyetjeve në mënyrë logjike dhe me qartësi, për të përmbledhur idetë, të gjitha procese që zhvillojnë individin.[iii] Studiuesit, pohojnë se debatet krijojnë lidera. liderat e mëdhenj publik, si Martin Luther King, dikur debatues të aftë në shkollat e tyre, janë bërë të tillë duke formuluar opinionin publik jo duke e diktuar atë.

Le të debatojmë në auditorët universitarë, le të jetë debati pjesë e veprimtarive kurrikulare dhe ekstrakurrikulare në universitetet tona si dhe një strategji mësimdhënie aktive dhe efektive për të motivuar studentët. Le të jetë kjo nismë e SCIDEV një ogur i mirë e të pasohet nga shumë nisma për debate të tjera brenda dhe jashtë auditorëve tanë.

[i] Vo, H. X., & Morris, R. L. (2006). Debate as a tool in teaching economics: Rationale, technique, and some evidence. *Journal of Education for Business*, 81(6), 315-320. Snider, A., & Schnurer, M. (Eds.). (2002). Many sides: debate across the curriculum. IDEA

[ii] Snider, A., & Schnurer, M. (Eds.). (2002). Many sides: debate across the curriculum. IDEA.

[iii] Kennedy, R. R. (2009). The power of in-class debates. *Active Learning in Higher Education*, 10(3), 225-236.

Debati si fuqizim i vetvetes, por vetëm për të mënçurit

| Mar 4, 2020 | Blog-Debati | Tea Hodaj

Së pari, gjej rastin të uroj çdo student për përzgjedhjen dhe pjesëmarrjen në debatin universitar për integrimin të organizuar nga SCiDEV me mbështetjen e Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë. Uroj që kjo platformë të jetë e frytshme për ju, për ne dhe për këdo që ka bërë të mundur këtë bashkësi!

Ka ardhur koha të debatojmë dhe të flasim për debatin. Le të largohemi pakëz nga teoritë, përkufizimet, historikun dhe le t'i afrohemi përditshmërisë sonë. Kjo pasi duhet të kuptojmë se përse ne flasim, ndajmë mendime dhe debatojmë. Duke dashur t'i shkojmë sa më afër të përditshmes, detyra jonë më e vështirë do të jetë mos prekja me 'të shëmtuarën e bashkëbisedimit'. Prandaj, në momentin që do të përbalim këtë 'të shëmtuar', do të tërhiqemi dhe do ta shqyrtojmë nga larg.

Arti i të folurit dhe ai i të debatuarit në mënyre të saktë mbeten virtyte të pakëta në shoqëri. Qëndrojnë larg arsimit bazë, sferës politike, programeve mediatike, fqinjësisë e kështu me rradhë. Me keqardhje le të pranojmë pa humbur kohë se 'e shëmtuara e bashkëbisedimit' mbizotëron dhe domosdoshmëria e përditshmërisë na afron me të. Rrjedhimisht, debati rëndom përdoret si përleshje e mendimeve të kundërta në një formë të pastrukturuar dhe jo të frytshme. Njerëzit debatojnë duke humbur energjinë pozitive, e kështu tejmbushen me atë negative. Mund të themi se, një debat i shkuar keq ngjason me çfarë Hobbes do të përshkruantë si 'njerëzore', dhe Hobbes hiperbolizonte anët negative të njeriut. Por siç e kam thënë dhe më parë, le të mos humbasim shumë kohë me të 'shëmtuarën' dhe le të kalojmë te ajo çfarë është shkruar në titull.

Duhet të jesh i/e mënçur që të vlerësosh debatin në thelbin e tij. Për më tepër, duhet të jesh akoma më i/e mënçur që të gjëmosh pas një debati të mirë e të vlefshëm. Një njeri i mënçur kupton se debati të ndihmon t'ç vetëkontrollosh mendimet; të ndash të vërtetën nga e gabuara; të zëvendësosh mendime që prej kohësh i dije të sakta, por dikush sapo të provoi të kundërtën; të pasurosh dije kur mendon se di gjithçka dhe mbi të gjitha, të mirëpresësh mendimet dukshëm të gabuara pa mëndjengushtësi.

Debati është rregullator i brendshëm jo vetëm i vetëkontrollit, por ai shërben si një filtrim dhe rafinim i të menduarit kritik. Dikush duhet të jetë në kërkim të vetëpërsosmërisë që të gjëmojë pas një debati të mirë. Jo vetëm kaq, debati është shenjues i një kulture të përgjithshme: të mos të nënvlerësuarit, të mos të të poshtëruarit dhe të mos të të ofenduarit.

Një njeri i fuqishëm punon në kanalizimin e mendimit të tij. Duhet punë e vazhdueshme dhe përplasje me mendime të ndryshme që kanalet e të menduarit të drejtohen nga 'perfeksioni'. Por do të ishte e kundërta e mëncurisë nëse mendon se 'mendimi perfekt/absolut' ekziston, kjo do të shkatërronte çdo urë lidhëse. Debati kthehet në 'armë' të fuqishme kur pranon se mendimi yt është i pasaktë, jo i vërtetë ose i pavlefshëm. Në këtë mënyrë, debati të shërben si sfungjer thithës ndaj një larmishmërie të pafundme informacioni dhe idesh. Këtu duhet patjetër etja për të mësuar e zbuluar. Shpesh kam përsëritur dhe do vazhdoj ta bëj në këto



faza përgatitore se, hapi i parë është vetëidentifikimi i pikave tona të forta dhe atyre të dobëta. Kjo do të na sjelli siguri diku dhe entuziasëm për të mësuar diku tjetër.

Edhe njëherë, uroj që gjithësecili t'a shijojë pjesëmarrjen sa më shumë!

Kultura e Debatit – Refleksione

| Mar 9, 2020 | Blog-Debati | Eurona Leka

Një projekt për të rinjtë me synim forcimin e kulturës së debatit është i një rëndësie të veçantë në funksion të zhvillimit të të gjithë shoqërisë në tërësi.

Ne kemi nevojë për të krijuar një kulturë të diskutimeve dhe debateve të shëndetshme. Është e trishtueshme që bisedat tona normale shndërrohen në një zënkë, e lëre më debate.

Një nga shkaqet kryesore të kësaj rënije është mos interesimi ynë për të ndjekur të vërtetën. Ne kemi humbur kulturën e të lexuarit dhe të kuptuarit të ideve të reja dhe më keq akoma kemi humbur zakonet e leximit. Askush nuk lexon libra, veçanërisht ato që janë në kundërshtim me idetë e paracaktuara të dikujt, pasi i duhet guxim të përballlet me një ligjërim alternativ.

Ne, si shoqëri, duhet të mësojmë se të ndash pikëpamje të ndryshme ose të mos pajtohesh me dikë tjetër nuk është diçka që të ndjehemi të mërzitur, përkundrazi është një rrugë përpara. Ndjekja e të tjerëve është e lehtë, por ajo që ka rëndësi është se sa mendim kritik po aplikojmë. Filozofi britanik Keith Ward thotë: “Sa më i arsyeshëm të jesh, aq më shumë nuk pajtohesh me askënd tjetër”.

Unë mendoj se është mirë të jetosh në një mjedis ku njerëzit nuk pajtohen me ty. Ata njerëz ju ndihmojnë të rivlerësoni qëndrimin tuaj për një ide të caktuar dhe kjo do t’ju mësojë shumë gjëra të reja. Edhe ju do t’i shikoni nga afër provat përsëri dhe përsëri dhe ato do t’ju tërheqin mendimet për anën tjetër të ideve. Dhe nëse ka prova të kundërta me atë që besoni, atëherë unë mendoj se është më mirë të ndryshoni mendje, sepse nuk është mirë të jetoni një jetë të mashtruar.

Nevojitet një kulturë e edukuar e debateve, ku gjërat gjykohen në bazë të informacionit dhe dëshmive përkatëse sesa paragjyqimeve tona personale. Ne duhet të bëjmë dallimin midis njerëzve dhe ideve. Të flasim për njerëzit dhe të flasim për ide janë dy gjëra të ndryshme; idetë nuk janë kurrë të shenjta dhe asnjë ide nuk është immune ndaj ekzaminimit.

Merrni këtë këshillë të Ralph Waldo Emerson, “Më lejoni të mos biem kurrë në gabimin vulgar, kur ëndërroj se jam i përndjekur sa herë që jam në kundërshtim.”

Debati mbi Integrimin European në auditor

| Mar 9, 2020 | Blog-Debati | Meljana Bregu

Proçesi i integritimit është shumë i debatuar në auditorët shqiptare por studentët në përgjithësi nuk debatojnë rreth fakteve por mbi opinione personale ose opinione të dëgjura në media. Vështirësia e një debati të strukturuar varet nga disa faktorë por mbi të gjitha kultura e debatit në Shqipëri është e mangët në auditoret universitare ashtu si dhe në shoqëri. Në media transmetohen vazhdimisht formate ku nuk respektohet e drejta e tjetrit për të folur, ku argumenti zëvendësohet me ulërime ose sulme personale si dhe asnjë temë nuk shtjellohet duke i lënë vëndin në fund, një pështjellimi akoma më të madh se në fillim. Në këtë panoramë nuk bëjnë përjashtim as auditoret universitare jo vetëm në Shqipëri, jashtë botës anglo-saksone ku debati është më i përdorur studentët kanë vështirësi për të debatuar duke ndjekur rregulla të caktuara.

Mungesa e kulturës së debatit e shoqëruar edhe me temëm e ndjeshme mbi të cilën debatohet e bën të vështirë zhvillimin e një ore konstruktive debati në auditor. Proçesi i integritimit të Shqipërisë është një temë delicate e cila trajtohet nga disa këndvështrime por organizimi i debatit mbi integrimin është një sfidë. Shpesh herë orët e debatit mbi vështirësitë e integritimit të shoqërisë shqiptare në BE transformohen në opinione personale të mbushura me ankesa kundrejt BE ose anasjelltas, me ankesa kundrejt klasës politike por edhe vetë shoqërisë. Në këtë mënyrë debati konstruktiv është shumë i vështirë për tu organizuar duke i lënë vënd diskutimit mbi perceptimet dhe jo mbi faktet.

Për këto arsye pjesëmarrja në projektin ‘Laboratori i Debatit mbi Integrimin European në Auditorët Universitare’, zbatuar nga Qendra Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim dhe financiar nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë ishte një hap pozitiv në ndryshimin e perceptimit të debatit por edhe mënyrës së të debatuarit në universitet. Më habiti entuziasmi i studentëve për të marrë pjesë në projektin në fjalë dhe dëshira e tyre për të eksperimentuar këtë sfidë të re.

Por, që në takimet e para përgatitore doli në pah mungesa e kulturës së debatit dhe vështirësia e tyre për të ndjekur rregulla të mirë përcaktuara të cilat e bëjnë konstruktive eksperiencën në fjalë. Me kalimin e kohës studentët filluan të kuptojnë rëndësinë e respektit të interlokutorit në debat, mbi të gjitha u mësuan të dëgjojnë argumentat e tjetrit dhe të strukturojnë përgjigjen e tyre mbi fakte dhe jo opinione personale duke nxitur mendimin kritik. Në këtë mënyrë ata u përfshinë edhe më shumë në projekt duke mësuar tashmë jo vetëm fakte të reja mbi integrimin por mbi të gjitha mbi mënyrën e të debatuarit.

Mendoj se debati si mënyrë didaktike duhet stimuluar gjatë gjithë ciklit të studimeve sepse ndihmon studentët në karrierën dhe në të ardhmen e tyre. Sot tregu i punës nuk vlerëson vetëm aftësitë individuale por edhe bashkëpunimin dhe punën në grup. Debati nxit bashkëpunimin gjatë përgatitjes së temës dhe gjatë parashtrimit të saj duke forcuar aftësinë e studentëve për të punuar në grup dhe ballafaquar me sfidat që ajo krijon.

Debati nxit vëmendjen ndaj tjetrit. Bota e sotme me zhvillimin e teknologjisë dhe rrjeteve sociale të komunikimit ka krijuar një deficit vëmendjeje, lajmet janë të shpejta dhe të shkurtra, thjesht shkëmbehen mendime por mungon kurioziteti për të dëgjuar dhe kuptuar mendimin e tjetrit. Format i debatit varet

eskluzivisht në vëmendja kundrejt skuadrës kundërshtare dhe në argumentat e paraqitura prej tyre, duke bërë studentët të ndalen tek mendimi i tjetrit ta kuptojnë dhe respektojnë atë.

Por mbi të gjitha studimi i argumentit i bën studentët më të përgatitur të kuptojnë këndvështrime dhe fakte të tjera, të zgjerojnë horizontet e tyre përtej librave të detyruara në auditore dhe lajmeve të shpejta të ndara në media dhe rrjete sociale.

Mundësia e shprehjes së mendimit në çdo moment dhe mbi çdo tematike në rrjetet sociale duke u fshehur mbrapa tastierës na ka bërë më të papërgjegjshëm ndaj komunikimit të perceptimeve tona mbi botën. Formati i debatit i dha mundësinë studentëve të reflektojnë më shumë mbi mënyrën sesi shprehin opinionin e tyre mbi integrimin dhe faktet ku bazohet ai. Njëkohësisht, nëpërmjet debatit studentët kanë filluar të kenë më shumë besim tek vetja dhe tek aftësitë e tyre për të folur në publik.

Për këto arsye projekti i debatit në auditorët universitare mbi procesin e integrimit duhet të nxitet dhe vlerësohet për impaktin pozitiv që mbi studentët dhe karrierën e tyre.

Pse duhet të nxitët kultura e debatit në auditorët universitare

| Mar 9, 2020 | Blog-Debati | Doris Malaj (Koliqi)

Sepse ne, si shoqëri, duhet të jemi të vetëdijshëm se është pikërisht elementi publik, elementi jetik i demokracive moderne, liberale dhe funksionale. Përballja me ndryshimin e formave të komunikimit, por edhe rritja e tendencave populiste në debatin politik vendos në pikëpyetje këtë element kaq të rëndësishëm.

Gjendemi përpara një situatë aspak të këndshme ku kultura e debatit publik po ndryshon: gjithnjë e më shumë pozicione nuk diskutohen më, por njerëzit sulmohen verbalisht. Me sa duket, koncepti i mendimit është bërë i paqartë. Ne duhet të mesojmë të zhvillojmë aftësinë kritike, të debatojmë dhe të lejojmë edhe mendimin dhe argumentin ndryshe. Gjej rastin të citoj moralistin francez Joseph Joubert, i cili shprehej se “Është më mirë të debatosh për një çështje pa e zgjidhur atë sesa të zgjidhësh një çështje pa e debatuar atë.”

Është debati i shëndoshë dhe i mirëfilltë ai që promovon një kulturë të gjallë të fjalës dhe argumentit – baza e çdo shoqërie demokratike dhe pluraliste. Një folës jo vetëm që duhet të përcjellë pozicionin e tij në një mënyrë të besueshme, ai gjithashtu duhet të bindë me argumente dhe, së fundi, por jo më pak e rëndësishme, të arrijë dëgjuesit duke i ofruar alternativa në bazë të një mendimi analitik dhe pse jo dhe kritik.

Këto aftësi të një folësi mund të praktikohen në kontekstin e debatit, i cili zhvillohet në kuadër të projektit ‘Laboratori i Debatit mbi Integrimin European në Auditorët Universitarë’, zbatuar nga Qendra Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim dhe financuar nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, pasi skuadrat gjithashtu shqyrtojnë pyetje dhe pozicione të panjohura.

Është shumë e rëndësishme që studentet – por jo vetëm – të dëgjojnë me kujdes argumentet e palës tjetër dhe të kundërpërgjigjen në mënyrën e duhur. Pra, aftësohen jo vetëm në zhvillimin analitik dhe kritik, por edhe në atë retorik. Sikundër duhet të theksohet se kultura e debatit nxit edhe një element tjetër shumë të rëndësishëm që është: aftësia për ta marrë seriozisht personin, mendimin ose argumentin tjetër. Duhet të nxitet akoma më shumë kultura e debatit, sidomos në auditorët universitare pasi, diskutimet rreth ndryshimit në kulturën e gjuhës dhe debatet në hapësirën publike çojnë gjithashtu në një kuptim më të thellë të konceptit të mendimit. Aktualisht, përshtypja është e qartë se çdo deklaratë në të ashtuquajturën media sociale – interpretohet si shprehje e mendimit. Në përgjigje të kësaj, atëherë kërkohet t’i referohemi fakteve të qarta për të hedhur poshtë mendimet subjektive.

Ka disa keqkuptime prapa një argumenti të tillë: Opinione nuk janë thjesht subjektive në kuptimin që ato janë arbitrare. Përmes opinioneve ne pozicionohemi. Me mendime, njerëzit fitojnë qasje në një botë të ndarë në të cilën mendimet e tjera janë gjithmonë të mundshme. Kjo do të thotë jo vetëm që opinionet janë të orientuara drejt gjuhës, por që ato kuptohen si deklaratë në një botë të ndarë, gjithmonë lejojnë deklaratë të tjera dhe – ndonjëherë – edhe i kërkojnë ato. Përkundër kësaj, shprehja e formimit të opinionit merr një aspekt krejt të ri që është i rëndësishëm për ndryshimin në kulturën e debatit. Nuk nënkuptohet më thjeshtë aftësia për të shprehur një mendim, qoftë edhe në pasiguri të plotë, por për më tepër aftësia për të pranuar mendimin ndryshe. Kjo përfshin maturi, zgjuarsi dhe takt dhe auditori universitar është një vend për të praktikuar këto karakteristika të një qytetari analitik, kritik, tolerant dhe demokraci-dashës.

Studentët dhe Debati

| Mar 9, 2020 | Blog-Debati | Eldian Balla

Në përditshmërinë tonë në ambiente familjare, shoqërore dhe pune, komunikimi është mjeti kryesor ku individët shkëmbejnë mendime, informacione dhe opinione mbi çështje të ndryshme. Shpesh herë na ndodh që të ndjekim median televizive me interes, por edhe të ndërrojmë kanal për emisione që përmbajnë debat në formatin e tyre sepse, menyra sesi zhvillohen dhe trajtohen debatet nuk na pëlqejnë. Kjo na bën të reflektojmë që për të qënë tërheqës, interesant dhe bindës në komunikim me njëri-tjetrin duhet të shmangim disa aspekte sjelljeje, mënyre komunikimi dhe qëndrimesh jo të duhura në debate. Në një debat e rëndësishme është që palët të bazohen në argumente dhe në prova. Kur kritikant apo sygjerimet të bëhen me këto dy mjete, atëherë debati është produktiv dhe shërben në përmirësimin dhe zgjidhjen e problemeve.

Përgjatë periudhës sime akademike më ndodh që për arsye të ndryshme të vizitoj ambientet e universitetit ku kam studiuar, çdo auditor që përshkon të rikthehen copëza kujtese të jetës studentore. Shpeshherë diskutimet me bashkë-studentët dhe lektorët transformoheshin në debate. Të qënit lektor në auditorët e universitetit është njëkohësisht kënaqësi dhe sfidë. Në situata të caktuara ndodh që për diskutime mbi tematika të ndryshme në leksion dhe seminare të diskutohet mbi koncepte dhe situata të shumëllojshme me studentët. Në këtë moment është e domosdoshme të pozicionohesh në rolin e moderatorit sepse, do të duhet që mendimet, opinionet dhe argumentat e shprehura të studentëve të mbrohen (qoftë dhe jo të duhurat), por edhe të mbash rregull sepse diskutimi kthehet në debat midis studentëve.

Nese kthehem pas në kohë, debati në forma të ndryshme ka një histori të gjatë dhe mund të gjurmohet në debatet filozofike dhe politike të Greqisë antike, siç janë demokracia atheniane, Shastrartha në Indinë e Lashtë. Format moderne të debatit dhe krijimit të shoqërive debatuese ndodhën gjatë Epokës së Iluminizmi në shekullin e 18-të.

Këtë vit Universiteti “Aleksandër Moisiu” është pjesë e projektit “Laboratori i debatit mbi integrimin European në Auditorët Universitar, mbështetur nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë dhe SCIDEV, ku në Fakultetin e Biznesit janë perzgjedhur 8 studentë, të ndarë në 2 skuadra (pro dhe kundër) të cilat do të jenë pjesë e një debati mbi tematika në lidhje me Integrimin European të Shqipërisë. Ky projekt synon të përforcojë njohuritë dhe zhvillojë analizën kritike të studentëve dhe kërkuesve të rinj lidhur me Integrimin European, si dhe të rigjenerojë kulturën e debatit në universitetet shqipëtare. Të qënit në rolin e trajnuesit të 2 skuadrave mbi këtë debat formal duhet që studentët të kenë të qartë disa aspekte kryesore ku mbështet dhe zhvillohet një debat.

Debati është një konkurs zyrtar i argumentimit midis dy skuadrave ose individëve dhe është një mjet thelbësor për zhvillimin dhe ruajtjen e demokracisë në shoqëritë e hapura. Më shumë se një aftësi thjesht verbale ose e performancës, debati mishëron idealet e argumentit të arsyetuar, tolerancën për pikëpamjet divergjente dhe vetë-ekzaminimin rigoroz. Debati, është një mënyrë për ata që kanë pikëpamje të kundërta për të diskutuar çështje polemike pa u zhvendosur në fyerje, thirrje emocionale ose paragjykime personale. Një veçori kryesore e debatit është se ajo rrallë përfundon në marrëveshje, por më tepër lejon një analizë të fortë të çështjes në fjalë.

Ndoshta kjo është ajo që filozofi francez “Joseph Joubert” nënkuptoi kur tha: “është më mirë të debatosh për një pyetje pa e zgjidhur atë, sesa të zgjidhësh një pyetje pa e debatuar atë”.

Një debat, brenda një formati të caktuar, nis me rezolutën ose temën që është një pohim i thjeshtë dhe i qartë që përkufizon se mbi çfarë do të argumentojnë të dy palët në debat. Çdo skuadër, ajo pro dhe ajo kundra, përpiqen të bindin një gjykatës neutral se pozicioni të cilin ata mbajnë në lidhje me temën është i drejtë. Skuadrat gjithë këtë e bëjnë duke ndërtuar argumentet e tyre pro temës së dhënë dhe duke hedhur poshtë argumentet e skuadrës kundërshtare.

Karakteristika kryesore në një debat formal, është se ai përmban rregulla të cilat inkurajojnë përballjen midis dy skuadrave me anë të argumenteve, arsytimeve logjike dhe evidencave. Nuk është e mjaftueshme që të dy palët të paraqesin fjalimet e tyre. Secila prej tyre në kohë të barabarta duhet t’i përgjigjet direkt argumenteve të skuadrës kundërshtare, të krahasojnë pozicionet përkatëse në lidhje me mocionin, në fund të fundit t’i japin gjykatësve një arsye për të votuar pro pozicionit që ata mbajnë, qoftë ky pro apo kundër temës të dhënë për debat.

Zbatimi i këtij projekti në universitetet shqiptare është në kohën e duhur meqenëse Shqipëria është vend kandidat për të iu bashkuar familjes Europiane dhe trajtimi me studentët i këtij procesi në auditoret universitare nëpërmjet debatit është mënyra e duhur që bashkarisht të ndajmë qëndrimet pro dhe kundra.

Roli e rëndësia e debatit nën perspektivën e psikologut

| Mar 14, 2020 | Blog-Debati | Besmira Lahi

Njohja me debatin përbën një përvojë unike në jetën e një të riu: rrugë të reja që hapen e kryqëzohen me njera tjetrën, njerëz që takohen dhe rrjet miqësor e profesional që do të të ndjekë gjithë jetën e për më tepër një përvojë të nxëniet, e vështirë të përftohet në mënyra të tjera. Po si është e mundur? Në përpjekje e sipër për të qenë objektive duke lënë mënjanë arsyen se ‘debati kontribuoi në njeriun që jam sot’, perspektiva ime mbi debatin paraqitet në këndvështrimin e një pedagogu e psikologu ku marrëdhënia mes mendjes e sjelljes përbën thelbin e trajtimit. Si e tillë, parashtrij tezën se “Debati rrit vetëbesimin duke sfiduar njohjen dhe nxitur zhvillimin personal” përmes argumentave të mëposhtëm:

Së pari: Debati përbën një mundësi për të njohur identitetin personal prej debatuesi, mënyrën se si reagon individi kur përballet me këndvështrimet e jashtëgrupit që paraqet e mbron ide të kundërta duke tronditur themelet e të kuptuarit “cila është mënyra më e mirë për të reaguar e vepruar?” Si i tillë debatuesi dhe kujdeset për të respektuar diversitetin e mendimit krahas diversitetit kulturor njerëzor. Komunikimi brenda grupit intensifikohet me qëllim rritjen e identitetit social, identitetit të grupit dhe më pas debatuesi merr rolin (ku ndërthuren një seri besimesh dhe pritshmëri) duke paraqitur mendimin e qasur në grup me zë dhe njëherazi duke u ndjerë pjesëmarrës i një lëvizje të fuqishme për ndryshim.

Npërmjet eksplorimit e njohjes së pozicionit që debatuesit do të mbajnë përgjatë minutave të debatit, ato arrijnë të njohin më shumë rreth vehtes së tyre, e cila pavarësisht lehtësisë së fjalës përbën një gjurmë të kompleksitetit njerëzor e dokumentuar që në kohët e lashta Sokratike ku citohej se “të njohësh vehten është fillimi i njohjes”.

Së dyti: Debati nxit zhvillimin personal përmes stimulimit të aftësive të buta (soft-skills) duke ndikuar në mendimin kritik, aftësitë e komunikimit e uljen e ankthit të ligjërimin në publik, zgjidhjen e problemeve, negociimin dhe vendim-marrjen në grup, aftësi të domosdoshme për tregun e punës vendas e global.

Debati është një përvojë të nxëniet për secilin që bëhet pjesë e tij dhe përbën një mendjehaptësi për të gjithë edukatorët, instruktorët e mësimdhënësit meqenëse nxit kuriozitetin prej kërkuesi duke nisur nga mbledhja e të dhënave empirike, konceptimi i teorisë, gjetja e metodave, konkluzionet e më pas komunikimin e gjetjeve para publikut duke përfaqësuar hapat e mirëfillta të një kërkimi shkencor.

Për të kuptuar impaktin e debatit si një teknikë e përdorur gjatë procesit të mësimdhënies janë ndërmarrë një seri kërkimesh me natyrë kuazi-eksperimentale me matje para e pas përdorimit të teknikës së debatit. Kështu, një studim i vitit 2017 i ndërmarrë në Indonezi tregoi se vërehet një përmirësim i ndjeshëm i aftësive të të menduarit kritik si dhe aftësive të të folurit në përgjithësi, si në vijim: “rrijdhshëmrisë 67.4%, grammatikës në nivelin 13.7%, theksin 8.3%, të kuptuarit 5.4%, si dhe në fjalorin e përdorur 1.4%”[1].

Së treti, Debati rrit inteligjencën emocionale si dhe empatinë personale të debatuesit duke zhvilluar të kuptuarit si dhe duke replikuar me etikë. Aftësia për “të kuptuar emocionet sikurse do të ishit në pozicionin e tjetrit” lehtëson ndërtimin e marrëdhënieve me të tjerët duke shprehur kujdes e vëmendje në vazhdimësi. E tillë është edhe filozofia e debatit: synon të ndërlihdë grupe me interesa të ndryshme me qëllim njohjen

dhe dëgjimin e avantazheve e dizavantazheve të një rezolute duke inkurajuar në fund një vendim-marrje efikase e për një të tillë, është e rëndësishme të vendosesh në pozitat e tjetrit. Sikurse shprehet një psikolog humanist Carl Rogers (1959) “Nëse do të kujdesesh vërtetë për tjetrin, nuk mjafton vetëm të flasësh, por të dëgjosh mire/me autenticitet, duke mbajtur një qasje pozitive si dhe empati”.

Debatuesit sfidojnë vlerat e tyre universale njerëzore që sipas modelit të vlerave të Schwartz synojnë universalizmin-të kuptuarit dhe mbrojtjen e mirëqënies së njerëzve e natyrës, mirësinë-mirëqënien e njerëzve me të cilët kontaktojmë më shpesh (brenda grupin), traditën: përcaktojnë qëllimin, duke paraqitur edhe fuqinë e tyre: statusin, privilegjet, arrijtjet e tyre: kompetencat përkundrejt standarteve sociale, me doza hedonizmi: kënaqësi në paraqitjen e vehtes, stimulimit dhe krijimit në mënyrë të sigurtë e në harmoni më atë çfarë është më e mira për shoqërinë.

Ekspozimi me tjetrin kërkon vetëbesim të lartë si dhe zhvillon aftësitë e komunikimit verbal e joverbal duke dhuruar aftësinë për të debatuar në mënyrë dinjitoze më cilindo pavarësisht moshës, nivelit akademik apo pozicionit në punë. Së bashku me skuadrën profesioniste të SCiDEV ne po synojmë për ta shtruar debatin si një mënyrë e njohjes e zhvillimit të individit, për një të mirë publike, për të nxitur një kulturë debati mes nesh po ashtu.

Edhe ti mund të debatosh dhe të përfitosh nga të mirat e debatit. Në çfarë mënyre? Ta nisim nga tavolinat ku drekojmë e darkojmë në çdo shtëpi të madhe e të vogël, ku një mendim i ndërtuar bukur nga fëmija ka kuptim dhe arrin të ndikojë në vendimet e një familjeje. Ta nisim me debatet mbi zgjedhjet e shkollës së lartë, karrierës që do të ndjekim ku krahas pasioneve të përballemi me të dhëna e referenca, do ishte më mirë , për të gjithë .

Unë e kam nisur tashmë, po ju?

Referenca:

Schwartz, S. H. (2012). An Overview of the Schwartz Theory of Basic Values. Online Readings in Psychology and Culture, 2(1). <https://doi.org/10.9707/2307-0919.1116>

Konstantikaki V.(2008). Empathy and emotional intelligence: What is it really about? International Journal of Caring Sciences, 1(3):118–123

http://internationaljournalofcaringsciences.org/docs/Vol1_Issue3_03_Ioannidou.pdf

Stets, Jan & Burke, Peter. (2000). Identity Theory and Social Identity Theory. Social Psychology Quarterly. 63. 224. [10.2307/2695870](https://doi.org/10.2307/2695870).

Iman, J. N. (2017). Debate Instruction in EFL Classroom: Impacts on the Critical Thinking and

Speaking Skill. International Journal of Instruction, 10(4), 87-108
https://www.researchgate.net/publication/320165326_Debate_Instruction_in_EFL_Classroom_Impacts_on_the_Critical_Thinking_and_Speaking_Skill

<https://debate.uvm.edu/dcpdf/DEBATE-%20Important%20for%20Everyone.pdf>

Të debatosh Metodologjinë e re të Zgjerimit!

Mar 14, 2020 | [Blog-Debati](#) | Lutjona Lula

Debati publik në Shqipëri mbi Integrimin European është pothuaj inekzistent, aq më pak debati publik i informuar. Nga ana tjetër Shqipëria është një ndër vendet më Euro-Entuziaste të rajonit duke patur integrimin Euro-Atlantik si prioritet që prej fillimit të tranzicionit. Megjithatë, diskutimi për këtë çështje është mbajtur në një nivel të përgjithshëm dhe kryesisht gjatë fushatave elektorale, ose midis grupeve të ngushta ekspertësh. Pas 30 vitesh aspiratash për integrim European, procesi në vetvete ka pësuar disa ndryshime. Çdo zgjerim i ndodhur ka shkaktuar atë që quhet ‘mësimet e mësuara nga zgjerimet e mëparshme’, të cilat po aplikohen në vendet e Ballkanit Perëndimor. Rishtazi, Bashkimi European ka publikuar [Metodologjinë e re të Zgjerimit](#).

Të debatuarit e temave lidhur mbi Bashkimin European është i nevojshëm për Shqipërinë pasi rrit informimin publik dhe mendimin kritik midis qytetarëve dhe sidomos studentëve. Të debatuarit e temave aktuale është nga ana tjetër një nevojë në auditorët universitarë. Metodologjia e re e zgjerimit sigurisht që ka ndeshur shumë interpretime sidomos në mediat në Shqipëri dhe Maqedoninë e Veriut, si dy vendet për të cilat u ndërtua. Serbisë dhe Malit të Zi kjo metodologji i është ofruar si opsionale, por nuk ka ndikim në kuadrin aktual me të cilin po zhvillohen negociatat me këto vende.

Megjithatë, si mund të analizohet kjo metodologji? Në të gjitha komunikimet zyrtare të Komisionit, fjala kyç është ‘besueshmëria’ (*credibility*). Në këtë kuadër, metodologjia e re kërkon të vendosë një perspektivë reale besueshmërie, e cila rrit drejtëpërdrejtë efektshmërinë e kushtëzimit (*conditionality*). Përpos kësaj, metodologjia e re duke qënë se fokusohet në parimet themelore të shtetit të së drejtës dhe demokracinë, përforcon atë që historikisht ka qënë postulati kryesor i procesit të europeanizimit-demokratizimit e vendeve që kalojnë nëpër këtë proces. Qëllimi i metodologjisë është në fakt të krijojë efekte të qëndrueshme në këto vende.

Çdo të thotë kjo për Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut? Proces më i gjatë në rast se reformat nuk merren si zotime serioze dhe prioritare. Kjo mund të sjell integrimin e Serbisë dhe Malit të Zi më parë se Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut, duke ndikuar indirekt dhe balancat gjeopolitike në rajon, kjo jo për shkak të BE-së, por si pasojë nëse këto dy vende nuk i japin fund dualizmit aktual. Aktualisht, në të gjithë vendet e Ballkanit Perëndimor vihet re një dualizëm në retorikën e përdorur nga liderat-njëra që i shërben gjuhës dhe audiencës kombëtare dhe tjetra në anglisht dhe për hir të faktorit ndërkombëtar. Më në fund, kjo metodologji mund t’i japë fund këtij dualizmi, por zgjatja e procesit mbetet një sfidë. Metodologjia shpreh në mënyrë eksplicite politikën e ‘sticks and carrots’ por në këtë rast përmes stimulit të fondeve të BE, që vijnë si shpërblim në rast progresi në *cluster*-in përkatës. Qytetarët e Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut mund të ndeshen me *euro-fatigue* edhe pse nga ana tjetër nëse informohen realisht mbi situatën, kjo metodologji mund të nxisë dhe llogaridhënien qytetare ndaj qeverive të vendeve. Në këtë pikë, metodologjia e re e zgjerimit shpreh plotësisht fokus mbi zhvillimet politike dhe demokracinë e vendeve kandidatë duke i konsideruar kapitujt me karakter ekonomik si pasues të të parëve, ndryshe nga kuadri e deritanishëm ku hapja e kapitujve zhvillohej paralelisht.

Kjo metodologji është publikuar gjatë 100 ditëve të para të Komisionit të kryesuar nga Ursula Von der Leyer, gjatë së cilës janë prezantuar edhe *'EU Green Deal'* & *'Gender Equality Strategy'*. Së fundmi, me situatën e pandemisë botërore COVID-19 pritet të ketë ndikime në ekonominë e BE-së, duke e renditur kështu zgjerimin sërish poshtë në listën e prioriteteve, pas periudhës së *'Brexit'*. E megjithatë, të gjitha këto zhvillime duhen debatuar publikisht për të arritur efektin e dëshiruar të vetdijësimit mbi procesin e integritit dhe rritjen e llogaridhënies. Një brez i tërë u rrit me shprehjen 'E duam Shqipërinë si gjithë Europa'. Tashmë brezit të ri i takon të informohet dhe përfshihet në proces.

Debati studentor dhe mësimet e tij për punën në grup

| Mar 23, 2020 | [Blog-Debati](#) | Nevila Xhindi

Një aspekt i rëndësishëm i realizimit të debatit me studentët është edhe puna në grup. Të gjitha debatet fillojnë me një temë dhe padiskutim me krijimin e dy grupeve debatuese, ku njëri grup do të argumentojë dhe një tjetër do të kundërshtojë. Për trainerët e debateve apo edhe për pedagogët në auditore, pika e parë e rëndësishme në krijimin e grupeve është dinamika e grupit, puna e tyre si një “team”, ku ndarja e detyrave dhe përgjegjësia janë fillimet e një pune për realizimin e një debati që vlen.

Puna në grup e bën përgatitjen për debatin më efikas dhe argëtues, si dhe jep mundësinë të mësojmë shumë nga njëri-tjetri. Ka shumë përfitime nga analizimi, diskutimi dhe eksplorimi i ideve dhe sidomos nga shqyrtimi i pyetjeve dhe përfitimi i komenteve nga njëri tjetri. Ndarja e detyrave, por edhe diskutimi i tyre në grup lejon unifikimin e ideve dhe përvijon qëndrimin ndaj çështjes që do debatohet, jo vetëm në këndvështrimin individual, por edhe nga këndvështrime të ndryshme. Në një situatë efektive të punës në grup, realizohen hulumtime që nuk mund të behen nga një individ. Puna në grup jep mundësinë e kombinimit të një larmie aftësish dhe ekspertize për të trajtuar probleme më komplekse dhe më të mëdha sesa vetëm një individ do bënte. Kjo aftësi bëhet edhe më e rëndësishme nëse jemi duke punuar në një kornizë të kufizuar kohore, sepse puna në grup na lejon realizimin në një kohë më të shpejtë bërjen e analizave në një thellësi dhe gjerësi më të madhe sesa nëse do të punonim individualisht.

Një punë efektive në grup së bashku për të përfunduar një detyrë në një kohë të caktuar, ndihmon që secili anëtar të kontribuojë në ekip sipas aftësive, përvojës dhe personalitetit të tij. Puna në grup jep një mundësi për t’u njohur më mirë me njëri-tjetrin dhe për të zhvilluar aftësi aq të nevojshme për suksesin e debatit. si p.sh. komunikim efektiv, bashkëpunim, kujdes, mendim kritik- konstruktiv, udhëheqje/roli i liderit, delegim, mirënjohje, respekt për mendimin ndryshe etj.

Unë dua të ndaj me kolegët e mi që po përgatisin debatet, por edhe grupet e studentëve, disa mësimet të nxjerra nga puna në grup për realizimin e debatit me studentët e Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë në kuadrin e projektit “ Debati Universitar mbi Integrimin: realizuar nga SCiDEV me mbështetjen e OSFA. Mësimet e nxjerra do tu ndihmojnë të realizoni një debat të suksesshëm.

Debati është një projekt grupi për të arritur një detyrë, dhe që të jetë i suksesshëm, ka faza të ndryshme përmes të cilave duhet kaluar. Planifikimi është thelbësor për punën efektive në grup dhe do t’ju japë drejtim dhe ndihmë për të koordinuar punën tuaj në mënyrë që të përfundoni me efikasitet detyrat për debatin e suksesshëm.

Para së gjithash është e rëndësishme të krijoni një seri udhëzimesh në grup. Njihuni me anëtarët në grupin tuaj, pikat e tyre të forta dhe mënyrat e preferuara të punës. Mundohuni të kuptoni se të gjithë kanë një mendim dhe se individët kanë metoda të ndryshme të të punuarit dhe të mësuarit.

Këshillohet të caktoni një drejtues të grupit dhe gjithashtu një shkruar për të regjistruar aktivitetet e grupit. Diskutoni për temën e dabit me grupin për të arritur një mirëkuptim të përbashkët. Përmbliidhni kuptimin e përbashkët të problemit në një tabelë ose në një copë letër dhe diskutoni se si do t'i afroheni problemit. Metoda brainstorming është ideale për të krijuar ide, plane dhe detyra për grupin tuaj. Të gjithë duhet të përfshihen në diskutime dhe të bien dakort se çfarë drejtimi po merr grupi dhe pse.

Vendosni detyrat specifike dhe shpërndajini ato për individë ose nëngrupe. Ndarja e detyrave me nëntema më të vogla mund të jetë më e qartë dhe më efektive. Është e rëndësishme që grupi të jetë i qartë, të qartë detyrat e secilit dhe për të parandaluar përsëritjen dhe punët dyfishe, dhe padiskutim vini afate që secili anëtar i grupit të ketë përgjegjësi. Pasi të keni vendosur për detyrat dhe rolet tuaja, është thelbësore që të organizoni takime të rregullta (tashmë online) për të rishikuar përparimin tuaj dhe të vendosni se në cilën drejtim duhet të marrë puna juaj. Secili anëtar duhet të marrë pjesë në këto takime. Vendosni data për përfundimin e detyrave specifike...dhe jam e sigurtë gjithçka do realizohet e do keni sukses!

Në fakt dua të bëj edhe disa përgjithësime mbi vlerën e përfshirjen e studentëve në punën në grup. Puna në grup ka të ngjarë të bëhet një aspekt i rëndësishëm i jetës suaj të punës. Thelbësore për punën efektive në grup është dinamika e grupeve, dhe praktikimi i punës në grup mund të ju ndihmojë kuptoni vlerën e faktorëve të ndryshëm që zbatohen në një skenar të bazuar në grup (p.sh. rolet në grup, komunikimi, delegimi).

Puna në grup po bëhet gjithnjë e më e rëndësishme për strukturën organizative të vendit të punës. Sot, puna në ekip/grup është një kërkesë absolutisht thelbësore në kriteret e rekrutimit të të diplomuarve. Përgatitja, apo avancimi i punës në grup gjatë jetës studentore, do të përgatisë studentët që të jenë menjëherë të dobishëm për punëdhënësit. Shumë kompani kërkojnë që detyrat të realizohen në ekipe dhe me ekipe që funksionojnë në maksimum të aftësive të tyre. Në biznese, sipërmarrje, industri përvoja ka treguar që problemet zgjidhen nga puna në grup dhe inovacionet kanë shansin më të mirë të suksesit nëse zbatohen nga ekipe multidisiplinare.

Pandemia COVID-19 dhe shkencat sociale

| Mar 23, 2020 | [Blog-Debati](#) | Blerjana Bino

Për këtë shkrim marr shkas nga një prej partnerëve kryesorë të Qendrës “Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim”, me të cilët kemi punuar së bashku me rrjetin COORP për realizimin e trajnimit të zhvillimit të kapaciteteve të kërkuesve të rinj për kërkimin shkencor me impakt. I referohem Institutit për Studimet Zhvillimore ([Institute of Development Studies](#)) dhe një përmbledhje shkrimesh e reagimesh të publikuar prej tyre së fundmi lidhur me përgjigjen e shkencave sociale si disiplinë ndaj pandemisë nga COVID-19.

Situata aktuale e pandemisë natyrisht që ka ngjitur në pedestal dhe me të drejtë rolin e mjekëve, infermierëve dhe të gjithë stafit mbështetës mjekësor që janë në vijën e parë të përballjes me luftën ndaj virusit. Kështu që nga pikëmapja e disiplinave shkencore, risillet në vëmendje edhe njëherë rëndësia e shkencave të jetës, mjekësia, biologjia, bio-teknologjia, kimia etj. E duke qenë se aktivitetet e zakonshme të jetës me të cilën jemi mësuar dhe njohim më mirë janë pezulluar, atëherë zgjidhja po gjendet tek “online”.

Kështu në këtë rast, gjithmonë e të tepër i drejtohem ekspertëve të teknologjisë së komunikimit dhe informacionit, inxhinierëve elektronik, programuesve dhe ekspertëve të transformimit digjital për të gjetur zgjidhje nga kryerja e pazareve online, e deri tek studimi online apo puna në distancë. Po shkencat sociale ku qendrojnë sot në kohë krize dhe pandemia globale si disiplinë? A janë të vlefshëm disiplinat dhe programet e studimit sot në shkencat sociale? Me perspektivën që bota dhe jeta jonë do të ndryshojë shumë pas kësaj, si do të ripozicionohen shkencat sociale?

Kërkuesit e Institutit për Studimet Zhvillimore (Institute of Development Studies) përmes analizave dhe shkrimeve të tyre na tregojnë sesi shkencëtarët sociale po reagojnë ndaj COVID-19 dhe impaktit të tij në jetën sociale në mënyra të ndryshme. Ndër të tjera, kjo përfshin ndarjen e mësimëve të marra nga Ebola dhe SARS dhe shpërthimin fillestar në Ëuhan, apo analiza të lidhura me përvojat e njerëzve në terren dhe marrjen e masave sidomos për ndikimet në njerëzit në lagjet dhe vendbanimet informale, dhe eksplorimin e ndikimit të virus në praktikën fetare. Për më shumë mund të lexoni [këtu](#).

Pandemia COVID-19 është edhe një fenomen shoqëror. Natyrisht që dinamika e virusit, imuniteti, përpjekjet për të gjetur vaksinën, mjekimi, parandalimi etj. janë të gjitha kritike në këtë situatë, por po aq kritike është edhe aspekti social. COVID-19 po ridimensionon praktika jetësore, sociale dhe kulturore në një shkallë të paprecedentë dhe në një kohë shumë të shkurtër. Merrni psh vetëm rastin e shtrëngimit të duarve apo dhënies së një përqaftimi. Të evidentosh, kuptosh, dhe analizosh këto fenomene nevojitet ekspertiza e shkencave shoqërore. [Këtu](#) mund të lexoni më shumë nga kolegët e IDS për COVID si një fenomen shoqëror që kërkon ekspertiza diverse.

Një tjetër aspekt është edhe reagimi politikëbërës ndaj COVID-19. Reagimi i politikës ndaj COVID-19 në të gjithë botën është i pashembullt. Ka shumë arsye për këtë, jo vetëm sepse kjo nuk perceptohet më nga kombet e fuqishme si një nga ato epidemi që prek më së shumti “tjetrin” larg, të varfër që janë ndryshe nga “ne”. COVID-19 i prek të gjithë pa dallim statusi social-ekonomik apo kufijsh kombëtar. Sidoqoftë, duhet të



bëhet më shumë për të adresuar rrjetet e politikave aktualisht të shkëputura që luftojnë për të menaxhuar kriza sociale dhe mjekësore. Më shumë mund të lexoni nga kolegët e IDS [këtu](#).

Përballimi i karantinës, përshtatja me mënyrat e reja të mësimin, studimit, kërkimit, punës dhe ndërveprimit në përgjithësi me të tjerët dhe mjedisin që na rrethon, kërkon pa diskutim kontributin dhe ekspertizën e shkencëtarëve sociale, e kërkuesve, studiuesve të shkencave sociale.

Debati Universitar për Integrimin dhe rikonceptimi i tij në kohën e koronavirusit

| Mar 23, 2020 | [Blog-Debati](#) | [Esmeralda Shehaj](#)

Ka dy jave që të gjithë jemi izoluar në banesat tona për shkak të pandemisë, dhe pas shqetësimit madhor për shëndetin, shqetësimi më i madh për shumë prej nesh është të gjejmë mënyra për të kaluar kohën pa ndier, e pa rënë në depresion, frikë e ankth për shkak të informacioneve të shumta mbi situatën. Ndërkaq, nga ana e drejtuesve të institucioneve të arsimit të lartë, ka një shqetësim të shtuar në lidhje me rifillimin e procesit të mësimdhënies online. Rrihen mendime dhe debatohet në lidhje me funksionimin, mundësitë, interesin, testimet, avantazhet e disavantazhet. Edhe aktivitetet e projektit për Debatin Universitar për Integrimin janë ndërprerë prej dy javësh, e si një alternativë ka lindur ideja e kryerjes së një konkursi të debatit online. Po sa e bëshme është kjo?

Qëllimi i këtij konkursi debati është kryesisht të stimulojë tek studentët aftësitë e të menduarit kritik, artikullimit, reflektimit, ndërveprimit, fleksibilitetit, të folurit në publik dhe të krijimit të pikëpamjeve të tyre në lidhje me Integrimin Evropian. Skuadrat e debatit universitar përbëhen nga katër anëtarë secila. Anëtarët e skuadrës do të duhet të debatojnë mbi një temë të caktuar, e cila do të hidhet me short, duke mbajtur qëndrime pro e kundër, gjithashtu të hedhur me short. Debati është i formatuar, rradha folësve për dhënien e argumenteve/kundërargumenteve dhe koha në dispozicion për ta është e specifikuar, si brenda skuadrës dhe ndërmjet skuadrave. Pra, debati është i formatuar dhe ky format lejon motivimin e kolegëve të të njëjtës skuadër, punën në grup, si dhe zhvillimin dhe thellimin e ideve dhe argumentave.

Po si mund të transformohet ky format në një debat online në kushtet e reja? A mundemi që ta shfrytëzojmë këtë situatë për të dizenuar një format efektiv të debatit online, efektiv në kuptimin që të mundësonte arritjen e qëllimeve të njëjta apo të ngjashme me një debat që zhvillohet në kushtet e pranisë fizike të pjesëmarrësve në një mjedis të përshtatshëm?

Dy janë format e debatit online. E para është ajo me video-konferencë. Në aplikimin e kësaj forme, studentët aksesojnë një aplikacion të caktuar online në të njëjtën kohë. Studentët duhet të kenë të hapura kamerat dhe mikrofonët. Duke lënë mënjane pajisjet që mundësojnë këtë lidhje dhe disponueshmërinë e tyre nga ana e studentëve, kufizimi kryesor për aplikimin e tij në kushtet e tanishme mbetet të jetë mungesa e një bashkëpunimi në grup, si një skuadër. Anëtarët e skuadrës nuk do të mund të jenë së bashku në një mjedis të përshtatshëm. Pavarësisht se rolet dhe rradha e dhënies së argumenteve është e përcaktuar në secilën skuadër, studentët nuk do të mund të bashkëveprojnë, të ushqejnë folësin e rradhës me argumente, të shkëmbejnë ide, e të marrin vendime për reagimin. Sigurisht, që një pjesë e mirë e argumenteve janë të parapërgatitur, por si do të mund të japin kundërargumenta për argumentat e skuadrës kundërshtare pa diskutuar mes tyre!? Përveç kësaj, strategjitë e ekipeve për përgatitjen mund të jenë të ndryshme. Supozojmë se një skuadër ka vendosur që secili prej anëtarëve të lexojë gjithë materialet bazë, dhe secili prej anëtarëve të specializohet në një apo dy prej temave. A nuk do të ishte e vështirë, që në mungesë të komunikimit me njëri-tjetrin gjatë zhvillimit të debatit me video-konferencë, studenti me njohuri më të mira për temën të furnizojë folësin e rradhës (i cili është i përcaktuar) me argumenta dhe statistika në kohë dhe në mënyrë efektive? Reagimi i duhur, i shpejtë, përzgjedhja e statistikave të duhura dhe argumentave më të mire

mbështetës, është një nga elementët bazë të këtij debati. Në përfundim të kohës së kufizuar e të shkurtër për të përmbledhur argumentat më të mirë, rezultati mund të jetë përzgjedhja e argumentave nën diskrecionin dhe njohuritë e folësit të rradhës, jo të skuadrës. Po lideri, si do ta kryejë funksionin e tij në këtë rast?

Në rast se supozohet që studentët do të përgatiten njësoj si të ishim në kushte normale, një supozim ky i dyshueshëm në kushtet e kufizimit të lëvizjeve dhe distancimit social ciladoqoftë forma e debatit, gjasat që debati me video-konferencë të mos arrijë një pjesë të mirë të objektivave të tij janë të larta. Në rastin më të mirë, studentët do të përgatiten me seriozitet dhe do të studiojnë në thellësi temat e debatit dhe do të kenë përgatitur më së miri argumentat pro e kundër. Ndërkaq, të folurit në publik, reflektimi, puna në grup, bashkëveprimi, reagimi, artikulli i kundërarargumentave, do të jenë të cunguar.

Alternativa e dytë është ajo e një debati online me shkrim. Sigurisht, që në këtë rast ka nevojë për një “riformim” të rregullave. Për shembull, nëse një folës duhet të japë argumentat e tij brenda një kohe prej dy minutash, kur argumentat jepen me shkrim, do të duhet të vendoset një limit fjalësh. Koha e përgjigjes duhet gjithashtu të ndryshojë. Për shembull, nëse në debatin me prani fizike, skuadra duhet të japë argumentat/kundërarargumentat pas një konsultimi apo kohe përgatitore prej dy minutash, në debatin me shkrim, kjo mund të përkthehet në një reagim, të themi, pas dy orësh. Po le të supozojmë se do të duhet një ditë. Në këtë formë alternative të debatit, përveç aftësive të përmendura më sipër, studentët do të përmirësojnë edhe aftësinë e të shkruarit. Dhe kosto në këtë rast do të ishte mungesa e reagimit të shpejtë, gjetjes shpejt të (kundër)argumenteve dhe statistikave mbështetëse të tyre. Nga ana tjetër, një reagim i tillë, edhe pse i vonuar në kohë, pritet të jetë më i thellë. Kufizim i fortë mbetet koha, pasi në një format të tillë studentët do të duhet t’i kushtojnë më shumë kohë këtij aktiviteti. E nëse këto parashtrime qëndrojnë, një debat me shkrim është, për mendimin tim, një formë alternative me më shumë përfitime, e më pranë arritjes së objektivave të projektit.

Mbi të gjitha, duhet patur parasysh që të gjitha këto bazohen në supozimin se studentët, të cilët vendosën të merrnin pjesë në një konkurs me pjesëmarrjen e tyre fizike, do të jenë dakord të marrin pjesë në një konkurs online. Këtu testohet prirja e tyre për të përqafuar ndryshimin në kohën e distancimit social. Por, cilado qoftë forma e preferuar e debatit online, duhet të kemi parasysh se zhvendosja drejt debatit online do të gjenerojë debate të reja mes studentëve dhe mentorëve për të marrë një vendim të përbashkët, për të zgjedhur një formë të debatit online, për të vendosur rregulla të reja, afate të reja. Pra, do të duhet të përgatitemi për sfida të reja, të cilat duhet të gjejnë zgjidhje në kushtet e distancimit social, dhe që me shumë gjasa do të qëndrojnë me ne, për të riformëzuar në afatgjatë konceptet dhe perceptimin tonë mbi debatin dhe mësimdhënien online.

Aftësitë debatuuese, një vlerë e padiskutueshme për studentët

| Mar 24, 2020 | [Blog-Debati](#) | [Petrina Broka](#)

Kur u kontaktova nga SCiDEV, për të qenë pjesë e organizimit të një debati për integrimin Europjan e pranova me shumë kënaqësi këtë mundësi. Kjo për shumë arsye, por këtu do të ndalem tek dy më kryesoret.

Arsyeja e parë, lidhet me vlerësimin tim ndaj aktiviteteve të këtij lloji, të cilat janë me shumë vlerë në zhvillimin e debatit mes studentëve në përgjithësi dhe si një vlerë e padiskutueshme për studentët e drejtësisë. Kur kam qenë studente jam përpjekur që të marr pjesë në çdo iniciativë të ngjashme, pavarësisht se kanë qenë shumë më të pakta. Nga këto eksperiencia, do të veçoja pjesëmarrjen në Konkursin Ballkanik të Rasteve Studimore (*Balkan Case Challenge*), në të cilin kam marrë pjesë dy herë, në Sarajevë e në Vjenë. Atje kam pasur fatin të bashkëpunoj dhe të debatoj me studentët më të mirë të Ballkanit. Një numër i konsiderueshëm prej tyre, sot japin kontributin në politikë, studio ligjore prestigjioze, në administratë publike, organizata ndërkombëtare, në botën akademike, etj. Eksperiencia të tilla sigurisht, që të rrisin e të pasurojnë, si në aspektin profesional, ashtu edhe atë njerëzor. Të bëjnë të kuptosh, se ku je dhe ku dëshiron të arrish. Nëpërmjet të tilla aktiviteteve, ku padyshim njeh shumë njerëz të rinj, ti njeh më shumë edhe veten.

Arsyeja e dytë, lidhet me gjendjen që po kaloni ju, studentët shqiptarë. Këto vitet e fundit kanë qenë për ju vite sfide, kërkese, protestash të mëdha, por edhe vite të arta që me siguri do të sjellin frytet e tyre dhe do të lënë shenja në histori. Semestri kalendarik, që lamë pas, ishte po ashtu një sfidë, ku na u desh të përballëshim me fatkeqësi natyrore si tërmeti i 28 nëntorit, i cili gjithsesi nuk e preu hovin e shumë prej jush për të mbushur auditorët dhe për të debatuar. Kjo ndoshta ishte terapia më e mirë për të gjithë ne, për të kaluar edhe ankthin e atyre kohëve. Tani që po shkruaj, jemi sërish në një tjetër sfidë, pandemia e COVID-19. Megjithatë, ajo që mbetet e përbashkët në të gjitha këto situata të ndryshme është rëndësia themelore, që merr nevoja për një kërkim e debat shkencor konstruktiv, si një mënyrë për t'u përballur me to dhe për ti dhënë zgjidhje këtyre situatave kaq të vështira.

E gjithë kjo periudhë u shoqërua edhe me ndërprerje mësimore, gjë që rrit nevojën e iniciativa të tilla jashtë-kurrikulare, për të kompensuar sado pak “humbjet” e shkaktuara, duke fituar aftësi dhe njohuri në një mënyrë alternative. Dhe pse jo, të na mundësojnë njohje të reja dhe eksperiencia të reja edhe në këto kohë të vështira, ku distancimi fizik nga njëri tjetri është i një domosdoshmërie jetike, por që falë teknologjisë mund të kapërcehet, në pritje të ditëve më të mira.

Po ti referohemi Fjalorit të Gjuhës së Sotme Shqipe fjala debat do të thotë: “Rrahje mendimesh ndërmjet dy a më shumë vetave rreth një çështjeje politike, shoqërore etj.; diskutim i gjerë, i hapur për një çështje me rëndësi”. Pra, të debatosh do të thotë të sjellësh argumente e të jesh në gjendje të kundërshtosh argumentet që të paraqiten, në mënyrë të qartë e të përmbledhur.

Kjo aftësi është e domosdoshme në çdo fushë të jetës, por për studentët e së drejtës e profesionistët e kësaj fushe është e një rëndësie tepër të veçantë. Debati për këta të fundit është një aftësi e domosdoshme, për të

ushtruar profesionin e tyre me sa më shumë përgjegjësi, rigorozitet e profesionalizëm. Ky debat duhet të jetë sa më konstruktiv. Një specifikë, që ka debati i njerëzve të ligjit është se gjithmonë ai duhet të udhëhiqet nga e drejta, e cila duhet të jetë logjike, ligjore dhe e mirë-arsyetuar.

Një prej frazave, që u përsëris shpesh studentëve, si në leksione e seminare është ajo mbi domosdoshmërinë për të nxitur debatin dhe për të kontribuar në të, në mënyrë konstruktive. Prej tij fitojmë të gjithë, si ne pedagogët ashtu edhe studentët, si një vlerë e çmuar e shoqërisë sonë dhe si një forcë e madhe. Debatet që gjenerojnë në këto forume janë të domosdoshme dhe janë padyshim ndër debatet më të bukura dhe të vlefshme për rritjen tuaj profesionale. Janë të tilla debate, që do t'ju aftësojnë për rrahje mendimesh, qëndrimesh e interpretimesh edhe në situatat më të vështira. Këtu do të veçoja, debatin gjyqësor, ku ju studentët e drejtësisë do të duhet të përballeni me profesionistë, që mund t'ju vënë në vështirësi emotive, përveç atyre profesionale. Pikërisht, që të mund ti kaloni të tilla situata, në mënyrën më të mirë dhe më të lehtë të mundshme, duhet ti zhvilloni të tilla aftësi, që kur keni "*privilegjin*" të jenë student. Pra, për të përballur me sukses veprimtaritë profesionale të së ardhmes, duhen zhvilluar që herët aftësitë debatuese, që bashkëshoqërohen me punë të konsiderueshme kërkimore e përgatitje teorike e praktike. Për të qenë në gjendje për të debatuar, duhet të kesh njohuritë e nevojshme mbi çështjen që po debaton. Për këtë, duhet të kryesh një kërkim më të thelluar për temën që debatohet, përtej atyre që mësohen në auditorë.

Konkurset e debatit i vendosin pjesëmarrësit nën trysinë për të qenë më të mirët, për të punuar më shumë, për të studiuar më shumë, për të sakrifikuar më shumë nga koha e argëtimit, në mënyrë që të realizojnë objektivin e tyre. Pa dyshim, këto vështirësi do ti sjellin frytet e tyre në të ardhmen e afërt ku përballja me këto vështirësi do të jetë: për të siguruar apo mbajtur një vend pune, për të fituar një çështje gjyqësore, apo për të ndihmuar dikë në vështirësi.

Pjesëmarrja në debatet studentore të jep më shumë siguri për të paraqitur argumente dhe për ti strukturuar logjikshëm në debate të çdo shtate. Këto aftësi do jenë të domosdoshme dhe të vlefshme, që në fazat e kërkimit të një pozicioni pune, si dhe në ushtrimin e tij, në pozicione të ndryshme si: avokat, prokuror, gjyqtar, noter, jurist në administratë a ndërmarrje, etj.

Në kuadër të ndryshimeve të rrufeshme që po kalon bota jonë, ndryshimet gjeopolitike dhe ekonomike në rrafsh ndërkombëtar, ashtu edhe sfidat me të cilat përballlet vendi ynë në drejtim të integritimit evropian, rritja ekonomike dhe sistemi ynë i drejtësisë, në kuadër të reformave që po ndërmerren; zhvillimi i aftësive debatuese dhe prezantuese marrin një vlerë të veçante në formimin e brezave të studentëve të sotëm dhe profesionistëve të së nesërme.

Disa refleksione në situatë vetë-izolimi

| Mar 24, 2020 | [Blog-Debati](#) | Renis Bakalli

Student pjesëmarrës në debatin universitar për integrimin

Corona virus. Covid-19. Do të ishin këto termat e rinj, fare të rinj, të padëgjuar, të afta të na tregonin paaftësinë tonë për zbulimin e identitetit të vërtetë të këtij virusi me emrin e birrës fort të pëlqyer nga të gjithë ne. Do ishin këto terma që do ktheheshin në një periudhë të shkurtër kohe shkaku I fillësës së një modeli të ri jete.

Një jetë pas në vite e ndoshta pas në shekuj. Bota tashmë ka fikur motorrin e saj. Shqipëria si pjesë e këtij fshati global po ashtu. Shtepitë janë plot. Lokalet janë bosh. Garazhet janë plot, rrugët janë bosh. Të pasurit janë brenda në shtëpi, të varfërit po ashtu. Për herë të parë deputetë e politikanë nuk kanë imunitet. Gjithëpërfshirja e këtij virusi pa dallim e ktheu në "pandemi", dhe e gjithë bota po e lufton. Varfëria sot është një pandemi. Krimi është një pandemi. Kequshyerja është një pandemi. Pabarazia është një pandemi. Vjedhja sot është një pandemi. Patjetër që po. Të gjitha këto që përmenda janë një pandemi dhe lista sigurisht vazhdon. Numri i të prekurve nga këto pandemi është shumë herë më i madh dhe ai vdekjeve shumë herë më i lartë. Por cili është ndryshimi mes diversitetit të pandemive dhe kësaj që po jetojmë? Gjithëpërfshirja. Fakti që kësaj here paraja dhe pushteti nuk krijojnë mburojë. Statistikat tregojnë që numri i vdekjeve nga raste tashmë të njohura dhe me kura tashmë të zbuluara është shumë herë më i lartë se numri i vdekjeve nga Covid-19. Dhe zgjidhja e tyre bëhet me para. Ke të tilla? Ia hodhe. Nuk ke? "Më vjen keq, bëmë më të mirën tonë". Por pavarësisht opinionit personal referuar çështjes, kjo që po jetojmë është një pandemi e cila na ka paralizuar.

Ky virus vuri në dukje "përsosmërinë" tonë, të perëndimit të zhvilluar, të Amerikës së mundësive, të Kinës së avantazheve konkurrese dhe gjithçkaje kishim si guide drejt më të mirës. Me sa duket u duhet të rishohin edhe njëherë këtë përsosmëri nga një këndvështrim tjetër. Viti 2020. Kush vallë do ta mendonte se të bërit asgjë do të ishte në dobinë e vijimësisë së jetës normale? Kush do ta mendonte se shtrengimi i duarve si shenjë respekti dhe përqaftimi si forma më e lartë e shfaqjes së dashurisë do të ishin rreziku i sigurt i së ardhmes? Kush do ta mendonte se për herë të parë bashkimi nuk e bën më fuqinë, por individualisht të gjithë mund të kemi mjaftueshmërisht fuqinë për të bërë ndryshimin. Kush do ta mendonte se teknologjia edhe pse e pandashme në përditshmërinë tonë do ishte zgjidhja e vetme për realizimin e zgjedhjeve tona. Kush do ta mendonte se për herë të parë shtëpitë do të ishin tërsisht në funksion të qëllimit për të cilin u ndërton? E kush do ta mendonte se biçikleta dhe jo makina do ishte luksi i kohës?

Me sa duket nuk na kanë mbetur shumë zgjedhje dhe zgjidhje. Zgjidhja herët ose vonë do të gjendet, e deri atëherë na duhet të zgjedhim. E nga zgjedhja jonë varet edhe e ardhmja jonë, e prindërve tanë, e gjyshërve tanë, e të afërmeve tanë, e ardhmja e cdonjërit kemi të shtrenjtë në jetën tonë. Me pak fat e ardhmja do të na buzeqeshi dhe e tashmja do jetë një kujtim i largët i së shkuarës. Deri atëherë, fli gjumë dhe bëj asgjë që bëhet jashtë.



Çelja e negociatave për Shqipërinë: Very good but too late my friends!

| Mar 24, 2020 | [Blog-Debati](#) | [Klodiana Beshku](#)

Vendet anëtare të Bashkimit Europian arritën sot të marrin një vendim për çeljen e negociatave me Shqipërinë e Maqedoninë e Veriut, për të mos thënë “pranuan” të hapin negociatat me këto dy vende, në linjë me shmangien e përdorimit të fjalës “refuzuan” të hapnin negociatat në Tetor të vitit të kaluar.

Po çfarë ka ndryshuar që në Tetor 2019? Që atëherë ka kaluar në mes një det i tërë, në kuptimin fizik dhe metaforik të fjalës. Jo vetëm ishulli britanik tashmë është ndarë zyrtarisht nga BE-ja, por metodologjia e zgjerimit të BE-së drejt vendeve candidate ka ndryshuar katërcipërsisht. Për ta sqaruar pak më mirë këtë, le të kthehemi pakëz në kohë.

Në Tetor të vitit 2019, Këshilli Europian nuk i hap negociatat për Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut, pavarësisht rekomandimit pozitiv të Komisionit Europian në lidhje me këto dy vende. Kundërshtuesi më i bindur në këtë drejtim qe Franca dhe presidenti Makron, por edhe Holanda e Danimarka i shkuan me zell nga pas kësaj linje. Disa ditë më vonë, Parlamenti Europian me një rezolutë të posaçme u shpreh “thellësisht i zhgënjyer” ndaj këtij vendimi e në vazhdim Franca u vendos nën një presion të fortë prej opinionit publik e elitave politike europiane, presion i cili në fakt duhej të ishte nxitur fort prej kohësh nga ana e Shqipërisë qysh përpara Samitit të Brukselit të Tetorit duke qenë se qasja e Francës e Hollandës dihej ngahera.

I vendosur përballë këtij presioni, presidenti Makron vendos t’i qendrojë linjës së tij, duke vazhduar të trumpetojë për një ndryshim të thellë në metodologjinë e zgjerimit të BE-së përpara ndezjes së dritës jeshile për vendet e mbetura pezull. Një muaj më vonë, në Nëntor 2019, Franca publikon një dokument të quajtur *Non paper* me rekomandimet e saj në lidhje me këtë proces, rekomandime të cilat ngjasonin më tepër me kushte që, nëse do të ishin aprovuar në atë formë, do të kishin bërë që vendet e rajonit të Ballkanit Perëndimor të shihnin BE-në “me dylbi”. Fatmirësisht, disa vende dashamirëse dalin me një tjetër *Non paper* në Dhjetor 2019 hartuar nga Austria, Republika Çeke, Sllovenia, Polonia, Estonia, Letonia, Lituania e Malta, i cili rreket të zbusë kushtet franceze dhe kështu ndodh. Metodologjia e re e publikuar më 5 Shkurt nga Komisioni Europian në lidhje me vazhdimin e zgjerimit të BE-së drejt vendeve të tjera duket të jetë një kompromis mes qasjes së bllokut francez jo favorit ndaj Shqipërisë dhe asaj të vendeve favorite ndaj saj.

Në këto kushte të reja, Shqipëria e Maqedonia e Veriut tashmë përballen me kushtëzime shumë më të ashpra se sa Serbia e Mali i Zi në rrugëtimin e tyre drejt BE-së. Tashmë 35 kapitujt janë përmbledhur në 8 Grupime dhe mbyllja e secilit prej tyre do të shihet ngushtësisht e lidhur me atë të kapitujve të tjerë në grup, Këshilli Europian merr pjesë ngushtësisht me Komisionin në hartimin e Raportimeve dhe tashmë është përfshirë edhe klauzola e “kthimit mbrapsht” të procesit në rast se një vend nuk performon ashtu siç duhet në këtë proces, për të përmendur këtu vetëm disa prej ndryshimeve më thelbësore. Pra, prej krenarisë së atyre që ishin ngarkuar të merreshin me procesin e integritit, mungesës së koordinimit të të gjithë aktorëve kombëtarë në këtë proces, aktivitetit destruktiv të opozitës, por sigurisht edhe prej situatës jo të favorshme në gjirin e BE-së, Shqipëria humbi një tjetër satcion në këtë rrugëtim, por fatmirësisht jo trenin. Edhe



njëherë ajo u shpëtua prej rastësive, siç do të thoshte Konica i madh, ndoshta për të mos i shuar plotësisht shpresat e atyre që e kanë dashur dhe ende e duan me gjithë zemër integrimin europian të vendit.

Transformimi digjital i përshpejtuar nga pandemia COVID-19

| Mar 24, 2020 | [Blog-Debati](#) | [Erjon Curraj](#)

Në përgjithësi, transformimi digjital si pasojë e përhapjes së gjithë-anshme të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit perceptohet si *'disruptive'*, në kuptimin që ndryshon rrënjësisht normalitetin, pra praktikat sesi mësojmë, punojmë, argëtohem dhe ndërveprojmë me të tjerët. Rezistenca për ta përqaftuar transformimin digjital është madje një fenomen i mirë-studiuar. Shumë biznese kanë qenë në mëdyshje për transformimin digjital pasi ishin mirë me status quo-në dhe nuk dëshironin të 'turbullonin ujrat'. Megjithatë, në kushtet e pandemisë COVID-19, duket sikur të gjithë u drejtuan nga digjitalizimi në përpjekje për të ruajtur e përjetuar sado pak 'normalitetin', të cilin po e humbasim me shpejtësi nga masat shtrënguese të pashëmbullta të kufizimit të lëvizjes, distancimit shoqëror, pezullimit të mësimin, punës e aktiviteteve të tjera kulturore, sociale, sportive. Për të qenë efektiv, për të vepruar në këto kushte të reja, për të përballuar përhapjen e virusit dhe për t'ia dalë mbanë, ka qenë e domosdoshme që vendet tona të punës, mësimin, argëtimit dhe ndërveprimit t'i kalojmë online thuajse të gjithë në një kohë shumë të shkurtër dhe shumë intensive. Gjasat janë që ato kompani që janë të afta të përdorin teknologjinë për të vazhduar të operojnë, ato që do të rishikojnë modelin e tyre të biznesit në kushtet e reja ku kalimi 'online' tashmë është detyrim, ato kompani që do të përqafojnë me shpejtësi transformimin digjital, janë ato që do të kenë avantazh konkurrues. Për një analizë sesi pandemia COVID-19 po përshpejton transformimin digjital të kompanive, mund t'i referoheni shkrimit të [Bernard Marr](#).

Sa të përgatitura janë kompanitë në tregun e Shqipërisë për t'ia dalë mbanë në këto kushte përmes transformimit digjital: të lejojnë punonjësit të punojnë nga shtëpia? të ofrojnë shërbime dhe të mira online? Të organizojnë eventet online? Të transformojnë rrënjësisht modelin e tyre të biznesit në kushte stresi të lartë? Natyrisht që kjo është sfida e çdo kompanie sot dhe jo vetëm e atyre shqiptare, të cilat hasin krahasimisht edhe sfida të tjera. Në studimin tim të doktoratës argumentoja se digjitalizimi i biznesit ndikon pozitivisht performancën e përgjithshme të sipërmarrjeve të mesme dhe të vogla (SME) në Shqipëri, por përgatitja e tyre për digjitalizim luan një rol vendimtar dhe në mungesë të kësaj përgatitjes impakti i digjitalizimit është i kufizuar. Madhësia, vjetërsia dhe vendndodhja e SME-ve ndikojnë performancën dhe janë të ndërlidhura me digjitalizimin më shumë sesa ekzistenca e strategjive për digjitalizim. Gjithashtu, karakteristikat sipërmarrëse të pronarëve apo manaxherëve të SME-ve gjithashtu ndikojnë nivelin e digjitalizimit. Të pasurit e një plani biznesi të qartë gjithashtu është i rëndësishëm sa i takon përdorimit të teknologjisë. SME-të në Shqipëri janë një pjesë shumë e rëndësishme e ekonomisë kombëtare dhe studime të ndryshme kanë treguar se ka një interes në rritje për digjitalizimin e proceseve dhe praktikave të punës, por inovacioni është ende në nivele relativisht të ulta për shkak të kufizimeve në burime financiare dhe njerëzore. Në kushtet e pandemisë, digjitalizimi nuk është një zgjedhje, por duket më tepër si një mundësi për mbijetesë dhe për të patur avantazh konkurrues në treg. Në këtë drejtim SME-të kanë një avantazh të madh, ato janë fleksible dhe lehtësisht të përshtatshme me ndryshimin dhe kur këto karakteristika kombinohen me një pronar apo menaxher vizionar atëherë SME-të tentojnë të ecin më shpejt drejt digjitalizimit. Megjithatë, jo çdo veprimtari mund të kalohet lehtësisht online. Le të marrim për shembull rastin e bizneseve të vogla, shpesh edhe familjare, të kafeneve, bareve apo restoranteve, që u gjuhëzuan nga shpërthimi i COVID-19. Një analizë me vlerë për këtë bëhet nga [Reporter.al](#).

Disa nga efektet kryesore negative të pandemisë për SME-të deri më tani janë pa-afhtësia e bizneseve për të shërbyer, prodhuar apo për të vizituar klientët e tyre; rënia e madhe e shitjeve; vështirësia për të shlyer detyrimet; pezullimi i marrëveshjeve apo planeve të reja për 2020. Është e paqartë se sa do të zgjasë kjo pandemi, pasi nuk ka ende një vaksinë për ta luftuar atë, as ndonjë terapi të aprovuar për të ngadalësuar veprimin e virusit në trupin e njeriut. Ajo që duket të jetë e qartë tashmë është se COVID-19 do të ndikojë në mënyrë rrënjësore në shumicën e bizneseve dhe ky ndikim nuk është aspak afatshkurtër. Kështu që bizneset duhet të përgatiten. Ajo çka mund të thuhet tani në një analizë paraprake është që transformimi digjital i përshpejtuar nga pandemia COVID-19 do t'i jap një shtysë edhe më të madhe ekonomisë digjitale.

Që tani ka edhe disa sinjale pozitive. Disa efekte pozitive të situatës ku gjendet biznesi sot në kushtet e pandemisë dhe të sforcimit për të qenë online, janë: aftësia në përmirësim e sipër për të punuar nga distanca dhe online me kolegë e bashkëpunëtorë; njohja e gjerë e vlerës dhe rëndësisë së transformimit dixhital dhe teknologjisë së informacionit midis të gjithë punonjësve dhe sidomos midis pronarëve apo menaxherëve, të cilët duhet të mendojnë për modele të reja biznesi; përdorimi i gjerë i marketingut digjital, shitjeve online dhe takimeve virtuale si instrumenta për zhvillimin e biznesit. Nëse SME-të do të duan të kenë sukses në performancën e tyre, atëherë do të duhet të përqafojnë teknologjinë në shumë dimensionet e saj. Përshpejtimi i transformimit digjital duhet të shoqërohet me masa për të mos thelluar hendekun si pasojë e tij.

Deri më tani janë realizuar disa studime lidhur me përdorimin e teknologjisë në biznese në Shqipëri, megjithatë situata e krijuar nga pandemia COVID-19 kërkon një vlerësim të plotë të kapaciteteve institucionale dhe njerëzore që kanë SME-të në vend për tu digjitalizuar dhe mbi të gjitha për ta përbrendësuar përdorimin e teknologjisë jo thjesht në rast emergjence, por në proceset e tyre të përditshme. Kështu ekspertët, qendrat kërkimore, institucionet akademike, organizatat ombrellë të bizneseve, dhomat e tregtisë, donatorët dhe aktorë të tjerë mund të bashkojnë forcat për të realizuar një vlerësim të tillë që do të informonte më tej modelet e reja të biznesit në një botë të re post-COVID-19.

Perspektiva e ndryshimit dhe e ardhmja jonë e përbashkët!

| Mar 25, 2020 | [Blog-Debati](#) | [Elda Zotaj \(Bushati\)](#)

Çdo ditë e më shumë mes qarqeve shkencore, akademike e më gjerë po përforcohet ideja se bota pas **pandemisë COVID 19** nuk do jetë më e njëjtja, dhe se kjo ngjarje ka për të ndikuar në mënyrën sesi ne kemi organizuar shoqëritë tona, sesi i jemi imponuar planetit dhe mbi të gjitha mënyrës sesi ne jemi pozicionuar në rolin e krijuesit. E gjitha kjo, triumfi i shoqërisë njerëzore bëhet krejt e brishtë nën efektin e një virusi vdekjeprurës. Ajo çfarë u përshfaq nga një ngjarje e tillë ishte tronditja jonë si shoqëri njerëzore që me gjithë arritjet e larta në çdo fushë, sfidën më të madhe e kemi nga kërcënimet që i vijnë species tonë që nga armët bërthamore, rendi ekonomik dhe së fundmi përballja me virusin COVID 19.

Padiskutim, që situata në të cilën ndodhemi sot është e paprecedentë. Ajo është e tillë jo për faktin që nuk ka patur kriza, katastrofa natyrore, luftëra, epidemi etj, por për mënyrën sesi ne po e përballojmë atë. Kufizimet e marra në emër të sigurisë dhe jetës nuk janë pjesë e ndonjë skenari të ndonjë filmi në Hollivud, jo aspak, janë pjesë e ditëve që secili nga ne po kalon realisht. Sa hap dhe mbyll sytë u zëvendësua komoditeti i lirisë së lëvizjes, i jetës së mirë me kufizime dhe rregulla të rrepta, padiskutim të domosdoshme, por të paimagjinuara dhe tashmë realitet. Dhe ja, sot, të gjithë jemi më shumë se kurrë në kohën kur duhet të qëndrojmë më shumë me vetveten, kemi mundësinë dhe detyrimin që të analizojmë atë që na rrethon. Të mendojmë në heshtje se çfarë është ajo që duam për veten dhe fëmijët tanë. Kjo pandemi do kalojë por jo pasojat e saj, ato do të mbeten gjatë... pasojat do jenë sa ekonomike, politike, sociale, shpirtërore po aq dhe vlerore. Shoqëria jonë, ka nevojë për një reflektim të thellë mbi sistemin e vlerave, ka nevojë të reflektojë dhe ndryshojë qasje ndaj rendjes së verbër drejt një konsumimi pa fre, drejt lakmisë pa kufij, drejt pasurimit ekstrem, në emër të gjithshkaje madje dhe vetë jetës. Siç do shprehej Lubonja: “Njeriu ka nevojë të ngadalësojë”, të reflektojë, ka detyrën madhore atë të përmirësimit të vazhdueshëm të vetes dhe të krijojë dhe respektojë ekuilibrat që natyra i vendos me aq mjeshtëri për miliona e miliarda vjet.

Bota do ndryshojë dhe kjo nuk ka më kthim. Pamjet me satelit që kanë bërë xhiron e botës tregojnë se cilësia e ajrit po pëmirësohet në Kinë e më gjerë si pasojë e masave të izolimit nga Covid 19, janë një sinjal i fort për secilin nga ne. Ky virus, dëshmoi faktin që “zhvillimi i qëndrueshëm” nuk është i pamundur. Shumë nisma në nivel global janë marrë për të përmirësuar jetën e njerëzve, për të zbutur hendekun e madh të pabarazisë në nivel botëror. Ambicje e madhe është për të gjitha shtetet angazhimi dhe realizimi i “Axhendës 2030” dhe objektivave të saj. Është fakt që bota në të cilën jetojmë është e ndërlidhur si asnjë herë tjetër, të tilla janë dhe pasojat e saj. Ato vijnë si një zinxhir që një e nga një i lidh të gjithë. Njerëzit përmes kësaj tragjedie po kthejnë sytë dhe do kuptojnë që sistemi i vlerave të një shoqërie nuk është konsumizmi në emër të gjithckaje, jo nuk është kjo, është egzistenca në harmoni me atë që është e tëra. Të pasur dhe të varfër, intelektualë dhe të paditur të gjithë sëbashku janë të kufizuar në ekstrem në liritë e tyre personale, të gjithë janë pjesë e masës kufizuese dhe distancimit social, të gjithë ne jemi papërrjashtim... Sikundër shprehet **Luigi Mastrodonato**: “Në këto kohë të pandemisë, shumë të drejta janë pezulluar, dhe privatësia po vihet në dyshim. Në fakt, demokracia është pezulluar...”.

Pavarsish kontekstit të krijuar si pasojë e koronavirusit, shoqërisë shqiptare më shumë se kurrë i nevojitet të analizojë dhe debatojë mbi hapat që do të ndjekë për të ardhmen e saj. Ruajtja e natyrës dhe e resurseve natyrore, përmirësimi i jetës së njerzve dhe i gjithë shoqërisë etj. Jo më larg se dje, një lajm i mirë për Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut ka ardhur nga institucionet e BE-së. Çelja e negociatave është një mundësi e madhe për të ndryshuar dhe përmirësuar, shtetin, shoqërinë dhe të ardhmen tonë. Statusi i ri i vendit tonë përballë Bashkimit European kërkon më shumë angazhim, punë dhe padiskutim debat më të gjerë përpos arritjes së standarteve të kërkuara për institucionet të jetë real dhe konkret ndryshimi cilësor i jetës në vend.

A po zhvilloni aftësi që nuk do të robotizohen?

| Mar 25, 2020 | [Blog-Debati Përshtatur nga Liburnetik](#)

E ardhmja e të punuarit duket e zymtë për shumicën e njerëzve. Qendra e studimeve *Forrester* ka vlerësuar së fundmi që këtë vit, 10% e profesioneve në SHBA do të zëvendësohen nga makineritë, dhe një tjetër studim nga qendra *McKinsey* ka rezultuar që përafërsisht gjysma e profesioneve në SHBA mund të zëvendësohen nga makineritë dekadën e ardhshme.

Llojet e profesioneve që ka te ngjarë të zëvendësohen nga makineritë janë ato profesione rutinë dhe që i përmbahen një skeme te caktuar pune. Ato variojnë që nga leximi i rrezeve X (së shpejti, imazheristët mund të kenë një rol më të kufizuar, pra mund të zëvendësohen lehtësisht nga makineritë në leximin e këtyre rrezeve), vazhdojnë me drejtimin e kamionëve dhe deri tek magazinimi i depove .

Tëksa shumë shkruajnë për llojet e profesioneve që ka te ngjarë të zëvendësohen plotësisht, një tjetër teori që ende nuk është studiuar në detaje është që të mos e përqëndrojmë hulumtimin tonë tek profesionet që do të zëvendësohen plotësisht por të interesohemi më tepër se proceset e cilave profesioneve që nuk janë robotizuar akoma do të zëvendësohen nga makineritë.

Le të marim si shembull profesionin e mjekut: Është më se e qartë se diagnostikimi i sëmundjeve, së shpejti do të realizohet më mirë nga makineritë sesa nga njerëzit. Kur kemi në dispozicion grupe të dhënash për trajtim dhe testim, mësimi nga makineritë është tmerrësisht efektiv sepse bëhet fjalë për një gamë të gjerë sëmundjesh. Mirëpo, le të provojmë të ulemi me familjen dhe të diskutojmë mbi mënyrat e mjekimit të një sëmundjeje? Ka shumë pak të ngjarë, që kjo aftësi të zëvendësohet nga makineritë në një të ardhme të afërt.

Tani le të marim si shembull një profesion krejtësisht të ndryshëm nga ai i mjekut: atë të baristit. Në kafenenë X të San Franciskos, të gjithë baristët janë zëvendësuar nga krahë robotikë fabrike, të cilët argëtojnë klientët me sjelljet e tyre të çuditshme ndërkohë që përgatisin pijë. Megjithatë, edhe kafeneja X ka punësuar një njeri që iu mëson klientëve se si të përdorin teknologjinë për të porositur pijet e tyre dhe për të zgjidhur problemet që ato mund të hasin me baristin-robot.

Ka një ndryshim midis të qenurit barist me të qenurit banakier. Njerëzit shpesh janë të prirur të fillojnë të bisedojnë me banakierin. Kjo punë është më shumë se të qenurit thjesht një “përzierës pijesh”. Njësoj si me mjekun, lehtësisht ne mund ta analizojmë këtë profesion në dy pikëpamje;

-pikëpamja e profesionit rutinë dhe që i përmbahet një skeme të caktuar (përzierja dhe shërbimi i pijeve) dhe-pikëpamja ndërvepruese (situatë e paparashikueshme në të cilën banakieri bisedon me klientet).

Pas analizimit të karakteristikave të një shumëllojshmërie punësh dhe profesioneve, dy lloje “punësh” janë për mua të veçanta dhe të vështira për tu zëvendësuar nga makineritë:

Së pari, emocionet. Emocionet luajnë një rol të rëndësishëm në komunikimin midis njerëzve (kujtojmë mjekun teksa shtronte bisedën me familjen, ose banakierin që ndërvepronte me klientët). Praktikisht, emocionet janë të përfshira në të gjitha format e komunikimit jo-verbal dhe në ndjeshmërinë e individëve. Por, më tepër se kaq, na ndihmojnë që ti japim përparësi asaj që bëjmë, p.sh na ndihmojnë të vendosim se çfarë është primare për tu bërë *tani*, dhe çfarë mund të shtyhet për *më vonë*. Përveç faktit që janë të ndërlikuara dhe të koklavitura, emocionet tona ndërveprojnë së shumti në proceset tona vendimmarrëse. Ka qenë një proces sfidues të kuptohej shkencërisht funksionimi i emocioneve, dhe është e vështirë që ato të robotizohen.

Se dyti, struktura. Kur marrin vendime, ose kur ndërveprojnë me të tjerët, njerëzit lehtësisht mund të marrin parasysh strukturën e vendimmarrjes apo të ndërveprimit. Duke qenë së është e hapur, struktura është veçanërisht interesante -për shembull, sa herë që jepen lajmet, ndryshon struktura në të cilën ne veprojmë. Për më tepër, ndryshimet në strukturë (psh zgjedhjet për një president që nuk mbështet asnjë parti) përveçse ndryshimit të mënyrës sesi faktorët ndërveprojnë me njëri tjetrin, mund të sjellin edhe risi në faktorë dhe të rikonfigurojnë organizimin e problemeve në mënyre financiare. Kjo përben një problem në mësimin e makinerive, pasi ato operojnë në grupe të dhënash që janë krijuar fillimisht sipas strukturave të ndryshme. Prandaj, marrja parasysh e një strukture është sfidë më vete për robotizimin.

Marrja parasysh e strukturës, dhe aftësia jonë për të menaxhuar dhe vënë në punë emocionet, janë elementët kyç të mendimit kritik, zgjidhjes kreative të problemeve, komunikimit efektiv, të të mësuarit teknik dhe të një gjykimi të shëndoshë. Është provuar se të programosh makineritë që të imitojnë njohuri dhe aftësi të këtilla njerëzore, është diçka shumë e vështirë dhe nuk është ende e qartë se kur apo nëse përpjekjet e ditëve të sotshme për t'a arritur këtë do të japin fryte.

Dhe në fakt, këto janë aftësitë që punëdhënësit e punëve sistematike kërkojnë tek kandidatët për punë. P.sh në një studim, 93% e punëdhënësve, deklaruan se “kapaciteti i të menduarit në mënyrë kritike të një kandidati për punë, komunikimi i qartë dhe zgjidhja e problemeve komplekse është më e rëndësishme sesa një diplomë universitare”. Përveç kësaj, punëdhënësit kërkojnë kandidatë që kanë spikatje të “aftësive të buta”, sic është të qenurit i aftë për të mësuar në mënyrë adaptive, marrja e vendimeve të duhura dhe të pasurit një mardhënke të mirë pune me të tjerët. Këto aftësi të spikatura futen tek gjërat që njerëzit mund ti bëjnë lehtësisht, por janë dhe do mbeten të vështira për t'u përvetësuar nga makineritë.

E gjithë kjo na udhëheq drejt sugjerimit që sistemet tona arsimore duhet të përqëndrohen jo thjesht në mënyrën sesi njerëzit ndërveprojnë me teknologjinë, por edhe sesi mund të bëjmë gjërat që teknologjia nuk do t'i bëjë edhe për disa kohë. Kjo është një qasje e re për të tipizuar natyrën themelore të “aftësive të buta”, te cilat me gjasë janë emërtuar gabim:

Këto janë aftësitë më të vështira për t'u kuptuar dhe për t'u përvetësuar nga truri ynë dhe që i kanë pozicionuar dhe do të vazhdojnë t'i pozicionojnë njerëzit një shkallë më lart se robotët.

Lexoni artikullin në [origjinal](#)

Po me arsimin çdo bëhet?

| Mar 25, 2020 | [Blog-Debati Nevila Xhindi](#)

Të gjithë, këto ditë, si kurrë më parë jemi përballur me distancën: punë në distancë, biseda në distancë, mësim në distancë, distancë sociale, distancë fizike, distancë të blesh bukë etj etj...duket sikur koha e “online” ka “dhunuar” kohën e vërtetë atë me minuta e orë, atë të takimit e shoqërizimit me miq e kolegë.

Çerdhe, kopshte, shkolla, universitete...të mbyllura! Fëmijë e studentë të gjithë në shtëpi, me librat mbi kokën e krevatit apo mbi komodinë dhe me laptopin përpara këmbëve. Duket një pamje klishe, si në ato filmat që kemi parë aq shumë, prodhuar nga kompani të mëdha Hollivudiane.

Ndërsa shumë shpejt u “lëshuan” nga Ministria e Arsimit masat e para të mësimin online, megjithëse të vetëdijshëm për mundësi reale gati të pamundura, edhe mësueset bënë të njëjtën gjë me ne prindërit email, whatsapp, viber...duhet të rifillojë mësimi virtual!

Ky është padiskutim momenti I vërtetë I provës së milionave para të shpenzuara për dixhitalizim e mësim online të arsimit Shqiptar! Fatkeqësisht, si taksapagues, jemi ne hallka e fundit te zinxhiri I provës! Është provë jo e lehtë për ne familjarët, as e lirë jo e jo, sepse ca të vërteta duhen thënë, që jo të gjithë e kemi mundësinë e 24 orëve internet të qëndrueshëm e për më tej na duhet një laptop apo celular smart.

Çfarë do bëhet me arsimin në Shqipëri në këtë dritë të re të zhvillimeve?

Procesi arsimor online po ecën në një korsi të përshpejtuar për shkak të pandemisë së COVID-19, por pasojat e kësaj shpejtësie nuk i dimë ende, ama shumë pyetje ngrihen për më tutje si dhe për mundësitë për ti adresuar ato. Ashtu si edhe për ekonominë, eksperimenti gjigant i arsimit online do të përshpejtojë ndryshimet që ishin tashmë në lojë. Unë vetë jam duke e provuar eksperimentin e mësimin online si prind dhe si pedagogje universiteti, dhe e them me zë: është sfidues!

Koha e qëndrimit në shtëpi për shkak të distancës shoqërore e fizike më ka mundësuar që të mendoj dhe të ngre disa pyetje rreth arsimit dhe të ardhmes së tij ndërsa merremi me COVID-19-n.

A është arsimi një çështje për diskutim ashtu si edhe ekonomia? Pse nuk po flitet për të? A na e dha mësimin ky virus që tashmë ne na nevojitet të rishohim me kujdes strategjinë e arsimit në Shqipëri, ligjin, aktet nënligjore? A është edukimi dhe mësimi e njëjta gjë? Si duhen trajtuar ato? A ka qenë zhvilluar deri më tash mësimi në një mjedis fizik tepër të ngurtë? A duhet të mendojmë më shumë për një kurrikul dinamike, interactive, krijuese me më shumë art, sport, ku shëndeti fizik dhe mendor I nxënësit të jetë në qendër? A ishin mësuesit tanë gati? A kishim menduar apo duhet të fillojmë të mendojmë seriozisht për trainimin e tyre të vazhdueshëm, dhe jo vetëm të trainojmë drejtorët (ndonëse edhe këtu ka shumë vend për diskutim). A duhet ndonjëherë tu themi faleminderit për përkushtimin dhe fleksibilitetin këtyre mësuesve që jetojnë, punojnë e u duhet të përshtaten sipas orekseve politike të rradhës? Dhe mbase pyetja më e madhe nga të gjitha: Cilat janë implikimet në arsim në lidhje me ngarkesat aktuale të borxhit?

Të gjitha këto pyetje më dalin përpara, ndërsa përballemi me këtë kurs të ri jetese, përplasjeje në mësimin dixhital, ...por nuk do të pretendoj që e vetme e di zgjidhen e tyre. Gjithsesi do të argumentoja që rimarrja në konsideratë e këtyre pyetjeve për të siguruar përgjigje që vlejné për dekadat e jo për ciklin politik partiak, ka të ngjarë të sillet rreth mësimin të vazhdueshëm.

Si të gjitha zhvillimet e teknologjisë dhe përpjekjet e transformimit, sfidat më të mëdha zakonisht përfshijnë ndryshimin kulturor. Mësimi online kërkon disiplinë. Edukimi gjithashtu kërkon disiplinë. Ky realitet do të favorizojë atë lloj nxënësi apo studenti që do të dijë të krijojë një rutinë të “online” në oraret e tjetërsuara sociologjikisht të kohës së vërtetë.

Nëse popullata do të mësohet me të mësuarit dixhital, do të bëjë që më shumë gjasa të përpilohen politikat dhe burimet për ta mbështetur atë. Platformat shkollore online do të kthehen në prioritet gjithmonë e më shumë, pavarësisht sesa interesante na janë dukur më pare. Mësimi do të dixhitalizohet, librat shkollorë (letër) do të kenë çmim të lartë. Ky ndryshim i procesit do të thotë që shkollat do të investojnë shumë në dixhitalizim, dhe kjo kërkon një gjeneratë të re mësuesish, inxhinierë, sociologë, psikologë...krejt ndryshe sa ishte menduar më pare...dhe shumë, po shumë para!

Publikuar fillimisht tek [Exit.al](#)

Evropianizimi i Ballkanin Perëndimor: – Prespektivat që duhen konsideruar

| Mar 25, 2020 | [Blog-Debati Adela Danaj](#)

Krahas pritshmërive të mëdha, të krijuara në më shumë se një dekadë me parë, në mesin e politikë-bërësve dhe studiuesve të Ballkanit Perëndimor, besohet se BP do të përsëriste historinë e suksesit Evropian duke u përfshirë në BE falë politikave zgjeruese të kësaj të fundit. Megjithatë, sot literatura kontemporane mbi Evropianizimin e Ballkanit Perëndimor, sygjeron se Evropianizimi i BP është i cekët si rezultat i sfondit historik, gjeografik, politik dhe ekonomik të rajonit përkundrejt sfondit dhe qasjeve të strategjive të BE-së, të cilat shpesh janë të paqarta. Vendi që duket se është në kundërshtim me këtë qasje pesimiste dhe tenton të bëjë përparim drejt evropianizimit, duke nxitur bisedime të here pas herëshme, është Shqipëria. Ky shkrim shtron pyetjen: Çfarë duhet të llogarisim kur diskutojmë evropianizimin e Shqipërisë? Kjo pyetje lind nga: (i) ngjarjet e fundit ku Shqipëria dhe Republika e Maqedonisë së Veriut pranohen si vende për të hapur negociatat; (ii) nevoja për ta vendosur Shqipërinë në një kontekst më të gjerë brenda Ballkanit Perëndimor. Kjo do të thotë që, krahas entuziasmit për hapjen e negociatave, duket se duhen hulumtime të thelluara që shqyrtojnë disa faktorë.

(I) Faktorët e brendshëm. Duket se në këtë moment duhen analizuar motivimet, mirëkuptimet dhe kufizimet e njerëzve që janë duke punuar ngushtë në bisedimet e pranimit dhe procesin e integritit evropian. Pra, ndoshta nuk është momenti për të diskutuar efektivitetin e strategjive të përdorura nga BE për të lehtësuar përhapjen e normave të BE-së dhe miratimin e rregullave, por duke synuar që procesi i Evropianizimit të Shqipërisë të përfundojë me sukses, duhen marrë në konsideratë faktorët e lartë-përmendur. Kjo sepse, duket se rregulli i 'politikave të përshtatura' sipas modelit evropian, po ecën shpejt (për sa kohë negociatat u hapën), por nga krahu tjetër, kjo qasje influencon kapacitetet njerëzore dhe administrative në inkurajimin e ndryshimeve të brendshme strukturore edhe institucionale. Nëse ky është një proces i lehtë për nënpunësit e përfshirë në proces, atëherë duhet të jemi të informuar dhe mbi të gjitha të sigurtë, në lidhje me zbatimin real të reformave dhe rregullave të miratuara.

(II) Prania e *idesë evropiane* duke se ka luajtur një rol thelbësor në procesin e hapjes së negociatave të BE-së me Shqipërinë. *Ideja Evropiane* si brenda elitave të brendshme politike ashtu edhe në shoqërinë e gjerë ka ndihmuar procesin në fjalë. Megjithatë, theksi duhet të vihet në faktorët e mëposhtëm vendas që inkurajojnë procesin e evropianizimit, përfshirë: praninë e *idesë evropiane* për sa i përket konsensusit të gjerë politik dhe konsensusit shoqëror mbi procesin e integritimeve evropiane, legjitimitetin e të gjithë procesit të integritit në BE dhe legjitimitetin e rregullave, normave dhe standardeve të BE-së nga të gjithë aktorët vendas politik e shoqëror.

(III) Po me kaq vëmendje dhe interes duhet të kryhen vëzhgime mbi stabilitetin politik në vend, ku duket se kemi një mungesë të lojtarëve me të drejtë *veto*, që gjithashtu luan rol thelbësorë në rritjen e besueshmërisë mbi prespektivat e anëtarësimit të vendit. Përse duhet kjo? Heather Grabbe (2003) argumenton se gjithmonë ekziston një nivel pasigurie në vendet candidate në lidhje me pyetjen se kë tjetër duhet të kënaqë politika vendase për të shmangur ngërçet në rrugën drejt anëtarësimit në BE. Kjo sepse, varet nga lojtarë të ndryshëm me të drejtë *veto*, si shtetet anëtare të BE-së, Komisioni Evropian ose Këshilli Evropian që do të thotë se 'ekziston edhe një pasiguri afatgjatë se kush mund të shfaqet si lojtar i vetos mbi

një tjetër' dhe ndoshta kjo është një çështje që duhet marrë në konsideratë që në këtë moment në mënyrë që të mos dalë si e papritur gjatë procesit'[\[i\]](#).

(IV) Një tjetër objektivi i këtij shkrimi është nevoja për të treguar se për vendet e Ballkanit Perëndimor duhet shkruar përtej qasjes 'një-madhësi i përshtatet të gjithave'. Duhet një kontekstualizim i thellë i secilit vend të Ballkanit Perëndimor si për kandidatët ashtu edhe për kandidatët e mundshëm, duke parë faktorët aktualë vendas që luajnë rol kyç në inkurajimin ose jo, të gjithë procesit të integritimit në BE. Në këtë drejtim, besueshmëria mbi procesin e anëtarësimit dhe numri i lojtarëve të vetos, marrin edhe një herë vlerë. Sigurisht, nuk është qëllim i këtij shkrimi të gjenerojë përfundime krahasuese midis Shqipërisë dhe pjesës tjetër të Ballkanit Perëndimor, por synon të nxisë debat nën këtë prespektivë. Për shembull, evropianizimi i Republikës së Maqedonisë së Veriut[\[1\]](#) nuk mund të shihet në të njëjtën dritë me evropianizimin e Shqipërisë pasi vendi ka mosmarrëveshje bilaterale me Greqinë që krahas hapjes së negociatave, është e dukshme që do të krijojë ngërçe në integrimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në BE, megjithëse dhe aty është e pranuar gjersisht *Ideja Evropiane* në mesin e elitave politike dhe shoqërisë brenda vendit.

Duke ndjekur këtë linjë, mund të konkludohet se për të patur histori suksesi për evropianizim e Ballkanit Perëndimor, zgjidhja më e dukshme qëndron në rritjen e besimit të gjithë procesit të zgjerimit, i cili njëkohësisht paraqet një faktor stabilizues brenda Ballkanit Perëndimor.

Megjithatë, nuk ka asnjë dyshim se hapja e bisedimeve si për Shqipërinë ashtu dhe për Republikën e Maqedonisë së Veriut, e lehtëson procesin e evropianizimit, pasi BE paraqet garanci për vendet që afrojnë, duke siguruar se këto vende janë të gati të punojnë më tej në përputhje me qasjet dhe prespektivat evropiane në sektorë si: ligji, ekonomia, qeverisja dhe reforma e administratës publike. Për më tepër, hapja e bisedimeve të pranimit dhe zgjidhja e çdo pengese në rrugën drejt Integritimit Evropian do të forcojë bashkëpunimin rajonal, si dhe do të lehtësojë procesin e përgjithshëm të evropianizimit dhe zgjerimit të BE gjë që është e dobishme si për BE-në ashtu dhe për Ballkanin Perëndimor, si rrugë e sigurtë që shkon drejt prosperitetit, paqes dhe stabilitetit.

[\[1\]](#) Republic of Macedonia is a candidate country for the EU since 2005, and despite the several recommendations of the European Commission to open accession talks, the European Council still haven't decided to open accession talks because of the bilateral name dispute with Greece.

[\[i\]](#) Heather Grabbe, "Europeanization goes East: Power and uncertainty in the EU accession process", in *The Politics of Europeanization*, ed. Kevin Featherstone and Claudio M. Radaell, (Oxford: Oxford University Press, 2003), 322.

Korona Virus në përpasjen e Lindjes me Perëndimin

| Apr 1, 2020 | [Blog-Debati](#) | [Marlin Muça](#)

Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës

Marrëdhëniet ndërkombëtare të pas Luftës së Parë Botërore dhe deri sot bazohen në një koncept të njohur si siguria e përbashkët (collective security). Ky parim i rezistoi Luftës së Dytë Botërore dhe garantohet sot nëpërmjet një rrjeti kompleks organizatash ndërkombëtare dhe konventash, më të rëndësishmet ndër to si Aleanca e Atlantikut të Veriut (NATO), OKB, Bashkimi Europian dhe organet e saj me fokus sigurinë, OSBE dhe shume e shume mekanizma të tjera. Synimi i institucioneve që vënë në jetë parimin e sigurisë së përbashkët është ruajtja e paqes dhe status quo-s, në mënyrë që asnjë shtet apo grup shtetesh të mundën të çënojë sovranitetin e një shteti tjetër e për rrjedhojë dhe paqen e mbarë njerëzimit.

Aktorët shtetërore që kanë kërcënuar paqen e globit janë qënë jo të paktë këto 100 vitet e fundit. Perandori, ideologji, aleanca me në thelb ekstremizmin irridentizmin dhe imperializmin politik e ushtarak janë ndeshur me aleanca e grupe të tjera shtetesh në mbrojtje të sovranitetit, lirisë dhe demokracisë vetëm për të humbur si pasojë e diferencave në resurse dhe vendosmerisë se atyre që me të drejtën mbronin atdheun dhe lirinë e tyre. Mirëpo rreziku i kësaj sigurie nuk vjen vetëm nga luftërat e nxitura prej aktorëve shtetërore dhe aleancave të tyre. Në epokën kur jetojmë ekzistojnë dhe disa rreziqe mikroskopike, të afta për të gjuhëzuar shtete të tëra pa nevojën e armëve bërthamore apo fushatave masive ushtarake. Tre muajt e fundit një pjesë e madhe njerëzimit vuan efektet e Covid 19, një virus që shkakton pneumoni. Shkenca nuk ka arritur ende të prodhojë një vaksine apo kure trajtimi për të infektuarit.

Kjo pandemi kërkon bashkëpunimin e të gjitha shteteve palë në konventa ndërkombëtare apo anëtare të organizatave me fokus sigurinë dhe jo vetëm. Koha kur jetojmë është provë e gjalle e efektivitetit të sistemit ndërkombëtar që qeveris marrëdhëniet ndërkombëtare. Përvetse provë e zotimeve të veta ligjore dhe morale, kjo periudhë do të rezultojë të jetë dhe vendimtare për sfidën serioze që Kina dhe Rusia i kanë bërë kohezionit, fuqisë dhe integritetit të Qytetërimit Perëndimor dhe interesave të tij në të gjithë botën. Deri më sot, gjasat janë që brenda këtij qytetërimi ka një carje të madhe që rrezikon të hedhë poshtë jo vetëm ngrehinën e Bashkimit Europian por shumë më tepër nga aleancat tradicionale e vendeve europiane me njëra tjetrën dhe marrëdhëniet e tyre me Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Shpërthimi viral i pandemisë i bëri njerëzit të harrojnë se janë qytetarë të lire të “Europës”. Papritmas ëndrra e një Europe të bashkuar politikisht ra pre e pamundësi së BE për të adresuar në mënyrë adekuate nevojat dhe urgjencën e shoqërive të prekura rëndë nga efektet shkatërrimtare të virusit. Ashtu si ne fatkeqesite e tjera natyrore, njerëzit ju kthyen Shtetit të tyre për ndihmë, jo një organizmi politik të largët dhe të centralizuar në Bruksel. Këto shtete, nën trysninë shqetësuese të krizes së pandemisë mbyllën kufijtë, kufizuan lirinë dhe të drejtat e qytetarëve me ligj e c`është më e habitshmjia treguan pak ose aspak solidaritet me shtetet e tjera simotra që vuajne po të njëjtën krizë virale në popullin e tyre. Ëndrra e Europës së Bashkuar politikisht u venit nga realpolitika e shekullit të ri që po lind dalëngadalë nga rrënojat e një ëndrre tjetër që po vdes e që lindi në shekujt e kaluar.

Vakumin e Bashkimit European dhe mungesën e solidaritetit të shteteve karshi njera tjetrës e zëvendësuan Kina e Rusia, dy vende me një plan të qartë politik për ta shtrirë influencën e tyre në tregjet më të mëdha të botës.

Prej disa muajsh, nën iniciativën e Presidentit Xi Jinping, Kina ka ndërmarrë një projekt ekonomik tejet ambicioz të pagëzuar si “Belt and Road“ initiative. Ky projekt ka për synim shtrirjen e influencës ekonomike kineze kudo në Botë me synimin e qartë për ta përkthyer në një të ardhme të afërt në influencë politike. Përhapja e teknologjisë 5g nëpërmjet kompanise Huawei që ka shërbyer si kompania flagship e këtij projekti është jehona më e afërt e iniciativës së re kineze në Europën Perëndimore.

Pavarësisht problemeve ekonomike që kriza e virusit po krijon dhe do të krijojë në ekonominë kineze, ky projekt pritet të jetë gjurma kryesore ekonomike dhe financiare në botë e një Kinë që pritet të rivalizojë në të gjitha fushat Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe partnerët e saj. Kriza e Korona Virusit nuk e ka ndaluar Kinën të rrisë prezencën në Europë dhe Azi duke dërguar ndihma dhe personel mjekësor për të përballuar pasojat e virusit.

Nga ana tjetër, Federata Ruse nën drejtimin e Presidentit Putin prej vitesh tashmë ka ndërmarrë një fushatë të fuqishme informative që synon të dobësojë kohezionin politik të Bashkimit European duke sulmuar pikërisht bazat themelore mbi të cilën është ndërtuar Unioni. Nëpërmjet agjensive të saj inteligjente, një rrjeti të sofistikuar programesh kompjuterike dhe hackerash që fabrikojnë fake news dhe fushatave politike online, Rusia ka mundur të nxisë rritjen e ekstremeve politike në vendet e Bashkimit European, të rrisë ksenofobinë ndaj emigrantëve dhe të ulë ndjeshëm besimin e shoqërive europiane ndaj idesë së një Europe të bërë bashkë. Një Europë e përcarë përkthehet domosdoshmërisht në një Kontinent të dobët. Një Europë e dobët është një pre e lehtë e makinerisë ruse që synon ta shtrijë ndikimin e saj sa më në Perëndim, me qëllimin e largët të zvogëlimit të influencës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Europën Perëndimore. Ftohjen e shteteve europiane ndaj njera tjetrës në këtë kohë krize nuk mbeti pa e shfrytëzuar as Federata Ruse. Italia, një nga vendet me lidhje të ngushta me Rusinë qysh në kohën e Bashkimit Sovjetik, priti disa tonë ndihma mjekësore këtë javë nga vendi i cili, paradoksalisht, mbështet dhe mbyll marrëveshje si me ekstremin e djathtë Lega Nord ashtu dhe me partinë e një ekstremi të një tjetër lloji, atë të 5 Yjeve.

Ndihmat nga vende të cilat Bashkimi European dhe Shtetet e Bashkuara i konsiderojnë si problematike në qasjen që ato kanë ndaj Perëndimit, sanksionet që këto dy aktorë të fuqishëm politikë i vendosin atyre si dhe mbështetja që kërkohet nga vendet më të vogla nën një qëndrim të perbashkët shkon në përpjestim të zhdrejtë me solidaritetin që duhet treguar në një kohë kur testohen aleancat dhe partneritetet e mëdha e të qëndrueshme. Fakti që ky solidaritet mungoi i dha një alibi të shkëlqyer forcave eurospektike që duan ta shohin Europën të ndarë në shtete sovraniste. I dha gjithashtu një kazus tjetër mjeteve të propagandës ruse dhe kineze për të ushqyer më tej euroskeptizmin si dhe për të dobësuar akoma dhe më tej shtetet e brishta të një Europe të ligur. Virusi nuk do të japë fund Bashkimit European por do të ushqejë akoma dhe më kontradiktat e një organizate që i trajton hallkat e saj përbërëse si gur shahu e asgjë më tepër. Do të shëndoshë dilemat e ngjizura prej vitesh të establishmentit european se ku duan ta cojnë ëndrrën e Shumanit dhe të De Gasperit. Pandemia do të nxisë me patjetër transformimin e projektit të guximshëm european të shekullit të kaluar, përndryshe vetëm koha mund të zbulojë rezultatën e një bote shumëpolare ku edhe njëherë fatet e saj nuk do të luhen më në Europë, por gjetkë.

Pak shpresë

| Apr 3, 2020 | [Blog-Debati Iris Beqiri](#)

Një situatë sfiduese është ajo çka po jetojmë prej disa javësh. E gjithë bota po përballet me një pandemi. Kjo gjendje emergjence ndryshoi gjithë përditshmërinë tonë. Megjithatë, ka shpresë se shumë shpejt gjithçka do jetë si më parë.

Rutina nuk është më e njëjta. Ka ndryshuar mënyra e jetesës, e të mësuarit, e të argëtuarit. Ndikimi i kësaj pandemie është shumë i madh në shoqëri, në gjithë elementët e saj. Efekte të shumta do të shfaqen gjatë kësaj periudhe, por edhe më tej. Lajmet negative janë të shumta, por do të ishte mirë të mendonim pozitivisht.

Distancimi social ka edhe anën pozitive. Një prej tyre është se natyra po merr pak frymë. Prej shumë kohësh automjetet, industria, pakujdesia jonë, kanë shkaktuar shumë dëme në mjedis. Ulja e ndotjes është e ndjeshme. Për qytetet e mëdha, në të gjithë botën, kjo është një periudhë rigjenerimi.

Në këto javë vetëizolimi, shoqëria është më e bashkuar se kurrë. Jemi të gjithë së bashku në këtë situatë. Pavarësisht distancës, ndihemi më të lidhur me gjithë shoqërinë. Kjo është një mundësi për t'iu larguar sjelljeve egocentrike dhe individualizmit.

Sigurisht, kjo pandemi na bën të shohim botën ndryshe. Perceptimi ynë për politikën po ndryshon. Ekonomia dhe bizneset po sfidohen. Marrëdhënia me teknologjinë ka ndryshuar. Po përiqemi të përshtatemi në këtë realitet të ri.

Ndërkohë, të gjithë kërkojmë mënyra për të larguar monotoninë. Në këtë periudhë kemi mjaftueshëm kohë për lexuar, për libra e revista. Mund të ndjekim kurse online. Kemi mundësinë të perfeksionojmë një hobi si skicimi ose fotografia. Mund të dëgjojmë muzikë, shohim filma, etj.

E deri sa gjithë kjo situatë të përfundojë, duhet të kemi besim se çdo gjë do t' i rikthehet normalitetit.

Nacionalizmi dhe Covid-19

| Apr 3, 2020 | [Blog-Debati Erti Poka](#)

Fakulteti i Drejtësisë, UT

Padyshim që premisa kryesore e Bashkimit European jo vetëm si koncept utopik dhe në dukje shpeshherë i paarritshëm, por edhe si një praktikë, e cila ka vendosur në një sfidë të madhe shtete, të cilat kanë pranuar të jenë pjesë e kësaj familjeje homogjene në pamje, por heterogjene në realitet është që të hiqen dhe të eliminohen pikërisht këto elementë, të cilat i bëjnë shtetet të jenë të ndryshme.

Kjo gjë kërkon të rregullojë gabimet e së kaluarës duke tentuar të harrohen copëzat e mbetura gjallë të ekstremizmave të të dyja krahëve politikë, qoftë të majta, qoftë të djathta. Në teori lloji i parë i ekstremizmit zhvillohet kur problematikat janë të shumta dhe vështirë të artikulueshme dhe zemërimi është i madh e njerëzit tentojë të ndajnë me njëri- tjetrin pikërisht këtë urrejtje, ndërsa lloji i dytë i ekstremizmit ndodh kur duhet një dorë e fortë për të drejtuar ,pasi krizat janë të mëdha, por të identifikueshme e askush nuk është i aftë të ndaje me të tjerët atë që ka. Kjo është pikërisht ajo që po ndodh në këto momente.

Covid- 19, ishte prova e rradhës për durimin e liderëve për të mbrojtur interesat e vendeve të tyre e duket se kur vështirësia troket tek dera të gjithë bëhen nacionalistë e mendojnë për veten e tyre. Një pjesë e mirë e vendeve në të gjithë botën kanë mbyllur kufijtë, për shkak të mospërhapjes së virusit, por duket se dalëngadalë po mbyllin edhe kufijtë e asaj se çfarë janë të gatshëm të pranojnë. Italia, vendi jonë fqinj, ka hasur në ndalesa të shumta doganore të materialeve kundër luftës ndaj Covid-19, Bashkimi European nuk është treguar aq bashkëpunues sa në situata të tjera tragjedish natyrore ose njerëzore, duke dhënë një mesazh të heshtur të shprehjes: “Të gjithë për vete, Zoti për të gjithë.” Por, të gjithë jemi koshientë se gjeopolitika, kërkon diplomaci e çdo shtet mundohet ta mbulojë sadopak këtë parim, nëpërmjet të cilit po qeveriset në këto momente.

Padyshim që çdo vend po përballet në një shkallë të ndryshme me këtë pandemi globale, e cila ka ndaluar aktivitetin human në një shkallë të lartë, por padiskutim të ndryshme për çdo vend, ama diçka është e sigurtë, që aleatët e vërtetë njihen në kohë të vështira. Për fat të keq në një periudhë të tillë vështirësish ku nevojtarët janë të shumtë e ofruesit të paktë duket se marrëdhëniet diplomatiko- shtetërore, jo vetëm nuk i interesojnë përmirësimit të marrëdhënieve, por thjesht shpalosin anën egoiste të gjithësecilit, e cila padyshim që është e justifikuar në një situatë të tillë. E kur rrethanat përcaktojnë zgjidhjet, janë të pakta ato që mund të bëhen për të arritur në një balancim të situatës.

Gjithmonë krizat kanë prodhuar ekstrem, e me fuqizimin e ekstremistëve nacionalistë në Europë viteve të fundit për shkak të ardhjes së shumtë në numër të emigrantëve të paligjshëm, madje edhe në shtetet tona fqinje, duket se një situatë e tillë krize ku çdokush “mendon për veten” ka favorizuar fuqizimin e ideologjive nacionaliste. Shumë individë e shohin të arsyeshme një logjikë të tillë, ku secili mendon për vete, po kjo nuk është aspak pranë premisave të Bashkimit European, i cili si qëllim kryesor ka pikërisht shuarjen e nacionalizmit, nëpërmjet krijimit të një formacioni të përbashkët shtetëror, e nëse kjo tingëllon shumë utopike, të paktën krijimin e një ambienti, i cili kultivon vlerat e përbashkëta e jo diferencat, të cilat për hir të së vërtetës janë të dallueshme.

Mbyllja e kufijve fizikë, do pasojë edhe një mbyllje të kufijve intelektualë, duke bërë që kombet të mendojnë në vetën e parë. Sa herë globi përplasat me luftën për mbijetësë, instiktet “survival” dalin në pah duke i bërë të ditur të gjithëve, se konflikti shmanget, vetëm duke shmangur kontaktin, pra me pak fjalë urën e vetme të një marrëdhënieje të mirë, për të cilën Bashkimi European ka investuar kaq shumë kapital intelektual e ekonomik.

Përsa kohë Covid- 19 të jetë shqetësimi kryesor i qytetarëve, askush nuk do të mendojë më për të mbështetur prirje “të qëndrës”, pasi të gjithë do të jenë duke menduar për veten e tyre dhe kjo është mëse normale. Më i kujdesshmi në këtë situatë duhet të jetë vetë Bashkimi European, i cili nuk duhet të lejojë që pikërisht kjo ego e shtuar në kushte jonormale të shkatërrojë aspiratat për të cilat ka punuar kaq shumë. Dita kur çdo gjë të ketë mbaruar, do të jetë dita kur të gjithë të kuptojnë se kë kanë mik e kë armik, ashtu siç edhe Makiaveli, tek vepra “Princi”, pohon, “të gjithë e shohin atë se çfarë ti je, por pak e përjetojnë dhe kuptojnë realisht se çfarë po kalon.”

Një kthim pas te Shtet-Kombet

| Apr 5, 2020 | [Blog-Debati Marlin Muça](#)

Bashkimi European u themelua mbi paradigmen se bashkëpunimi ekonomik i dy superfuqive europiane, Gjermanisë Perëndimore dhe Francës mund të mbyllnin ciklin e përgjakshëm të një kontinenti të drobitur nga luftërat e fillimit të shekullit të 20-të. Edhe më parë Europa kishte parë tentativa për një aleancë të shteteve europiane me njëra tjetrën. Aleanca më e qëndrueshme mund të quhet Aleanca e Shenjtë e monarkive europiane të themeluar pas Kongresit të Vjenës me qëllim garantimin e stabilitetit politik brenda kufijve të mbretërive si dhe ruajtjen e paqes mes tyre. Fushatat pushtuese të Napoleonit nga njëra anë si dhe lëvizjet e shumta revolucionare në Austro Hungari, Francë, Itali dhe gjetkë lëkundën fort balancën e fuqive të ngjizur me paqen e Vestfalisë, duke i rradhitur Mbretërit e Europës në një aleancë “kushërinjsh“, në dukje të pathyeshme me njëri tjetrin.

Mirëpo dhe kjo Aleancë dështoi dhe rezultat i këtij dështimi ishte Lufta e Parë Botërore .

Përfundimi i Luftës së Dytë Botërore e gjeti botën nën nervat e një përpjekjeje të anktshme për të mos përsëritur gabimet e dyzet viteve të shkuara. Për te tejkaluar këtë fatalitet historik, u ndërmorën një sërë iniciativesh politike e juridike të cilat i dhanë jetë një miriade të tërë ligjesh dhe institucioneve. Më konkretisht, Fuqitë e mëdha e panë të arsyeshme të ndërtonin dy lloje aleancash; një të politiko-ekonomike dhe tjetrën, një aleancë ushtarake për të siguruar paqen e shëndoshë dhe jetëgjatë të kontinentit. Një ndër to ishte dhe Bashkimi European, i cili për të ardhur në formën dhe organizimin që ne njohim sot, kaloi një mori ndryshimesh përmbajtësore dhe strukturore.

Ajo çfarë nisi si një bashkim ekonomik, do të bëhej shpejt bashkim politik më solid që Europa ka parë në historinë e saj të pas shekullit të 17-të. Bashkimi European arriti jo vetëm të siguronte për anëtarët e saj një zhvillim të jashtëzakonshëm ekonomik të nxitur nga lëvizja e lirë dhe heqja e tarifave doganore, por dhe një bashkim të atillë politik shumë larg takimeve të niveleve të larta që diplomatët apo sovranët kryenin në shekullin e 19të. Tanimë, popujt europianë kishin mundësi të përfaqësoheshin në një organ legjislativ të përbashkët prej nga miratoheshin akte juridike me fuqi në të gjitha shtetet anëtare.

Sigurisht që ky Union pati shumë vështirësi në rrugëtimin e tij. Madje vitet e fundi ai po përballlet me sfidën më të vështirë në historinë e vet të shkurtër. Krizat ekonomike, pasojat politike të luftërave në Lindjen e Mesme si dhe ndryshimi i qasjeve ndaj kësaj organizatë nga ana e aktorëve shtetërorë jashtë Europës si SHBA, Kina apo Rusia, i kanë vendosur shtetet përbërëse të saj në dilema tepër të rrezikshme që vënë në pikëpyetje pikërisht vlerat dhe parimet kryesore mbi të cilat u ndërtua ky union. Aktualisht, vëmë re kthimin mbrapa në Europën e Shtet-Kombeve dhe balancës së fuqisë si teori rregulluese mes tyre.

Në këndvështrimin tim, arritja më e madhe e Bashkimit European dhe institucioneve të ngjashme me të ishte institucionalizimi dhe ligjësimi i marrëdhënieve midis shteteve. Këto organizata ndërkombëtare zëvendësuan forcën ushtarake dhe ushtrimin e saj me një mori siguresash në sanksionuara në konventa dhe marrëveshje ndërkombëtare që e bëjnë luftën të duket në mos një skenar të pamundur, një skenar apokaliptik filmash. Ajo çfare po ndodh sot është humbja e besimit të këto organizata dhe kthimi pas drejt një Europë që dikur nuk njihte kaq shumë bonne sens politik.

Ëndrra europianë filloi të krisej qyshse ne momentin u vu në dyshim aftësia e saj për të gjeneruar mirëqënien që donin të gjithë. Kriza e vitit 2008 e shoqëruar më pas dhe me valën e emigrantëve nga vatrat e konfliktit i bëri njerëzit t`iu riktheheshin identiteteve të tyre kombetare e bashkë me to për fat të keq dhe diferencave kulturore. Njësoj si me pjesën e dëmtuar të një dige, fasada e Europës së bashkuar mbi bazën e një zhvillimi ekonomik të kenaqshëm për secilin, u plasarit për të mos qënë më e njëjta. Vakumi që la Britania e Madhe me largimin e saj do të jetë një tjetër e carë që euroskeptikët do ta gërmojnë gjersa të nxjerrin 1001 arsye pse Europa e bashkuar është një ëndërr e dështuar.

Rikthimi i shtetkombeve të lidhura fort pas sovranitetit të tyre politik dhe territorial do të na cojë akoma dhe më afër panoramës që pikturoi Paqja e Vestfalise në shekullin e 17të. Ky skenar nuk duhet të na bëjë pesimist. Historia e njerëzimit ka njohur kthesa të tilla historike. Ajo cfare Bashkimi Europian dhe organizmat e saj duhet të bëjë është të ruajë sa më shumë zgjidhjen institucionale të problemeve që do të lindin mes shteteve. T`i mbajë këto të fundit të lidhura ligjërisht dhe moralisht pas anëtarësisë së tyre në këtë organizatë. Vazhdimësia e këtij Unioni nënkupton balancën e brendshme politike të Europës si dhe një kundërpeshë të rëndësishme ndaj Ruisë dhe Kinës të cilat po bëjnë jo pak në shtrirjen e influencës së tyre ne continent.

Koha e dashurise dhe mirëkuptimit mund të ketë mbaruar por kjo nuk do të thotë se paqja dhe bashkëpunimi nuk mund të arrihet përmes obligimit moral dhe ligjor që e drejta ndërkombëtare imponon mbi të gjitha shtetet e kohës. Vetë ekzistenca e këtyre organizmave i atribuohet frikës se etërve themelues se një ditë situata ndërkombëtare mund të conte deri aty sa shtetet të kërkonin mënyra të tjera dhe aleatë te tjerë që mund të hidhnin në erë paqen e Europës e pse jo dhe të botës. Në këtë rast Unioni do të shërbente e padyshim që do të shërbeje si një failsafe për të mos iu rikthyer plotësisht një Europe të varfër, të përcarë e në konflikt të vazhdueshëm me veten.

Arsimi në kohërat e Covid-19

| Apr 5, 2020 | [Blog-Debati Skerdi Kruja](#)

Fakulteti i Drejtësisë, UT

Tashmë ne kemi arritur në javën e tretë të izolimit në shtëpi dhe “luftës ndaj armikut të padukshëm” që quhet Covid-19. Ne na është dashur të ndryshojmë tërësisht mënyrat tona të jetesës dhe me to kanë ardhur dhe kufizimet e të drejtave tona. Duke filluar që nga lëvizja e lirë e personit, të drejtën për të punuar apo të drejtën për tu arsimuar. E unë kam vendosur të ndalem specifikisht te e drejta për tu arsimuar.

Me datë 9 Mars, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë së bashku me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nxorren vendimet e para në lidhje me masat që qeveria do të ndërmernte për t’u përgatitur për këtë luftë, ku njëra prej tyre do të ishte mbyllja e të gjitha institucioneve arsimore publike dhe jopublike parauniversitare në rang kombëtar. Vendim ky që u pasua nga vendimet e Rektorateve përkatëse të çdo Universiteti në Republikën e Shqipërisë për të pezulluar mësimet deri në një lajmërim të dytë.

Situata sa vinte dhe rëndohej, duke shënuar më shumë të prekur pas çdo dite dhe më shumë masa të ndërmarra nga Qeveria për të ngadalësuar përhapjen e tij. Duke ndjekur situatën aktuale studentët vendosën të riktheheshin pranë familjeve të tyre ndoshta nga frika dhe pasiguria për të gjetur te ta ndopak ngushëllim.

Pas gati dy javësh pasigurie sesi do vazhdohej me arsimin dhe nëqoftëse viti i nxënësve dhe studentëve do të digjej Ministria Arsimit dhe Rektoratet njoftuan se do të fillonin procesin mësimor online ashtu si vendet e tjera.

Sigurisht që ky njoftim solli shumë pyetje të ngritura nga studentët, prindërit por dhe vet mësuesit dhe pedagogët.

Si për t’i kthyer përgjigje pyetjeve dhe për të sqaruar çdo problematikë Ministria Arsimit me të gjithë fuqinë e kabinetit të saj u përpoq dhe po përpiqet në maksimum për ta realizuar atë, por a i’a ka arritur në të vërtetë qëllimit?

Për këtë le të marrim në analizë disa pika kyçe.

Së pari procesi i mësimin online do të implementohej nëpërmjet disa aplikacioneve të reja, për të cilët studentët, mësuesit prindërit dhe nxënësit vetë nuk ishin të qartë sepse ishte e padëgjuar dhe më parë.

Së dyti, mundësia e çdo familje për të patur një smartphone apo një laptop për të përdorur këto programe. Është e vërtetë që në ditët e sotme shumica e familjeve janë të pajisura me të paktën një smartphone për familje, por këtu duhet të marrim në konsideratë dhe prindërit që u është dashur të punojnë nga shtëpia e rrjedhimisht marin prioritet përpara ndjekjes së leksioneve. Përtej kësaj niveli ekonomik i familjeve shqiptarë ku rroga minimale prej 26000L për muaj është e pamjaftueshme për kërkesat bazike të jetesës e tani u është shtuar dhe problemi i pajisjes me internet.

Do ju duket e çuditshme ama një nga paketat më të lirë mujore të internetit variojnë nga 1500L e lart si për smartphone ashtu dhe me modem.

Po të mbështetemi në statistikat e INSTAT niveli i papunësisë është rreth 24.6%, por këto statistika duhet të merren të rezervuara nga ana jonë sepse janë përpara se të mbylleshin pikat e basteve dhe lojërat e fatit ku afërsisht 17 mijë veta u regjistruan si të papunë.

Së treti, e ndoshta veprimi më i mirë që Ministria ka realizuar është transmetimi i leksioneve për nxënësit parauniversitar në radiotelevizionin e Tiranës, i cili gjithsesi mbahet nga taksapaguesit shqiptarë. Por dhe leksionet aty janë të pamjaftueshme siç dëgjojmë shpesh nëpër transmetimet televizive me opinionistë të ndryshëm.

Por dhe këtu duhet të merren parasysh familjet në zonat e thella rurale ku mundësia për të ndjekur këto leksione është e vështirë, për të mos përmendur që jo më larg se vjet kanalet televizive u bënë të paaksesueshme pa pajisjen e një modemi.

Së katërti, përgatitja dhe njohuria e palëve të interesuara me mësimin online. Është e vërtetë që shtetet e huaja kanë implementuar metodën e ndjekjes së leksioneve online, por nuk duhet të harrojmë që ata nuk janë të saponjohur me to. Prej vitesh Universitetet e tyre kanë website personale ku studentët mund të lundrojnë online për çdo pyetje që mund të kenë, dhe tek ne një pjesë e mirë te sistemit Parauniversitar është e papajisur me to dhe Universitetet i kanë të paplota, të mbushura me bug-e të ndryshme dhe të vjetëruara.

Vendet e huaja, ku mund të marrim si shembull sistemin arsimor të vendeve Nordike, kanë implementuar prej kohësh komunikimin online për të dhënë detyra dhe projekte për studentët e tyre, ndërsa në Shqipëri ka filluar të vihet në zbatim kohët e fundit.

Sipas një analize të bërë nga ana ime të dy daljeve të Ministres së Arsimit në emisione televizive, ka plot paqartësi dhe ankesa nga studentët, sesi mësuesit po “neglizhojnë” me detyrat e tyre duke u kërkuar llogari dhe komunikuar në orare të vona, pa respektuar oraret zyrtare në një kohë normale, por dhe vete mësuesit kanë ankesa dhe pse në vështirësi për t’i shprehur, që janë të patrajnuar për një situatë të tillë.

Sigurisht, që në këtë situatë ku gjendemi, shëndeti është kryesori, por a mos vallë gjendemi në një situatë që mund të ishte parandaluar?

A mos ndoshta duhet të kishim filluar prej kohësh implementimin e një sistemi arsimor online, ku të bëhej ndërthurja e leksioneve online dhe në mënyrën tradicionale? Mos ndoshta mësuesit dhe studentët duhet të ishin trajnuar për një situatë të tillë paraprakisht? Jeff Bezos ka thënë para 5 vitesh në një podium të mbajtur prej tij që sfidat më të mëdha njerëzimi nuk do t’i ketë prej luftërave, por prej viruseve/baktereve sepse do të na kapin të papërgatitur, siç dhe po e shohim. E unë kam bindjen personale që një situatë e tillë do të përsëritet në të ardhmen, por me shpresën që do të kemi nxjerrë disa mësim të rëndësishme dhe të kemi vepruar mbi to.



Në këtë mënyrë një brez tjetër nuk do të duhet të “vuajë” pasojat që po përjeton sistemi arsimor i sotëm.

Një vështrim drejt së ardhmes

| Apr 6, 2020 | [Blog-Debati](#) | [Selmina Varfi](#)

Fakulteti i Drejtësisë, UT

Pas përfundimit të luftës me Covid 19, do jemi të gjithë ‘veteran’, të mbijetuarit e një bote që s’do jetë më e njëjta.

Nëse marrim në analizë fjanën ‘veteran’ të shpjeguar sipas autorit polak Woldek Goldkorn, tregon për një individ që ka jetuar nën lekurën e tij traumën, emocionet dhe katastrofën e më pas ka rinisur përsëri jetën duke treguar cka ka përjetuar për të mos lënë më historinë të përsëritet.

Në fund të emergjencës botërore të shkaktuar nga Covid19, të gjithë do jemi ‘veteran’, të mbijetuarit e një bote që nuk është më.,por për sa kohë do të nevojitet që të qëndrojmë në karantinim dhe a është efikase si metodë?

Historia e politikës së karantinimit në fakt tregon qasje dhe peridha të ndryshme kohëzgjatje. Anglia përshembull, në rastin e situatës së murtajes bubonike në periudhën e hershme moderne, u vendos një periudhë karantimi në shtëpi prej 40 ditësh në rast se zbulohet një individ i infektuar në familje.

Por karantinimi modern është një qasje tërësisht e re për qytetarët, pasi pas thujse një gjysmë shekulli pa u zbatuar, karantinimi modern u rikthye në vitin 2003 me Sindromën e Rëndë Respiratore Akute ose epideminë ndryshe referuar si SARS-Coronavirus. Persona të ekspozuar ndaj infeksionit dhe kontaktet e tyre të drejtëpërdrejta, përfshirë edhe kontaktet me persona në komunitet, karantinoheshin për një kohëzgjatje të përafërt me periudhën e inkubimit afërsisht dhjetë ditë.

Nga situata e krijuar, Këshilli i Sigurisë Kombëtare ka propozuar udhëzime lidhur me planifikimin për rastet kur duhet vënë në zbatim karantina kolektive, ndryshe referuar si ‘ditët e dëborës’, në përgjigje të një pandemie të mundshme:

- Individët dhe familjet të kufizojnë kontaktet sociale duke qëndruar brenda shtëpive të tyre — do të conte në uljen e nivelit të transmetimit në komunitet dhe do të ofronte mbrojtje për familjet ku infeksioni ende nuk ka mbërritur.
- Në mungesë të masave përfundimtare kundërpërgjigjëse (p.sh. një vaksine efektive) kufizimet e ditës së dëborës do të shërbejnë për të ngadalësuar por jo ndaluar transmetimin e gripit në komunitet.
- Përdorimet e kufizimeve të ditës së dëborës gjatë një pandemie mund të ndryshojnë.

Këto kufizime vendosen në zbatim për të ulur fluksin në institucionet e kujdesit shëndetësor, duke ulur përkohësisht shkallën e infeksioneve të reja brenda një komuniteti te caktuar.

Pandemia aktuale për COVID-19 parashikon një periudhë inkubimi prej katërmbëdhjetë ditësh. Nën udhëzimet e Sigurisë Kombëtare, kjo do të thotë se urdhërat për ‘ditën e dëborës’ duhet të kenë një limit prej njëzet e tetë ditësh, nëse do konsideronim qasjen më konservatore. Ndërkohë që në përgjithësi, situata që kemi parë në praktikë nuk është kjo.

Por si po përshtatet Evropa, kryesisht Bashkimi Evropian mbi “mbijetesën e mëtejshme të saj mbas Covid 19?

Një nga leksionet më të vyera që duhet të mësojmë nga kjo situatë është ajo e solidaritetit mes popujve e shteteve , i njëjti solidaritet që ka sjellë lindjen e Komunitetit Evropian e më pas Bashkimit Evropian , sipas ndryshimeve të Traktatit të Mاستritit.

Në debatin që po trajtohet ne lidhjen me zgjidhjen e krizës ekonomike post Covid19 , shihet se shtetet e bashkimit kanë opinione të ndryshme.

Propozimi i shfaqur nga Italia ,Spanja dhe Franca për planin “Coronabond”,i cili konsiston në shitjen e letrave me vlerë të unionit për të ndihmuar ekonomikisht shtetet më të prekura nga pandemia , ka shkaktuar një pëçarje mes tyre .

Alternativa tjetër e përkrahur nga vendet nordike ,Gjermania dhe Hollanda, si kundërshtim për “Coronabond” shtynjë drejt aplikimit të Mekanizmit të Stabilitetit Evropian (MES)

Nëse në një situatë kaq të tmerrshme si ajo e tanishmja , disa shtete preferojnë të mos përdorin MES , kjo është për shkak se ajo është ndërtuar mbi një seri privilegjesh “mesjetare” ,siç është identiteti i fshehtë i zyrtarëve të tij,imuniteti diplomatik , paprekshmëria e pasurive të saj edhe në kushte gabimi të dukshme , por sepse mbi të gjitha përfaqëson një shkatërrim të vet themeleve ngritëse të Bashkimit.

Një shembull i zbatimit të kushteve të MES , është gjatë krizës së vitit 2012 në Greqi , ku MES paraqiti mekanizmat e saj shtrëngues , mekanizën i cili shkaktoi më shumë dëme sesa përmirësoi situatën . Fusha më e dëmtuar nga ky mekanizëm sipas raportit të Këshillit të Evropës mbi Greqinë në 2018 konsistonte në sistemin shëndetësor duke sjell pasoja si: shtim i numrave të pacientëve me HIV dhe vendosjen e kujdesit shëndetësor ,në përgjithësi, në kolaps.

Madje Komisioneri për të Drejtat e Njeriut,Dunja Mjatoviç, pretendoi dhe shkelje të të drejtave themelore të njeriut.

Nëse MES do të duhej të zbatohet tani , nevojitet një ndryshim i theksuar i strukturës së saj për ta kthyer në një instrument “shpëtimi” . Në rast se kjo nuk mund të jetë e mundur , të përdoren instrumentat e saj financiarë inovatore , duke bërë të mundur clirimin e sasive të të ardhurave që ajo mban aktualisht , në favor të shteteve më të dëmturava nga Covid 19.

Duke mos ditur dhe për sa kohë do të vazhdojë kjo situatë, beteja që duhet të bëhet në Bruksel është në rikthimin e frymës solidare , unitare dhe principeve mbi të cilat është ngritur Bashkimi Evropian.



Nevojitet të rikujtohet përsëri se *“Bashkimi i Evropës ishte ëndërr e të paktve . U kthye në shpresë për shumë .Tani është një domosdoshmëri për të gjithë ne – Konrad Adenauer.*

Ku dallon Kina nga Shtetet e Bashkimit European në menaxhimin e Covid-19

| Apr 8, 2020 | [Blog-Debati](#) | [Marlin Muça](#)

Para pak muajsh shteti Kinez shpërnguli me forcë rreth 1 milion ujqurë për t`i dërguar në kampe të mëdha përqëndrimi ku do të riedukoheshin sipas parimeve marksiste. Ky precedent tregoi se sistemi politik i Kines i lejon kësaj të fundit të kryejë akte që bien në kundërshtim me liritë e të drejtat e njeriut, pa e vrarë mendjen për pasoja apo sanksione politike të jashtme dhe të brendshme. Gjurmimi ekstrem që autoritetet kineze i bënë të infektuarëve me virusin, thyen çdo legjislacion ndërkombëtar të ndërtuar për këto skenarë. Mbyllja e çdo veprimtarie ekonomike, kulturore apo politike nuk u shoqërua me pakënaqësitë e këtushme, përkundrazi, u prit me qetësi e bindje nga popullata vendase.

Bashkimi European ishte një histori komplet tjetër. Në dallim nga Kina, shtetet e Unionit duhet të respektonin kornizën ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare të miratuar apo ratifikuar pikërisht për këto lloj situatash. Koha që procedurat kërkojnë për të vënë në zbatim planin e masave vonon përgjigjen ndaj përhapjes së virusit duke e bërë më të vështirë mobilizimin e njerëzve dhe burimeve në menaxhimin e situatës.

Një tjetër dallim, është dhe natyra e opinionit publik në dy modelet e përmendura më lart. Në sistemet diktatoriale nuk ka një opinion publik ndaj dhe mbështetja popullore është e pafundme për cdo iniciativë që ndërmerret shteti. Mungesa e kësaj pengese i krijon mundësi diktaturave të kenë në dispozicion një masë të jashtëzakonshme njerëzish të gatshëm jo vetëm për t`iu bindur urdhërave por edhe të jenë pjesë aktive e fushatave dhe masave që merren në parandalimin e krizave. Në shtetet perendimore, opinionit publik mbetet një ndër faktorët kryesorë që ndikojnë në politikbërje. Përveç vonësive që shkaktojnë procedurat ligjore, qeverisë i duhet të ndërtojë paralelisht dhe një fushatë piari në mënyrë që të ketë shumicën e opinionit publik pro veprimeve të saj. Edhe nëse ajo arrin të ketë në krah shumicën dërrmuese të njerëzve që janë të aftë të reflektojnë mbi realitetin që i rrethon, përsëri kjo mbështetje nuk do të jetë e pafundme dhe e përjetshme. Kjo specifikë e demokracive liberale do t`i bëjë shtetet të harxhojnë energji të dyfishtë si në përbalimin e krizave ashtu edhe në marketimin e tyre në sytë e publikut.

Distancimi social dhe sfidat me motivimin e studentëve

| Apr 8, 2020 | [Blog-Debati](#) | [Blerjana Bino](#)

SCiDEV është duke zbatuar projektin 'Debati për Integrimin European në Auditorët Universitar' me mbështetjen e [Fondacionit për Shoqëri të Hapur në Shqipëri \(OSFA\)](#). Sipas planifikimit në mars e prill 2020 ishin parashikuar të organizoheshin debatet universitare në 11 institucione të arsimit të lartë. Ndërkohë që debatet në dy institucione ishin realizuar në dhjetor 2019 dhe shkurt 2020, në kushtet e pandemisë COVID-19, SCiDEV në dakordësi me grupin e pedagogëve dhe OSFA vendosën shtyrjen e debateve të planifikuara për një datë në të ardhmen.

Me qëllim që të përgatitemi për mundësinë e zhvillimit të debateve apo aktiviteteve të tjera online, SCiDEV në bashkëpunim me OSFA ndërmoi një pyetësor për të vlerësuar kapacitetet dhe mundësitë që kanë studentët pjesëmarrës për të arritur rezultatet e projektit përmes përdorimit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në kushtet e reja të vetë-izolimit dhe distancimit shoqëror si pasojë e pandemisë COVID-19. Gjetjet e pyetësorit shërbejnë për të informuar vendimmarrjen e SCiDEV lidhur me realizimin e debateve apo aktiviteteve të tjera online.

Projekti zbatohet në Tiranë dhe Durrës duke përfshirë vetëm universitetet nga këto dy qytete në këtë fazë pilot. 42% e studentëve që iu përgjigjën pyetësorit jetojnë në Tiranë dhe 14% në Durrës, ndërkohë të tjerët jetojnë në qytete të ndryshme të Shqipërisë, por studiojnë në Tiranë ose Durrës. Pjesa më e madhe e studentëve që i janë përgjigjur pyetësorit janë vajza dhe gra (66%). 60% e respondentëve janë studentë të nivelit bachelor.

93% e studentëve raportojnë që janë në vetë-izolim në shtëpi sipas udhëzimeve të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe vetëm 1% janë në punës sipas rregullave dhe kufizimeve të vendosura. 66% e studentëve të pyetur raportojnë se janë duke ndjekur mësimin online.

Sa i takon infrastrukturës, të gjithë studentët e pyetur konfirmojnë që kanë pajisje në gjendje të mirë pune për të realizuar mësim apo aktivitete të tjera online. Shumica (56%) kanë laptop ose PC personal në shtëpi dhe pjesa dërrmuese (75%) kanë telefon celular personal me kamera. Sa i takon lidhjes me Internet, 73% e studentëve raportojnë që kanë lidhje wireless me Internet në shtëpi, ndërkohë 22% përdorin lidhjen nga telefoni (3G/4G). Megjithatë 12% nuk kanë lidhje të vazhdueshme me internet, çka do të vështirësonte realizimin e aktiviteteve online.

Sa i takon platformave të përdorura për të realizuar mësimin online apo video-konferenca, studentët raportojnë përgjithësisht: Whatsapp, Skype dhe Zoom si edhe platforma të tjera të ofruara nga universiteti. Sa i takon përdorimit të platformave online, një e katërta e studentëve raportojnë se janë disi familjar dhe i përdorin me lehtësi ato. Ndërkohë 40% e studentëve nuk kanë përdorur ndonjëherë (19%) ose i kanë përdorur shumë pak platformat e punës apo mësimin online (21%).

Të pyetur se cilat do të ishin nevojat e tyre nëse debatet zhvillohen online, 68% e studentëve raportojnë se kanë nevojë për koordinim me anëtarët e skuadrës dhe mentorin. Ky është një tregues i mirë i kuptueshmërisë së tyre për rregullat e debatit të strukturuar dhe se pa koordinim nuk mund të realizohet

me sukses. 59% raportojnë se kanë nevojë për trajnim dhe udhëzime për të përdorur platformën online që do të përdoret. Kjo nënkupton punë përgatitore nga ana e SCiDEV, skuadrës së projektit dhe mentorëve për të mbështetur studentët dhe realizimi i trajnimeve që sërish do të duhet të bëheshin online. Në një kuptim më të gjerë, kalimi i mësimi apo aktiviteteve të projektit online erdhi papritmas dhe pa përgatitjen e nevojshme si në infrastrukturë edhe në kapacitete të studentëve dhe pedagogëve për ta realizuar me sukses. Ndaj ne po tregohemi të kujdesshëm të kuptojmë sa mundësi reale kanë studentët për t'i realizuar debatet online duke arritur po të njëjtat rezultate që i kemi vendosur vetes: përforcimin e mendimit kritik, analizën me argumente, komunikimin me etikë, tolerancën për mendimin ndryshe etj.

Ndërkohë që nga përgjigjet e studentëve vihet re një situatë që favorizon përgjithësisht zhvillimin e debateve online apo aktivitete të tjera (pra ka një infrastrukturë të pranueshme dhe kapacitete që mund të ndërtohen më tej), ajo çka përbën sfidën e vërtetë është motivimi i tyre për të qenë aktiv dhe produktiv në kushtet e vetë-izolimit e distancimit social si pasojë e pandemisë. Të pyetur si do ta përshkruanin situatën ku ndodhen aktualisht, shumica e studentëve raportojnë që situata e re u ka bllokuar aktivitetin normal dhe u ka shkaktuar një lloj gjendjeje apatie dhe 'parazitizmi' duke mos bërë asgjë me vlerë gjatë qëndrimit në shtëpi. Të tjerë studentë raportojnë që janë ngadalësuar aktivitetet e tyre normale, por kanë filluar aktivitete të tjera në kushtet e vetë-izolimit sikurse është mësimi online. Shumë më pak raportojnë se kjo periudhë i ka shërbyer për reflektim. Megjithatë togfjalëshat më të përdorur për këtë përgjigje të hapur është: na ka bllokuar / jemi dembesolur / nuk kemi motivim.

Si duhet vepruar për të motivuar studentët? Si të kuptojmë secili prej nesh që pikërisht në këto kushte është më e nevojshme për të qenë produktiv? Pra aktiviteti normal i studimeve, detyrave të kursit, aktiviteteve ekstra kurrikulare duhet të vazhdoj dhe bëra e këtyre aktiviteteve online është mundësi e mirë për të njohur më mirë teknologjinë dhe reflektuar mbi ndikimin e saj. Gjithashtu, qëndrimi në shtëpi ofron mundësi shumë të mira për të lexuar, për të mësuar një gjuhë të re, për të ndjekur performanca artistike, apo për të gatuar, për të bërë art e shumë aktivitete të tjera. Mjafton që të gjesh çdo ditë arsye për të qenë aktiv e mbajtur produktivitetin.

Është e lehtë kur mbahet një strukturë apo rutinë që fillon me vendosjen e qëllimeve apo objektivave dhe shpërblimin e vetes ku i ke realizuar ato. Kjo mund të bëhet individualisht, por edhe në komunikim dhe lidhje me bashkëmoshatarë, kolegë apo pedagog. Komunikimi në rastin e distancimit social është edhe më i nevojshëm, pavarësisht se bëhet virtualisht. Mësimi online mund të shtoj presionin, prandaj komunikimi dhe ndarja e përvojave ndihmon.

Gjatë kësaj periudhe SCiDEV i fton studentët që të bëhen pjesë e nismës '#QëndronëShtëpi #QëndroAktiv', të ndajnë me të tjerët përmes fotove, mesazhe pozitive se si po e shfrytëzojnë periudhën e izolimit. Për më tepër, studentët mund të publikojnë shkrime në [rubrikën e Blog-ut të debatit universitar](#) mbi tema që lidhen jo vetëm me integrimin europian, por edhe me aktualitetin: si ka ndryshuar realiteti ku punojmë e studiojmë nga pandemia. Disa studentë në fakt janë shumë aktiv në këtë rubrikë dhe shkrimi u ka shërbyer për të bërë edhe analiza të shkurtra, lexuar më shumë dhe reflektuar rreth situatës. Edhe pse [rezultatet e pyetësorit](#) nuk mund të përgjithësohen për të gjithë studentët në vend, pasi i referohen vetëm një grupi të caktuar studentësh pjesëmarrës në projekt, ato na tregojnë për sfidën e të qenurit aktiv e produktiv në kushte të jashtëzakonshme si këto që po jetojmë. Ndërkohë që sfida është e kuptueshme nga vetë situata, gjithsesi



kapërcimi i saj kërkon pikërisht të jemi krijues e të qëndrojmë aktiv e produktiv si një shërbim ndaj shëndetit mendor e trupor për veten, por edhe si shërbim ndaj shoqërisë.

Raporti i gjetjeve gjendet tek [Burime](#).

Studentët shqiptarë sot dhe parabola e së drejtës për arsim

| Apr 9, 2020 | [Blog-Debati](#) | [Laura Skenderas](#)

Në kushtet e një rrjetëzimi global të marrëdhënive sociale ,ekonomike e kulturore ,padyshim që dinamizmi i kësaj shfaqjeje ka hequr barrierat ekzistuese të imponuara nga kufijtë gjeo -politikë duke krijuar haptazi mundësitë për të ndjekur modele për ameliorimin e situatës faktike të çdo shteti. Këtu nuk nënkuptoj vetëm situatën ekonomiko-politike,por së shumti vendos në fokus situatën që përfshin statusin e një kategorie që gëzon privilegjin e avenerit të vendit : TË RINJTË. Në gjithë amalgamën e ndryshimeve që po përjeton Shqipëria , prima facia duket se të rinjtë ndikojnë pak ose aspak në procesin vendimarrës ,jo vetëm atë qëndror e vendor ,por veçanërisht atë akademik. Megjithatë ,pa u ndikuar nga situata e faktit, reagimet nga ana e instancave janë ende në nivele që nuk kalojnë fillestartet. Ngase mungojnë politikat për ingranimin e këtij mekanizmi në qeverisje ; ngase mungon interesi i të rinjve për të ndryshuar diçka në sistemin arsimor apo ngase mundësitë që vetë institucionet akademike u japin integrimin në sistemin e tyre të novacioneve me burim vetë studentin janë të pakta? Më e rëndësishmja ,cila është qasja që I bëhet këtij “fenomeni” dhe nëse midis gjithësisë së këtyre elementëve ka koherencë ,çfarë hapash mund të ndermerren për ndryshim?

Së pari, po ndalem te burimi i “fenomenit ” të lobimit të të rinjve për reformim në arsim . Është shprehimisht e përcaktuar dhe njëherazi e njohur e drejta për arsimim në çdo nivel të tij, e kushtëzuar vetëm se nga kriteret aftësie ,si një liri themelore me rëndësi universale e njohur po ashtu edhe nga KEDNJ. Megjithatë,duket se sot ka një hendek midis promulgimit de jure që i bëhet kësaj të drejte dhe masave për realizimin e saj de facto. Përse e them këtë ? Mementalisht në një periudhë tranzitore për arsimin, do të thoja sa i takon reformës në arsimin e lartë ex officio ,ky i fundit po priret të rrisë numrin e studentëve në auditore. Mjaft pozitive kjo qasje për të rinjtë e po aq për vendin. Por në një vështrim a contrario me këtë situatë ,gjendet pjesa tjetër e të rinjve ,e gjithë atyre që për motive ekonomike apo sociale ,privohen nga vazhdimi i studimeve universitare . Në këtë moment natyrshëm lind pyetja : Cila është ndërhyrja aktive dhe efektive e shtetit për rastin në fjalë?

Këtu do të ndalem për të shqyrtuar më thellësisht situatën . Gjithë të rinjtë që për arsyet e përligjura të mësipërme shfaqin pamundësi objektive të vazhdojnë studimet ,politikat sociale shtetërore u financojnë një buxhet periodik. Por a është kjo mjaftueshëm për mbulimin e shpenzimeve dhe tarifës shkollore e substraktit të teksteve? Dhe cila është kostoja oportune e studentit? Në këtë situatë çdo i ri apo e re tërhiqet . Si një reaktion zinxhir dalim në problematikën primar: tarifen shkollore. Pavarësisht faktit se sipas legjislatorit konsiderohet proporcionale de facto nuk konstatohet e tillë. Andaj zgjidhja racionale do të ishte arsimiti i lartë publik falas. Por kjo në kondicionet ekonomike të vendit tonë për momentin do të konsiderohej utopi , ndaj zgjidhja më pragmatiste do të konsiderohej ulja e tarifave së paku në 70% të shumës aktuale të tyre. Qëlimi i kësaj lëvizjeje? Realizimi i objektivit social të shtetit për të siguruar mundësi dhe kushte të barabarta për të gjithë. E po kaq kritike paraqitet situata edhe për studentët të cilët I përkasin komuniteteve etnike në vendin tonë.

Së dyti,do të doja të ndalem te kualiteti i zhvillimit të procesit akademik.” Sekretit i arsimit qëndron në dëgjimin e studentit” do të thoshte Emerson. Po kështu duhet interpretuar edhe sot funksionimi i fakulteteve . Një eko e shfaqjes dhe dëgjimit të zërit të studentit. Në auditoret tona sot,pavarësisht punës së profesorëve ,procesi akademik është një marrëdhënie e thjeshtë e riprodhimit të informacionit të marrë,duke e lënë

kështu në hije mendimin kritik a vlerësues të studentit dhe në fund ajo që ka rëndësi qëndrimin e tij përballë çështjes. Të nesërmen studentët e së sotmes do të jenë profesionistët e diplomuar që “falë” metodave të studimit do të konsiderojnë pak ose aspak teorinë e mësuar për vite. Pse? Sepse aktualisht ndihet në programet akademike mungesa e prioritetit ndaj vënies në zbatim të njohurive të mara ,ku zbatimi i vetëm i tyre është një testim final. Me këtë metodë studentët kthehen në asgjë më shumë se një mekanizëm ripërsëritës ,me mungesë të theksuar vetëanalizimi. Mungesa e kërkimeve shkencore të vetë studentëve është po aq shqetësuese ,pasi dinamika e zhvillimeve në gjithë korpusin e fushave të jetës është gjithnjë në proces dialektike . Kjo vjen si shkak i mungesës së financimeve nga ana e qeverisjes dhe po aq nga mungesa e orientimit . Në një rast hipotetik, nëse studentët shqiptarë do të vetëinicionin programe të tilla , universitetet simotra në gjithë botën mund të kishin si referim këto unë kërkimore.

Për analogji mund të marrim shtete të tjera të Ballkanit të cilat në thuajse të njëjtat kondita, kanë zhvilluar një praktikë të tillë. Mungesa e debateve konstruktive,punëve kërkimore dhe shkembimeve të mendimeve është hendeku që ndan studentin shqiptar nga Europa. Sikurse mungesa e programeve në gjuhën angleze në universitetet tona përbën ngërç për vetë duke marrë në konsideratë faktin se ne aplikojmë programet Erasmus dhe së shpejti projektojmë vizualisht antarësimin në unionin evropian. Në kushte të tilla e ardhmja parasheh probleme. E të gjitha në mënyrë kumulative synojnë një objektivi të përbashkët : përmirësimin e cilësisë së të mësuarit në mënyrë akademike. Studentë më të përgatitur do të thotë qëndrueshmëri politike e juridike ,e kjo përkthehet mot à mot në qëndrueshmëri prioritare të shoqërisë dhe mirëqënie të saj .

Parashtrimi i problemeve bashkëkërkon edhe analizimin e mundësive. E para prej nga duhet të fillohet është vetë studenti si subjekt i këtyrI dinamikave. Ndikimi I tij në qeverisje është më tepër se thjesht fundamental . Ai mund ta bëjë këtë me anën e grupeve të interesit, në momentet kur kryefjala e ditës për legjislativin është arsimit , duke shfaqur interesat e veta dhe duke dhënë mundësi alternative. Monovrat e korridoreve janë një prej rrugëzgjdhjeve të përdorura gjerësisht nga Evropa dhe pse jo integrimi në shoqërinë shqiptare me qëllim përmirësimin e arsimit ,do të ishte i frytshëm. Duke qenë se synimi ynë primar është BE-ja ,duhet të kujdesemi që ne si breza të rinj të fokusohemi te procesi i edukimit më tepër se ai i mësimit të gjithçkaje par couer . Investimi në edukim nuk nënkupton vetëm atë financiar ,por edhe atë me vizione futuriste që qëllimet të kthehen në objektiva e objektivat në realizime ,si rruga më e sigurt për tu integruar me ritme të akseleruara. Jo vetëm pjesëmarrja në seancat e dëgjimit me grupet e interesit,por edhe aktivizimi në këshillat bashkiakë për të dëgjuar se çfarë konkretisht ka nevojë shoqëria paraqet rëndësi. Kjo ngase të rinjtë kanë kontrubutin që të sjellin një revolucion të tretë ,këtë herë në arsim , kontribut që është i çmuar dhe thelbësor nga rëndësia. Shoqëria ka nevojë për të rinjtë ,studentët po aq sa këto kanë nevojë për mbështetjen e shtetit. E më e rëndëshishmja ,studentët kanë nevoja të kapërcejnë sfidat e çdo dite në fakultete ,të nderrmarrin nisma e të bëhen mekanizmi lëvizës i këtij vendi,të kërkojnë që zëri i tyre të dëgjohet për një të ardhme më të mirë të vendit.

NE jemi VIRUSI shkatërrues i Gjuhës Shqipe!

| Apr 9, 2020 | [Blog-Debati Ketii Sula](#)

Përdorimi i rrjeteve sociale (teknologjisë) shkakoi për tjetërsimin e gjuhës shqipe?!

Në këto ditë kur Jeta duket sikur ka ndalur frymën, po gjejmë forcën për të mposhtur virusin vdekjeprurës, koronavirusin, ndërkohë, ende nuk kemi kuptuar, që një tjetër virus më i rrezikshëm ka kohë që transmetohet.

Ndërsa të gjithë përpiqemi me padurim të dalim nga kjo pandemi, pa e kuptuar, kemi shkaktuar vet një tjetër pandemi më të rrezikshme.

NE jemi VIRUSI shkatërrues i Gjuhës Shqipe!

Ju duket e çuditshme?!

Mjafton të hyni në rrjetet sociale dhe aty kupton ç'po ndodh me Gjuhën Shqipe!

E Mjera! I ka rezistuar në shekuj asimilimit të saj nga gjuhët e huaja. Është përballur me furtuna e rrebeshe të shumta e të egra dhe ka ditur të fitojë.

Por, ndjej dhimbje dhe drithërohem kur konstatoj se Virusi më i madh, rreziku, furtuna dhe rrebeshi kësaj radhe, po bëhemi vet NE! Gjuha jonë po shkatërrohet dhe tjetërsohet nga shpërfillja dhe indiferentizmi i shoqërisë dhe individit!

Nëse nuk e ndalim sot dëmin e pafalshëm ndaj së shenjtës Gjuhës Shqipe, nesër do të jetë vonë dhe Historia do të na gjykojë të gjithëve!

Gjuha në vetvete është një organizëm i gjallë që evoluon në kohë dhe si e tillë i përgjigjet emancipimit të shoqërisë, kulturës, teknologjisë.

Me futjen në përdorim të teknologjisë së lartë (high tech) dhe krijimin e rrjeteve sociale zhvillim të madh ka marrë “gjuha elektronike” ose ligjërimi elektronik i përdorur në rrjetet sociale, një lloj i ri i shfaqjes së gjuhës (e-mail, what up, sms, facebook, instagram, twitter, linkedin, etj.).

Me këtë platformë ligjërimi, përdoruesi nuk kalon në filtrin e redaktimit, për pasojë vërehen shmangie nga normat e gjuhës dhe natyrshëm lind shqetësimi, nëse përdorimi i rrjeteve sociale po tjetëron gjuhën shqipe?

Por, a mund të jenë rrjetet sociale për tjetërsimin e gjuhës shqipe?

“Një komb nis të shturet kur nis të shturet gjuha e tij” Octavio Paz

Çdo komb ruan me fanatizëm shenjat e identitetit të vet, ku përfshihen edhe shkronjat tipike për një gjuhë

Alfabeti ynë ka shkronjat **ë** dhe **ç**, që shënojnë dy tinguj të veçantë të shqipes. Ato dëshmojnë jo vetëm origjinalitetin e alfabetit tonë, po lidhjen edhe me tradita të caktuara kulturore. Shkronjën **ë**, të quajtur shkronjë “flamur”, e kemi trashëguar nga tradita arbëreshe e fillimit të shekullit të 18-të; kurse **ç**-në e kemi nga alfabeti i Shoqërisë së Stambollit, me autor Samiun[1].

Përdorimi i tyre ka rëndësi, përveç anës emocionale, edhe asaj përmbajtësore, pasi fjalët marrin tjetër kuptim. Për shembull, **çap** bëhet **cap**, **çik** bëhet **cik**, ose **në** bëhet **ne**, **nën** bëhet **nen**, **ndër** bëhet **nder**, etj.

Për këtë kërkohet ndërhyrja e menjëhershme e shtetit shqiptar për instalimin e tastierave në gjuhën shqipe në kompjuterat e institucioneve shtetërore dhe private në shërbim të publikut.

Përqaftimi çdo ditë e më shumë i teknologjisë po përparon dukshëm në të gjitha sferat e jetës sonë, që shoqërohet me rritje të shkallës informative tek ne.

Për përdoruesit është shumë e rëndësishme shpejtësia në ndërveprimet sociale mes tyre, që imponon këtë lloj komunikimi jo korrekt nga ana gjuhësore.

Fjalët përshëndetëse **ç’ kemi**, **faleminderit**, **kalofsh mirë**, **mirëmëngjes** janë zëvendësuar me inicialet **çkm**, **flm**, **klm**, **mngj**. Përdorues të pyetur në lidhje me këtë çështje pranojnë këtë tendencë, sepse ndihmon në komunikimin sa të thjeshtë, aq edhe të kapshme e të shpejt midis tyre.

Mënyra shumë e thjeshtë e të komunikuarit me fjalë dhe fjali të shkurtuara, gati të koduara, tashmë është bërë praktikë pune, duke deformuar, varfëruar dhe lënë pas zhvillimin e gjuhës shqipe.

Gjatë procesit të integritit të Shqipërisë, gjuha shqipe po përballlet me sfida të mëdha dhe mund t’i paguajmë shtrenjtë, nëse nuk do t’i kushtojmë vëmendjen e duhur.

Ndihet dukshëm mungesa e përdorimit të mirë të fjalorit të gjuhës shqipe. Akoma më shqetësuese është zëvendësimi i fjalëve shqipe dhe me fjalë të huaja. Për shembull, **avangardë** me **pararobjë**; **abdejt** me **përditësim**; **aludim** me **dysim**; **demolim** me **rrënim**, **shkatërrim**; **inkursion** me **dyndje**, **mësymje**; **komportim** me **sjellje**, **qëndrim**; **impëdim** me **angazhim**, **zotim**.

Problem mbetet shtrembërimi i saj nga institucione shtetërore apo private (shkollat, qendrat kërkimore, administrata, mediat, gazetatat si dhe aktet e dala nga këto institucione) apo persona publike të të gjitha sferave.

Në tre rastet e sipërpërmendura, fajin për tjetërsimin e gjuhës shqipe nuk mund t'ia hedhim rrjeteve sociale – teknologjisë, edhe pse nuk mohohen modelet e këqija të të shkruarit, që ndikojnë për keq te lexuesi.

Por, platformat e reja të teknologjisë

Na tregojnë më shumë nivelin e ulët të zotërimit të normave të gjuhës standarde në shkollë dhe pikërisht ky fakt duhet të shërbejë si nxitje për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë që të forcojë kontrollin në shkolla dhe masat për rritjen e cilësisë së mësimdhënies së gjuhës shqipe.

Ato zbulojnë disa problematika që kërkojnë reagim të shpejtë nga institucionet shtetërore të arsimit e të shkencës, inovacionit, teknologjisë, të cilat duhet të bashkëpunojnë që të pasurojnë gjuhën shqipe me elementë të kohës, në mënyrë që arritjet të shfrytëzohen si vlerë e shtuar për përvetësimin dhe gjallërimin e saj.

Pjesë e Misionit tim “ Të ruajmë dhe të mbrojmë gjuhën shqipe”

[1] Referuar Prof. Dr. Rami Memushi

Mendime rreth racionalitetit të pandemisë

| Apr 10, 2020 | [Blog-Debati Kriton Kuçi](#)

Në këtë periudhë kur gjithnjë e më shumë po duken të qarta pasojat tragjike që pandemia COVID 19 po lë në thuajse të gjithë botën, me mijëra jetë të humbura dhe me sisteme shëndetësore gjithmonë e më shumë në vështirësi, duket se Bashkimi Evropian po kalon përsëri ditë të vështirë, në planin politik, ekonomik dhe institucional. Ashtu si pandemia po nxjerr gjithmonë e më shumë në pah difektet dhe problematikat e sistemit egzistues, në të njëjtën mënyrë po dalin në pah edhe difektet e strukturës së Bashkimit Evropian, të institucioneve të tij, të aftësisë dhe të vullnetit për të marrë vendime kolektive në favor të qytetarëve dhe sidomos të atyre të vendeve më të varfëra. Difekte dhe problematika të cilat u shfaqën në të njëjtën mënyrë gjatë krizës së borxheve. Gjithmonë kriza të tilla të mëdha i vendosin shoqëritë, politike përballë sfidave të mëdha. Sfidat që për tu përballuar me sukses kërkojnë, ndryshime mënyrash të menduar, tejkalim të stereotipeve dhe paragjyqimeve, ndryshime strukturash politike dhe ekonomike.

Dhe përsëri në qendër gjendet debati. Dhe përsëri dilemat egzistencialiste që kanë gati 10 vite me rradhë që po turbullojnë Bashkimin Evropian. Cili është kuptimi i Bashkimit Evropian? Cilat janë vlerat mbi të cilat ky Bashkim mbështetet? A egzistojnë në praktikë këto vlera apo janë thjesht koncepte abstrakte? Cfarë do të thotë solidaritet? Deri ku duhet shtrirë ky solidaritet? A janë bilancet më të rëndësishme se njerëzit? A janë shtetet anëtare të barabarta mes tyre? A duhet që integrimi evropian të vazhdojë me shtete të reja?

Ditët e fundit kemi qenë të gjithë dëshmitarë të seancave të stërgjatura të institucioneve të Bashkimit Evropian dhe të ngurrimit të shumë vendeve anëtare për të marrë hapa të rëndësishëm dhe thelbësorë për të përballuar krizën e pandemisë në mënyrë të përbashkët. Dhe kemi qenë dhë jemi dëshmitarë të masave të pamjaftueshme që janë marrë. Nuk është dicka e re. Një ngurrim i tillë, dhe debate të tilla kanë qenë të pranishme edhe gjatë krizës së borxheve, me vendimet dhe masat e marra në atë periudhë jo vetëm të gabuara por edhe të pranuar më vonë si të tilla.

Dhe sot gjendemi përsëri përballë të njëjtave dilema dhe të njëjtave ngurrime. Me ndryshimin e vetëm që nëqoftëse gjatë krizës së borxheve rreziku dukej sikur i përkiste vetëm disa vendeve periferike të BE-së sot rreziku duket se është i përbashkët. Them duket sepse rreziku ndoshta përsëri nuk është i njëjtë për të gjithë. Edhe sot disa vende janë më të afta për ta përballuar krizën e pandemisë krahasuar me disa të tjera. Edhe sot brenda shoqërive tona ka njerëz të cilat i vuajnë pasojat e krizës më shumë se disa të tjerë. Dhe vendet të cilat hasin vështirësitë më të mëdha sot janë ato vende të cilat u goditën më shumë nga kriza e borxheve dhe u detyruan të marrin masa shtrënguese dhe të bëjnë shkurtime buxhetore kryesisht në sistemet e tyre shëndetësore. Dhe njerëzit të cilët hasin vështirësitë më të mëdha sot janë po ata të cilët paguan cmimin më të lartë gjatë viteve të krizës së borxheve. Dhe përsëri duket sikur cdo gjë fillon nga e para. Si një rreth vicioz.

Rritemi duke menduar se jemi qenie racionale të cilat mësojnë nga gabimet e tyre. Këtë besim në vazhdim ua atribuojmë edhe institucioneve politike, ekonomike dhe sociale që krijojmë dhe që me rradhën e tyre ndërtojnë mënyrën se si bashkëjetojmë dhe bashkegzistojmë. Mësohemi të besojmë se gjenerata së cilës i përkasim ka më shumë mundësi, më shumë prosperitet se sa ajo paraardhëse dhe se gjenerata që do vijë do të ketë akoma më shumë se sa e jona. Ja ndoshta mbi këto çështje ja vlen të drejtohet debati. A jemi të tillë?

Një këmbanë alarmi ka rënë: Të rinjtë nuk lexojnë sa duhet, as në kohë pandemie

| Apr 12, 2020 | [Blog-Debati Klodiana Beshku](#)

Kam qenë në kontakt me të rinjtë këto ditë nëpërmjet leksioneve *online*. Shpesh ata janë të trishtuar e të përhumur. Kur ju them të lexojnë libra për të kaluar kohë cilësore e për të jetuar edhe jetët e të tjerëve, ata më shohin me habi. Në këtë periudhë teksa bota është ndalur edhe rrjetet sociale nuk kanë shumë për të ofruar, ndaj ata ndjehen të zbrazët. Të lexuarit tashmë nuk është shoqëruesi i ditëve të tyre, ndaj nuk mund të bëhet befasi i tillë.

Një këmbanë alarmi e heshtur ka kohë që vërvitet mbi kokat tona: Të rinjtë në Shqipëri nuk lexojnë më. Ata lexojnë, shfletojnë, informohen, por nuk studiojnë. Këto dy të parat i bëjnë sa për të “marrë një notë të mirë” apo “marrë provimin”, ndërsa këtë të fundit sa për t’u dukur “cool”. Nuk është e nevojshme të realizosh një anketim apo studim në lidhje me këtë çështje: Është lehtësisht e deduktueshme nëpërmjet vrojtimit me sy të lirë në përditshmërinë e auditoreve apo në bisedat e lira me ta.

Nëse disa vite më parë në auditore kishte të paktën 10-20 studentë të cilët të përpinin fjalën nga goja dhe lexonin me një frymë çdo pjesë literature që iu jepje, sot ka vetëm 3-4 të tillë. Kjo është për të ardhur keq, vërtet. Nuk është teknologjia apo post-moderniteti që kanë sjellë këtë tendencë në vendin tonë, ashtu siç mund të mendohet rëndom. Disa muaj më parë kam punuar në një ambjent akademik në perëndim, dhe aty, megjithë zhvillimin e teknologjisë apo pasojat e post-modernitetit, të rinjtë nuk e kishin humbur etjen për dije. Përkundrazi, dukeshin më të interesuar se më parë për të kuptuar zhvillimin e botës, të njerëzimit e shoqërisë dhe sfidat e reja që bartte ky zhvillim.

Nuk është as moskalimi i pragut të mbijetesës arsyeja. Ekziston një bindje e përhapur në shoqërinë tonë se duhet “me pas” pastaj me “qenë”, pra e famshmja *primum vivere deinde philosophari*, e cila, duket të jetë i vetmi mësim e aplikuar nga ne prej antikiteti romak. Nuk qendron kjo sepse, dihet, ai ose ajo që ka dashur të studiojë, e ka bërë këtë edhe nën dritën e qirinjve. Nuk mund të qendrojë as arsyeja se pedagogët nuk janë “tërheqës” aq sa duhet apo nxitës mjaftueshëm të kureshtjes a mendimit kritik. Një pedagog i mirë padyshim ndihmon, por i vetëm nuk bën dot mrekullira.

Jo se arsyet që kam listuar më sipër nuk qendrojnë asfare, por ato nuk janë tërësisht përcaktuese në rënie e përgjithshme të interesit për të studiuar. Të rinjtë e sotëm nuk janë më të këqinj apo më pak të virtytshëm se në të shkuarën. Ata thjesht ata janë më pragmatistë dhe këtë, sa më shpejt t’u kuptojmë e të marrim masa, aq më mirë do të jetë për përmirësimin e të ardhmes e emancipimin e shoqërisë tonë.

Të qenët pragmatistë i bën ata të mendojnë se, në një shoqëri ku ende zbatimi i parimit të meritokracisë le shumë për të dëshiruar, është e kotë të rropatesh për të studiuar. Në fund fare, ata konkurrojnë mes tyre nëpërmjet “mikut” më të fortë, e jo dijeve më të shumta. Në fund të fundit, konkurrohet mes atyre që janë më të shkathët e jo mes atyre që janë më të aftë. Në disa sektorë të jetës tonë janë ulur aq shumë standartet sa, nëse dikush përpiqet ti mbajë lart ato e të mos lejojë që të tjerët të abuzojnë me rregullat, ai perceptohet si një njeri strikt e jo komod (në kuptimin pezhorativ të fjalës) e deri diku, si dikush i cili, duke mos lejuar të tjerët të bëjë allshverishe, thuaje i ka mohuar atyre të drejtën për “të bërë përpara” në jetë.

Ndërkohë, nuk duhet harruar se modelet e njerëzve të suksesshëm që iu ofrohen të rinjve janë shpesh ato të të pasurve të rinj të cilët mund të bëhen çfarë të duan e të bëjnë ç'të duan, pasi ata kanë, pra edhe “janë”. Intelektualët e njerëzit me vlera në më të shumtën e rasteve qendrojnë të strukur ose të pa promovuar nga politika. Nëse shtojmë këtu edhe mungesën e një debati serioz intelektual në lidhje me këto tema, atëherë mund të dilet lehtësisht në përfundimin se, të rinjtë bëjnë shumë mirë që janë pragmatistë e që nuk studiojnë. Ata të cilët nuk e kanë kuptuar mirë si funksionon bota janë në fakt ata, njerëzit që kanë derdhur djersë mbi libra apo janë rropatur për t'u perfeksionuar në profesionin e tyre. Të rinjtë që nuk studiojnë më, nuk kanë asnjë faj. Ata duan veç një diplomë sa për të kaluar kriteret formale të pranimit nëpër aplikime. Janë aftësi të tjera ato që iu duhen më pas: konformizëm, njohje, dukje, arrogancë dhe një dozë e mirë vetëbesimi prej të padituri.

Lufta me dy fronte COVID-19

| Apr 12, 2020 | [Blog-Debati Ana Lena](#)

Fakulteti i Drejtësisë, UT

Pandemia e Covid-19 ka shkaktuar në të gjithë globin një krizë, që mund të marrë përcaktorë të tillë si shëndetësore, ekonomike, institucionale, psikologjike, etj. Kësaj vorbulle nuk i ka shpëtuar as Shqipëria, e cila vetëm disa muaj më parë pësoi humbje të rënda njerëzore dhe materiale si pasojë e tërmetit të 26 nëntorit.

Ajo që në zhargonin popullor flitet si krizë, në kuadrin ligjor shqiptar njihet me termin e “masave të jashtëzakonshme”. Dhe në këtë shkrim do të trajtoj pikërisht rastin e gjendjes së fatkeqësisë natyrore dhe ‘fatin’ e të drejtave të njeriut pas shpalljes së saj.

Kushtetuta parashikon se masat e jashtëzakonshme mund të vendosen për shkak të gjendjes së luftës, gjendjes së jashtëzakonshme ose gjendjes së fatkeqësisë natyrore dhe zgjatim për aq kohë sa vazhdojnë këto gjendje¹. Si një sëmundje infective, pushtimi nga Covid 19 përbën një fatkeqësi natyrore.

Për parandalimin ose mënjanimin e pasojave të një fatkeqësie natyrore ose aksidenti teknologjik, Këshilli i Ministrave mund të vendosë, për një periudhë jo më të gjatë se 30 ditë, gjendjen e fatkeqësisë natyrore në një pjesë ose në të gjithë territorin e shtetit. Zgjatja e gjendjes së fatkeqësisë natyrore mund të bëhet vetëm me pëlqimin e Kuvendit². Kështu me vendim nr.243, datë 24.3.2020 me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe të ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave vendosi shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në të gjithë Republikën e Shqipërisë për shkak të epidemisë së shkaktuar nga Covid-19.

Gjatë gjendjes së fatkeqësisë natyrore mund të kufizohen të drejtat dhe liritë e parashikuara nga nenet: 37 (Paprekshmëria e banesës), 38 (Liria e lëvizjes), 41 paragrafi 4 (Shpërblimi nga shpronësimi), 49 (Liria e profesionit dhe mbrojtja shoqërore e punës), 51 (E drejta e grevës), të Kushtetutës 3.

Shumë shtete janë kritikuar nga organizatat e shoqërisë civile dhe media se nën pretekstin e pandemisë po dhunojnë të drejtat e liritë themelore⁴ dhe Shqipëria nuk i mungon kësaj liste, pavarësisht garancive kushtetuese dhe ligjore. Kjo duket qarte në: rastin e shtetasve shqiptarë që kane mbetur të bllokuar në kufirin greko-shqiptar në Kapshticë dhe Kakavijë prej datës 3 prill në kushte të vështira jetese dhe pa një argument bindës ligjor; kushtetueshmëria e akteve normative të Këshillit të Ministrave; projekt-amedamentet e maxhorancës për Kodin Penal ku parashikohen dëmime jo porprocionale me heqje lirie; debatin për publikimin e emrave të të infektuarve, etj.⁵

Kushtetuta sanksionon se organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre, duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre.⁶ Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë.



DEBATI UNIVERSITAR
PËR INTEGRIMIN



Këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut 7.

Shembujt e mësipërm tregojnë se si de facto po vihet në pikëpyetje parimi i njohur i padhunueshmërisë të të drejtave kushtetuese. Mesa duket Covid-19 ka prekur jo vetëm shëndetin publik por ka dobësuar edhe demokracinë. Ndërkaq mbetet për t'u parë si dhe sa do të respektohet shteti i së drejtës në ditët në vijim deri në mposhtjen e armikut të padukshëm.

Mundësitë që lindin për biznesin nga pandemia e COVID19

| Apr 12, 2020 | [Blog-Debati Erjon Curraj](#)

Sa i takon digjitalizimit, pandemia e COVID-19 ka disa lajme të mira si dhe disa jo aq të mira. Nga një anë kriza e shkaktuar nga kjo pandemi ka përshpejtuar adoptimin e digjitalizimit përmes përdorimit të zgjidhjeve digjitale për të punuar nga distanca (online) për një pjesë të bizneseve në Shqipëri. Megjithatë, kriza ka sjell rënie të fitimeve dhe si rrjedhojë të investimeve që do të mundësonin një transformim digjital të mirëfilltë duke u bazuar në një strategji të re të përshatur me kontekstin aktual dhe modelin e biznesit të një kompanie të caktuar. Kjo pasi pjesa më e madhe e sektorëve të ekonomisë ka filluar të ndiej pasojat e kësaj krize. Ajo çka është e sigurt është që pandemia COVID-19 ka formësuar tashmë nevojshmërinë për zgjidhjet digjitale edhe për SME-të, përfshi këtu edhe për ato Shqiptare.

Sikurse e thotë edhe Albert Einstein: ‘Në mes të çdo krize, ekziston një mundësi e shkëlqyer’, kështu edhe kjo krizë po ofron një mundësi për SME-të me synimin për të përdorur digjitalizimin në përfitim të tyre. Megjithatë sa të qëndrueshme do të jenë këto zgjidhje në rastin e Shqipërisë, por edhe më gjerë, varet nga mënyra sesi këto zgjidhje po zbatohen. Pyetja që ngrihet është: –A janë këto zgjidhje vetëm reagim i çastit në përgjigje të krizës apo ofrojnë ato një zgjidhje më të qëndrueshme e cila shkon përtej kohëzgjatjes së pandemisë? Gjasat e suksesit janë më të mëdha nëse zgjidhjet digjitale ofrohen si zgjidhje e qëndrueshme dhe të mirëbashkërenduara me një strategji të posaçme për çdo sipërmarrje. Kërkohej me patjetër që fillimisht strategjia të rishikohet me qëllim pasqyrimin e dinamikave të reja që shtrihen para nesh.

Pandemia COVID-19 do të riformësojë biznesin në nivel global. Për ne mund të mos jenë të qarta që tani të gjitha pasojat dhe sesi do të duket bota që na rrethon pas COVID-19. Megjithatë, është pak por e sigurt që mënyrat sesi kemi punuar dhe jetuar deri më tani do të ndryshojnë rrënjësisht. Në sferën e biznesit, prioritetet e kompanive po ndryshojnë nga ora në orë dhe vazhdimësia e pjesës dërrmuese të biznesit është nën një gjendje trysnie dhe paqartësie. Ka disa sektorë si ai i transportit ajror apo i turizmit që po humbasin shumë. Ka sektorë të tjerë si zinxhiri i furnizimit me ushqime dhe supermarketet që po rriten ndjeshëm. Në këto kushte të reja, është e nevojshme që të mendohet me kujdes strategjia dhe lidhja e ngushtë tashmë me vazhdimësinë e transformimit digjital.

Është e rëndësishme që të mos e nënvlerësojmë mundësinë që ka krijuar COVID-19 për transformimin digjital. Edhe pse gjatë këtij vrulli zgjidhjet digjitale kanë qenë të shpejta si përgjigje e kësaj situatë por me siguri në post-pandemi ato duhet të shndërrohen në transformime afatgjata digjitale të mënyrës sesi bëhet biznes në vendin tonë.

“E-commerce” po përjeton tashmë një rilindje në nivel global dhe madje një rritje të konsiderueshme edhe në Shqipëri. Për shkak të izolimit dhe distancimit fizik e social, konsumtorët po blejnë “online” gjithmonë e më shumë. “E-commerce” mund të rritet edhe më shumë në post-epidemi pasi ekonomia të fillojë rimëkëmbjen dhe konsumatorët ende mund të vazhdojnë të jenë të shqetësuar dhe t’i friksohen daljes në vende me densitet të lartë njerzish. Kjo do të thotë që kompanitë logjistike, magazinat dhe hallka të tjera në

zinxhirin e shpërndarjes duhet të ri-vlerësojnë dhe ri-modelojnë mënyrat e tyre të funksionimit për t'iu përgjigjur kërkesave të reja të tregut, por njëkohësisht edhe kërkesave të shëndetit publik.

Tregu për zgjidhjet e bashkëpunimit online dhe punës nga distanca (smart work) do të zgjerohet edhe më shumë në Shqipëri ngjashëm me tendecat botërore. Këto platforma kanë qenë vendimtare në ofrimin e mundësive për vazhdimësinë e disa bizneseve. Kështu psh. si përdorimi i video-konferencave apo ndërveprimi në distancë me sistemet e informacionit të kompanive. Tashmë qarkullojnë shumë platforma që mundësojnë këtë: psh Skype, ZOOM, WhatsApp apo Viber mund të jenë disa opsione të mundshme për dikë që do të komunikoj shpejtë dhe pa shpenzime.

Një shembull më profesional dhe i kompletuar është paketa e MS Office 365 bazuar në Cloud që ofron aplikacionin Microsoft Teams i cili mundëson anëtarëve të një skuadre të bashkëpunojnë online në shumë forma të ndryshme. Madje edhe në botën e argëtimit, të qëndrojmë online nga shtëpia është bërë e modës dhe madje duket sikur ka për të qëndruar e tillë për gjatë. Tashmë ka mundësi të shumta që ofrohen përmes teknologjive të përjetimit të realitetit të dubluar dhe virtual, që shijohen prej kohesh “online” nga shtëpia në mënyrë të sigurt (smart living). Këto teknologji po bëjnë të mundur rritjen e kërkesave për ture virtuale në muze, galeri apo edhe qendra historike, turistike e kulturore, apo hapja e bibliotekave online dhe aksesit i tyre i pakushtëzuar fizikisht (smart entertainment).

Të gjitha këto teknologji duke marr në konsideratë dhe rritjen e nivelit të përdorimit nga konsumatori fundor tregojnë se ku duhet të hedhi sytë sektori privat me qëllim investimin në dije apo në financa, ndërkohë që sektori publik në Shqipëri sugjerohet të investoj në politika nxitëse apo ato rregulluese duke nxitur kështu në mënyrë pararojë një cikël të pavarur nga ai privat nga arsimit e deri tek konsumi i këtyre shërbimeve (smart government).

Në këtë kushte, kompanitë që do përqafojnë novacionin e qëndrueshëm do t'ia dalin më së miri edhe pse realiteti është i paqartë dhe në ndryshim të vazhdueshëm. Secili sektor i ekonomisë përjeton pasoja të ndryshme nga kjo krizë ndaj do të kërkohet të përdoret strategji specifike e rishikuar për t'ia dalë mbanë. Pyetja kryesore që mbetet për çdo biznes është si të krijoj vlerë të shtuar në këto kushte të reja ku prioritetet personale të konsumatorëve dhe prioritetet publike e private po ndryshojnë?! Më pas na duhet t'i japim përgjigje pyetjes deri në çfarë mase duam të digjitalizohemi? Psh. a do të zëvendësojë mësimi online atë tradicional apo në përfundim të kësaj situatë do të vrapojmë me padurim drejt e në klasë për një leksion që mendojmë se mund të jetë më i hajrit me pedagogun fizikisht përpara nesh?! Në përfundim, mendoj që në post-epidemi ne duhet të ndërtojmë një realitet të kombinuar me pjesët më të mira të normalitetit të mëparshëm si në jetën private, në biznes edhe në sferën publike me elementët më të mirë që po ofron aktualisht kjo përvojë e distancimit dhe ‘botës online’.

Kjo krizë na ofron mundësi të eksperimentojmë, të provojmë ide të reja, të vlerësojmë mundësitë e reja, por në fund nëse duam ti marrim frytet e plota kërkohet reflektim dhe një ri-modelim i mënyrës sesi jetojmë, mësojmë, punojmë apo qeverisim. Për biznesin është e rëndësishme të ndërtojë dhe të mirëmbajë një kulturë të digjitalizimit. Këtu nënkuptoj mënyrat e reja të komunikimit, të punës, të mendësive të menaxherëve, pronarëve apo punëtorëve, pra në thelb praktikat e rimodeluara të punës dhe komunikimit.

Përpara nesh kemi një mision historik dhe këtu flas në emër të miqve dhe kolegëve novatorë të Shqipërisë pasi kërkohet që të shohin anën pozitive në post-krizë dhe të jemi më empatikë, më të kujdesshëm me të tjerët, të fokusohemi tek mësimi e përmirësimi i vazhdueshëm dhe mos të marrim asgjë për të mirëqenë por të vlerësojmë edhe gjërat e vogla në jetë duke shplurosur kështu ndjesinë e mirënjohjes dhe komunitetit. Detyra jonë praktike është të ndihmojmë kompanitë e vendit tonë që të kombinojnë vizionin, modelin e ri të biznesit me përqaftimin e transformimit digjital afatgjatë duke reflektuar mbi impaktin e tij me përgjegjshmërinë shoqërore, pasi kjo është formula që do të rris suksesin e kompanive në kapitullin e ri ekonomik. Në mënyrë që formula të funksionoj është koha të kuptojmë se kompanitë duhet të kenë përkulshmëri dhe efikasitet të lartë (agile & lean), ndaj kërkohet që drejtuesit e SME-ve të jenë mendjehapur dhe të aftë për tu rrethuar nga njerëz të pajisur me dijet e nevojshme.

Nuk e dimë nëse epoka e COVID19 do të mbahet mend si një e keqe e madhe apo si një moment historik që solli një mëndësi të re për t'i dhënë shtysë lindjes dhe fuqizimit të mënyrave të reja të të bërit biznes, mënyra novatore, më të qëndrueshme, më njerëzore dhe më të kujdesshme?!

Personalisht votoj për zgjedhjen e dytë pasi kam besim se edhe shumë si unë po e shohin këtë si zgjedhje pasi vetëm kështu SME-të mund të përballojnë sfidat e shumta që kanë përpara. Mbase kjo është më shumë shpresë sesa bindje por sërisht ne do të vazhdojmë të ecim në këtë drejtim duke ndihmuar sa më shumë kompani përmes strategjive të përshtatshme dhe harmonizimit të tyre përmes mjeteve dhe procesve të reja digjitale. Gjej rastin të ftoj të gjithë aktorët e tjerë të na bashkohen në këtë mision të përbashkët ku të gjithë veç fitojmë, ndaj le të jetë ky momenti ku ndërrohet faqja e mëndësisë së drejtimit të kompanive drejt udhëheqjes largpamëse (leadership).

Përqsaja e faktorëve të diamantit të Porterit në dimensionet e pasaportës tone europiane pas COVID19

| Apr 14, 2020 | [Blog-Debati Av. Erinda Hyska](#)

Bashkimi European na shfaqet si një tablo me vetëm një rrugë vajtjeje, rrugë kjo drejt prosperitetit, na vjen para syve tanë si një fenomen esencial për zhvillimin e gjithë rajonit dhe veçanërisht për zhvillimin e Shqipërisë.

Integrimi European është një proces i hapur për të gjitha vendet europiane, por udhëhiqet nga disa kritere, të cilat duhen përmbushur në mënyrë që të mundësojnë anëtarësimin në BE të shteteve të rajonit.

Kjo ka nxitur Shqipërinë për të marrë hapa të mëdha përpara, por të ecësh në rrugën e integrimit për në familjen e madhe europiane është një proces i vështirë. Arritja e këtij objekti do të thotë zhvillim i demokracisë, përparim ekonomik dhe ndërtimi i një shteti ligjor.

Perspektiva europiane bazohet te kushtëzimi. Vendet integrohen atëherë kur janë realisht gati për t'i bërë ballë detyrimeve gjë e cila përkthehet në një punë të vazhdueshme për realizimin e reformave.

Parë në këtë këndvështrim, unë kam sjellë në fokus teorinë e Diamantit të Porterit.

Porteri gjatë përpjekjeve të tij akademike ka zhvilluar një model të quajtur “Diamanti i Porterit” i cili bazohet në pesë faktorë, të cilët unë i kam sjellë brenda kornizës së përcaktuar nga Progres Raporti i Komisionit për Shqipërinë. Këta faktorë përbëjnë njëkohësisht edhe pesë prioritetet kyce që duhen përmirësuar.

Prioriteti i Parë: Reforma në Administratën Publike

Prioriteti i Dytë: Reforma në Sistemin e Drejtësisë

Prioriteti i Tretë: Lufta Kundër Korrupsionit

Prioriteti i Katërt: Lufta Kundër Krimit të Organizuar

Prioriteti i Pestë: Mbrojtja e të Drejtavë të Njeriut

Në një dimension tjetër unë kam sjellë kontekstin e integrimit të Shqipërisë në Bashkimin European, pasi njësoj si pesë faktorët apo forcat e diamantit të Porterit që një vend apo një industri të ketë avantazhe duhet të përqëndrohet në fuqitë e tyre të brendshme, edhe vendi ynë, në një përqsaje të tillë duhet të fokusohet në prioritetet e lartpërmendura

Porteri, jo më kot ka përcaktuar termin diamant për t'ju referuar këtyre kushteve në idenë e një sistemi të një kombi, ku efekti i një faktori është ngushtësisht i lidhur me gjendjen dhe zhvillimin e një faktori tjetër dhe nga njëra anë dobësimi i një faktori ka impakt negativ në të gjithë elementet e të gjithë sistemit.

Njësoj si në këtë model, me qeverinë që luan rolin e katalizatorit duhet të bëhen përpjekjet maksimale në secilin drejtim, në mënyrë që të lëvizim drejt niveleve të përcaktuara nga Bashkimi European.

Por, në momentin aktual kur bota është e përfshirë në zonën e turbullimeve për shkak të virusit Covid-19, padyshim që të kapërcehet kjo situatë nuk është e lehtë pasi kërkon një aksion të madh të përgjithshëm ndërgjegjësues e qytetërues, respektim maksimal të masave të ndërmarra, është periudhë kohore në të cilën duhet të mendojmë dhe të vëmë në lëvizje të gjithë fuqinë tonë të brendshme si shtet, duke gjetur rrugët më efektive në mënyrë që ta fitojmë këtë sfidë botërore.

Edhe pse në kohë tepër të vështira për të gjitha shtetet në përballje me këtë pandemi, ne jemi një shtet që e kemi të qartë se ku shtrihet e ardhmja jonë

BE-ja do të ketë përfitimet e veta kur Shqipëria të marrë “Pasaportën Europiane”. Megjithëse ne jemi një vend i vogël, jemi një nyje nevralgjike midis Ballkanit Perëndimor dhe Evropës dhe si shtet i tillë, përbëjmë një ndër faktorët kryesorë të gjithë rajonit që kemi se çfarë t’i ofrojmë Bashkimit European.

A do të jetë një e ardhme më e mirë pas Covid-19? Padyshim që po. Kemi përpara një sfidë të vështirë, por me mekanizmat e krijuar nga vendi ynë, me besim e disiplinën e duhur, gjithçka do të ketë efektivitet e pavarësisht ditëve të tilla do ja dalim. Këto janë momente reflektimi edhe për çdo individ. Në këto ditë të vështira, mund të japim më të mirën nga vetja jonë, mund të bëhemi shembull në shumë aspekte për komunitetin ku jetojmë, në këto ditë të vështira jemi më pranë njërezve që duam, në këto ditë të vështira jemi të gjithë, për të gjithë.

Sa për integrimin në Bashkimin European? Patjetër që Unioni është i angazhuar për anëtarësimin e Shqipërisë, kam besim se shteti ynë do bëjë maksimumin mbi rekomandimet e dhëna sepse mbi të gjitha një Europë më e madhe, nënkupton një Europë më të fuqishme.

Qasja mbi respektimin e të drejtave të njeriut përgjatë krizës së Koronavirus

| Apr 16, 2020 | [Blog-Debati Av. Megi Kurti](#)

Në një kohë të tillë të pazakontë në të cilën gjenden të gjitha shtetet, masat e ndërmarra kundrejt parandalimit apo mbajtjes në kontroll të shifrave të të prekurve nga ky virus, padyshim shëndeti i qytetarëve është thelbësor.

Komisioni European dhe Këshilli kanë ndërmarrë masa ekonomike të larta duke përdorur të gjithë fuqinë e buxhetit European për rikuperimin në masë të industrive e shërbimeve të mëdha të cënuara e dëmtuara nga kriza aktuale, me qëllim rikuperimin “pas-korona”.

Megjithatë, krahas aspekteve ekonomike që kriza cënon, masat e marra nga shtetet, për shkak edhe të detyrimeve që shtetet kanë si palë kontraktuese në instrumente ligjore ndërkombëtare, përballen me një sfidë juridike për zbatimin e njëkohshëm të detyrimeve ndërkombëtare dhe moscënimin e tyre në rang ndërkombëtar. Për këtë është më së shumti i angazhuar Këshilli i Europës fokusi i të cilit është respektimi i të drejtave të njeriut. Të drejtat e njeriut, respektimi i demokracisë dhe zbatimi efektiv i ligjit janë disa nga pikat kyçe që sfidojnë çdo qeveri të shteteve ndërkohë që hartojnë e zbatojnë masat më emergjente të kohës.

Lidhur me këtë problematikë, në javën e parë të prill 2020, Sekretare e Përgjithshëm i Këshillit të Europës, Marija Pejčinović Burić u ka dërguar të gjitha qeverive në Europë një sistem masash që duhen mbajtur parasysh për respektimin e të drejtave të njeriut, demokracisë dhe sundimit të ligjit përgjatë krizës nga COVID-19. Ky dokument i dërguar 47 shteteve anëtare të Këshillit të Europës detajon mundësitë ligjore të derogimeve nga disa prej detyrimeve që shtetet kanë marrë përsipër si palë kontraktuese në instrumente ligjore ndërkombëtare.

Sikurse Sekretare e Përgjithshme citon, *“Virusi po shkatërron shumë jetë, por nuk duhet të lëmë të shkatërrojë vlerat tona thelbësore”*. Ajo shton se, *“Sfida madhore sociale, politike dhe ligjore me të cilën po përballen shtetet anëtare lidhet me aftësinë e tyre për t’ju përgjigjur në mënyrë sa më efektive kësaj krize, ndërkohë që sigurojnë se masat e marra nuk prekin interesat thelbësore afatgjata në ruajtjen e vlerave themelore Europiane të të drejtave të njeriut, të demokracisë dhe sundimit të ligjit.”*

Dokumenti i shpërndarë në formën e një pakete, çdo qeverie të shteteve anëtare të KE shërben për t’i ofruar ndihmë në përballjen me krizën aktuale të paprecedentë e në shkallë masive, por duke ruajtur proporcionalitetin e marrjes së masave me kërcënimin që po përballlet dhe duhet të jenë të kufizuara në kohëzgjatjen e tyre.

E shprehur në trajtën më të përmbledhur, paketa ndihmues mbulon katër fusha kryesore:

- Derogimi nga detyrimet e Palëve të Larta Kontraktuese nga Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNj) në kohë emergjence;

- Respektimi i sundimit efektiv të ligjit dhe parimeve demokratike në kohë emergjence, duke përfshirë parimin e vendosjes së masave në kufijtë e fushëveprimit të krizës dhe në kohëzgjatjen e masës emergjente;
- Standardet e të drejtave themelore të njeriut duke përfshirë lirinë e shprehjes, privatësisë dhe mbrojtja e të dhënave personale, mbrojtja e grupeve vulnerabël nga diskriminimi dhe e drejta për edukim;
- Mbrojtja nga krimi dhe mbrojtja e viktimave të krimit, veçanërisht të dhunës me bazë gjinore.

Shkurtimisht, secila nga katër fushat vendos theksin në disa elementë që shtetet duhet t'i kenë parasysh kur ndërmarrin masa, por do të ndalem kryesisht në dy pikat e para për t'i shpjeguar në aspektet parimore që përfshijnë.

Për pikën e parë të derogimeve, derogimet nga KEDNj parashikohen në nenin 15 të Konventës, por këto derogime janë gjithashtu subjekte të zbatimit të kërkesave formale që lidhen me njoftimin e Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës mbi masat e marra, arsyet dhe kohëzgjatjen e parashikuara të tyre. Krahas të drejtave të parashikuara në Konventë, disa të drejta janë të paderogueshme, si e drejta e jetës (Neni 2 KEDNj); ndalimi i torturës dhe trajtimit çnjerëzor e degradues (Neni 3 KEDNj); ndalimi i skllavërisë (Neni 4/1 KEDNj); dhe parimi i mosdënimit pa ligj *Nulla poena sine lege* (Neni 7 KEDNj). Po kështu, nuk mund të derogohet nga shfuqizimi i dënimit me vdekje apo e drejta për të mos u gjykuar apo ndëshkuar dy herë (Protokollet nr. 6 dhe 13, si dhe Neni 4 i Protokollit nr. 7 të KEDNj).

Lidhur me pikën e dytë, të respektimit të demokracisë e sundimit të ligjit në kohën e emergjencave janë të caktura në mënyrë eksplicite cilat janë kushtet e zbatimit. Në aplikimin e këtyre detyrimeve duhet të respektohen: *parimi i ligjshmërisë* (edhe në situata emergjente, parimi i sundimit të ligjit prevalon; *parimi i kohëzgjatjes së kufizuar në kohë masave emergjente* (në situata emergjente shprehet Këshilli i Europës në dokumentin e dërguara qeverive, qeveritë mund të vendosin masa me efekt të përgjithshëm që kanë forcën e ligji, por kjo duhet të jetë e limituar për aq sa janë kushtet e emergjencës. Është pikërisht ky kuptimi i emergjencës, marrja e masave sa më të shpejta dhe efektive për t'ju rikthyer sa më parë normalitetit dhe jo të merren vendime që zgjaten në kohë pas situatës emergjente.); *Parimi i domosdoshmërisë së legjislacionit në kohë emergjence* (në kohë emergjence, Këshilli i Europës përmend parimin e përgjithshëm të mosmarrjes së masave apo reformave ligjore të mëdha, këto duhet të mbeten pezull deri në kalimin e situatës); *Shpërndarja e kompetencave dhe kontrollet mbi veprimet ekzekutive gjatë regjimit të gjendjes së emergjencës* (Autoritetet ekzekutive duhet të kenë aftësinë të veprojnë shpjet dhe në mënyrë efektive. Po kështu Parlamenti duhet të ruajë pushtetin e kontrollit të veprimeve ekzekutive. Nga ana tjetër, funksioni themelor i gjyqësorit, veçanërisht i Gjykatave Kushtetuese, kur ato ekzistojnë, duhet të ruhet edhe në kohën e krizës. E rëndësishme është të ekzaminohen kufizimet e shkeljet më serioze të të drejteve të njeriut që vijnë për shkak të legjislacionit të miratuar në kohë emergjence.)

Këto ishin disa nga interpretimet juridike që i takojnë dokumentit paketë ndihmuese që qeveritë, ndër të tjera dhe qeveria jonë, kanë marrë për mbajtjen në kontroll dhe në vemendje edhe të parimeve bazë e themelore edhe në kohën e krizës.

E gjithë situata ka ndikuar në nivel botëror në çdo aspekt. Madje ndikimi në disa elementë siç mund të jetë telepuna apo zbatimi i teknologjisë mund të pasojnë edhe në kohën “pas-korona”, e rëndësishme është të ngrihemi pas një trysnie të tillë.

Sikurse presidente e Komisionit European Ursula von der Leyen shpreh në fjalimin e mbajtur në Parlamentin European, *“Europa është ajo që bën çfarëdo është e mundur për të mbrojtur jetë e çdo jetesë, ajo që është e hapur për të ndihmuar të tjerët, por di dhe mund të kujdeset edhe për veten dhe të ngrihet pas një krize të tillë përmes një investimi dhe bashkëpunimi.”* Duke shtuar se, *“Thonë që një shpirt i fort shkëlqen akoma më fuqishëm pas çdo stuhie, ndaj nëse të gjithë përpiqen me kurajo, besim dhe solidaritet shpirti i Europës do të shkëlqejë edhe më shumë se më parë.”*

Pavarësisht viteve që kanë kaluar që nga përmendja për herë të parë të parimeve të tilla të bashkëpunimit si, prosperiteti, solidariteti, tregu i vetëm European dhe parimet më të larta të Europës që kanë iniciuar për herë të parë nevojën e bashkimit të shteteve në një Bashkim European, duket se dalin në pah dhe nevojiten më së shumti në kohë të tilla, kur shtetet, jo vetëm ato të Bashkimit European, por çdo shtet duhet të mendojnë në mbrojtje të interesave afatgjatë krahas menaxhimit të situatës.

Dobitë e ekonomisë së tregut në shoqërinë shqiptare

| Apr 16, 2020 | [Blog-Debati](#) *Renis Bakalli*

Viti 1776. Adam Smith me pasurinë e kombeve i dha shoqërisë teorinë moderne të zhvillimit ekonomik duke argumentuar se ndërhyrja shtetërore në ekonomi është përgjithësisht e dëmshme dhe se interesit public i shërbehet më mire nëpërmjet konkurrencës në tregun e lirë. Megjithëse Smithi e shkroi këtë libër për të kaluar kohën ai e pa atë në këndvështrimin e ndikimit social si për punëtorët, murgjit, fermerët, tregtarët, pronarët e anijeve etj. David Ricardo pak kohë më vonë i dha jetë teorisë së tij të avantazheve krahasuese e cila qëndron në thelb të të gjitha marrëveshjeve të mëpastajshmë të tregtisë së lirë duke i dhënë hov zhvillimit ekonomik të vendeve.

Shekuj më vonë, Ayn Rand, një noveliste e shekullit të 20-të dhe një nga influencueset e Alan Greenspan (njeriu më jetëgjatë në krye të Rezervës Federale Amerikane), do të mbronte zellshëm principet e arsyes dhe kapitalizmin “Laissez faire” në novelën e saj të katërt, të fundit dhe më të gjatën, “Revolta e Atlasit”. Ajo do të përshkruante një shoqëri imagjinare, çnjerëzore dhe të pakënaqur në limitet e saj; ku njerëzit e mendjes, si krijues, novatorë, sipërmarrës dhe industrialistë të shquar dhe të suksesshëm të shoqërisë, në përgjigje të ndërhyrjeve, kontrolleve dhe rregulloreve të reja agresive të qeverisë, braktisën pasurinë e tyre bashkë me kombin, braktisje pas së cilës shoqëria pësoi një kolaps. Mendja u fut në grevë, duke e lënë qeverinë të lirë të përballet me realitetin që krijuan.

Shqipëri, 1991. Një sistem i ri vendimmarrje, lindja e pluralizmit politik, më shumë liri dhe të drejta themelore, Hapja e tregut, ekonomia e lirë dhe lindja e sipërmarrjeve private solli nevojën për një reagim të shpejtë dhe profesional ndaj kërkesave të shoqërisë dhe të tregut. Hapja e tregut të punës, inovacioni, ndryshimet e shpejta në teknologji, mjedisi i të bërit biznes dhe rritja e konkureshmërisë në tregun ndërkombëtar e bënë nevojën për përshtatjen një domosdoshmëri. Të mëdhenj apo të vegjël, prodhues apo tregtarë, ndërkombëtarë apo familiarë, njerëz të guximshëm dhe novatorë, që në kohëra të turbullta patën idenë e çmendur të të bërit biznes, patën sukses. Nëpërmjet sistemit ekonomik të decentralizuar ato ndërtuan atë që sot quhet “Kapitali” që nëpërmjet taksave mban në këmbë struktura burokrate shtetërore, punëson njerëz, ndërton rrugë, shkolla e spitale, i jep frymëmarrje ekonomisë dhe përballet me sfidat e panumërta të qeverisë. Qeveri, që prej 30 vitesh përvese aspak jo të vogla kanë qenë inefficente dhe jotransparente. E këto të mbështetura nga një sistem gjyqësor në nevojë immediate për ndryshim dhe gjithmikonë të ndjekur nga shqiptarë tanimë të lodhur nga ky sistem i ngritur dhe që si shpresë të vetme shohin braktisjen e vendit. Qeveri në vende të ndryshme të botës edhe së fundmi kanë vënë re një ndikim më të madh të ekonomisë së tregut që bazohet në pronën private në raport me ekonominë e centralizuar që mbështetet në pronën publike. I gjithë ristrukturimi i ekonomisë së vendeve të ish bashkimit sovjetik, privatizimi i mjaft industrive në Mbretërinë e Bashkuar apo Francë si dhe reduktimi i nivelit të taksimit në Shtetet e Bashkuara e theksojnë edhe më shumë këtë dallim midis privates dhe publikes.

Pavarësisht të gjitha dobive, raporti më i fundit i Doing Bussines (i cili na rendit në vendin e 82-të me një rënie prej 19 vendesh nga viti i kaluar) vë theksin në problematikat që çdo sipërmarrës has në të bërit biznes në Shqipëri. Vazhdon të mbetet mjaft problematike trajtimi jo i duhur fiskal dhe ligjor, mosrespektimi i

kontratave, paqëndrueshmëria politike, lufta kundër informalitetit dhe korrupsionit, transparenca e tenderave public dhe paparashikueshmërie e politikave ekonomike. Masat ligjore dhe administrative të qeverisë, agresiviteti i strukturave shtetërore ndaj biznesit në tërësi, mungesa e mbështetjes dhe lehtësirave për zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë, aksione të shpejtuara të shoqëruara me kontrolle të tepruar sjellin një klimë frike duke bllokuar tërësisht ekonominë dhe mendjen krijuese në këtë vend.

Për çka më sipër, në funksion të përmirësimit të masës reaguese të shoqërisë dhe për maksimizimin e dobisë nga ekonomia e lirë, një investim serioz në arsim do të ishte përcaktuese e një epoke transformuese në ekonominë dhe shoqërinë shqiptare.

Kriza është EDHE një mundësi e re, mos e lër të ikë!

| Apr 16, 2020 | [Blog-Debati Nevila Xhindi](#)

Al Gore, ish sekretari amerikan i shtetit, në ligjëratën e tij për cmimin Nobel në Oslo në dhjetor 2007 pat thënë: “Në shkronjat Kanji të përdorura si në gjuhën kineze apo edhe në atë japoneze, fjala” krizë “shkruhet me dy simbole, kuptimi i parë është “rrezik” dhe e dyta “mundësi “. Mu dukën aq me vend këto fjalë, tek rastisa ti lexoj ndër dhjetra faqe lajme mbi Covid-19, dhe unë sot zgjodha të fokusohem pak tek e para “kriza’, e më shumë tek e dyta” mundësia”.

Në çështjen e disa javëve, konteksti ynë u zhvendos në mënyra të pabesueshme, bota po jeton me të papriturat zinxhir të një një krize sfiduese! Pandemia e koronavirusit po merr jetë dhe po shkatërron ekonomi, po zbulon dobësitë e sistemeve kombëtare të kujdesit shëndetësor, ka c’orientuar shkollat, universitetet, bizneset, jetën shoqërore dhe po hedh dritë mbi paaftësinë e disa udhëheqësve politikë për të menaxhuar situatën. Kjo krizë na kujton se duke jetuar në këtë planet të vogël tonin jemi të gjithë sa përgjegjës dhe përfitues, jemi nën të njëjtin qiell-cati, ndajmë të njëjtin hall-si një familje e madhe, jemi të ndërlidhur dhe të ndërvarur – dhe mbi të gjitha kemi nevojë për njëri-tjetrin.

E vërteta është se çdo krizë, megjithëse është thellësisht shqetësuese, përmban edhe farat e mundësive dhe risive. Kur përballemi me një lloj krize si kjo që kalojmë sot, duhet të kujtojmë tre gjëra:

Së pari, si ta përballojmë këtë krizë tani? Kjo pyetje është më e rëndësishmja në mendjen e njerëzve – ashtu siç edhe duhet të jetë – dhe gjithashtu ka tendencë të dominojë lajmet. Së dyti, a është kjo një mundësi për ndryshim? Cfarë mundësish krijon kjo krizë? A është koha të flasim për to? Së treti, çfarë mund të bëhet për të parashikuar krizat në të ardhmen dhe përgatitjen e tyre? Edhe nëse nuk është e mundur të parashohësh një krizë në të ardhmen, si mund të përgatitemi të reagojmë shpejt dhe me efektshmëri?

Ndërsa shumica e njerëzve përqendrohen vetëm në pyetjen e parë, e cila ka të bëjë me mbijetesën e menjëhershme, unë mendoj se tashmë ka ardhur koha të shikojmë mundësitë për inovacion dhe transformim dhe të ofrojmë zgjidhje efektive për veten dhe shoqërinë.

Transformimi dixhital nuk ka qenë kurrë më i rëndësishëm dhe më present se tani. Në këto javë kemi parë që kjo krizë i “detyroi” mësuesit, pedagogët dhe studentët të jenë virtualisht aktiv, dhe gati profesionistë të mësimdhënies digitale duke zhvilluar matematike, kimi, vizatim apo duke shpjeguar makroekonomi dhe tregje financiare. Po kështu, transformimi digital përfshiu dyqane rrobash online, bare, restorante me shërbim në familje, fermerët po shesin prodhimet e tyre në internet, sigurisht që kjo përfshin vetëm një numër të vogël në krahasim me shumë njerëz që nuk kanë sot njohuri teknike ose ekspertizë për të ndërmarrë një tregti elektronike, por u kthye në mundësi dhe po ndodh.

Kjo është një kohë për të qenë më produktivë duke përvetësuar aftësi të reja, si njohja e platformave dixhitale dhe vebinars, përmirësimi i një gjuhe të re ose një instrumenti muzikor. Është kohë për të parë dokumentarë historikë, shkencore, apo ato tw naturws. Shumë prej nesh iu rikthyen librave të lënë

mënjë, thirrjeve për grante kërkimesh shkencore, shkrimit të artikujve shkencore. Kjo është një kohë, e ndër të rradhat deri më tani, ku dija dhe kultura qytetare kanë zënë vend në ekranet televizive dhe mediat sociale. Është koha kur dëgjojmë të flasin më shumë mjekw, ekonomistë, sociologë...është kohë dhe mundësi për të ndryshuar!

Eksperimentimi dhe inovacioni janë tashmë të domosdoshëm. Ne duhet të jemi inovator në gjithçka që bëjmë, por sigurisht nuk mund të bëjmë gjithçka menjëherë. Duke pasur parasysh paqartësitë gjatë kesaj krize, mënyra e vetme që mund të jemi inovatorë është minimalisht të përmirësojmë metodologjikisht dhe konceptualisht, vazhdimisht- atë që bëjmë. Kjo mund të arrihet vetëm përmes eksperimentimit të vazhdueshëm. Të gjithë duhet të mendojmë se si gjërat mund të bëhen ndryshe dhe më mirë, ndërsa po përpiqemi ti bëjmë...Secili në mënyrën dhe mundësinë që ka duhet të eksperimentojë, dhe mbi të gjitha, le të mësojmë edhe nga eksperimentet e sukseshme që po ndodhin përreth nesh...

Publikuar fillimisht: [Exit.al](#)

Kriza e neoliberalizmit, sistemit të organizatave ndërkombëtare

| Apr 21, 2020 | [Blog-Debati Elvisa Qosja](#)

Deri më sot ishim mësuar me një marrëdhënie të ngushtë midis shteteve, ku nëse një shtet do të kishte një problem, do të zgjidhje nga organizatat ndërkombetare, dhe anëtarët e tjerë do të solidarizoheshin me situatën e ndodhur. Ishim mësuar me një Amerikë që do të shprehte solidaritet e të bëhej bashkë moralisht madje dhe me ndihmë të drejtpërdrejte për shtetin në nevojë, anëtar të organizatës.

Marrëdhënia e SHBA-së dhe Evropës Perëndimore ka qenë e ngushtë për vite të tëra, kjo si pasojë e interesave të ndersjelltë dhe qasjes demokratike që ato kishin. SHBA-ja ka qenë gjithmonë një aleat i ngushtë për Evropën Perëndimore. Kjo u pa më qartë gjatë luftës së ftohtë ku interesi ishte më i madh sepse BS nuk duhej lënë që të kishte ndikim e të fuqizohej më shumë

Por, edhe pse ishin bashkë në një kah, shtetet e Evropës Perëndimore dhe SHBA-të u treguan egoistë. Ato kërkonin që të fuqizoheshin dhe të rrisnin hegjemoninë e tyre duke përfitur nga aleanca. Rast i tillë është çështja e Egjiptit në 1955 ku SHBA, Britania dhe Franca ishin bashkë për të larguar ekspansionizmin e komunizmit. Në një moment, SHBA largon Britaninë dhe Francën nga zonat që kishin influencë duke i vendosur këto zona nën ndikimin e saj. Është pikërisht momenti ku Franca e kupton që duhet të kishte ushtri të sajën të fuqishme. Por, në këtë moment, gjithashtu u vu re që edhe një shtet i dobët e pa influencë si Egjipti po luante me dy superfuqitë botërore dhe boshtet Perëndim – Lindje. SHBA i ofronte ndihmë per Digën e

Asuamit ndërkohë që Egjipti njihte Kinën komuniste.

Siç e shohim, edhe shtetet e vogla mund të luajnë një rol të madh në momentë të caktuara historike. Marrëdhënia e arenës ndërkombëtare është egoiste. Ndonëse shtetet më të fuqishme rreken të shfrytëzojnë ato më të vogla, Perëndimi na është shfaqur gjithmonë i bashkuar dhe shtetet afër njëri – tjetrit. Por sot po shfaqet një realitet tjetër. Shtetet perëndimore po bëhen çdo dite e më shumë egoiste, ndërkohë që organizatat heshtin në interes të shteteve më të mëdha e më të fuqishme.

Pikërisht në këtë kohë të vështirë shikojmë një Itali që zë vendin e Frances në 1955. Italia sot ndodhet e vetmuar përballë pandemisë botërore. Jo se shtetet e tjera janë bashkë, por duke qenë se Italia po e vuan më shumë se çdo vend tjetër pasojat e kësaj sëmundjeje, ajo nuk po merr ndihmë, sidomos nga Bashkimi Evropian. Një nga qëllimet e BE-së është ndihma, zgjidhja bashkërisht e problemeve, por sot BE e la vetëm Italinë. Interesant është fakti se BE ndihmon Ballkanin Perëndimor dhe jo një shtet anëtar të saj. BE braktis Italinë dhe kërkon të rrisë ndikimin në Ballkanin Perëndimor. Mos ndoshta kjo sjellje është si kundërpërgjigje a mesazh ndaj Italisë?! Apo Italia nuk ka ku shkon ndërsa në Ballkanin Perëndimor mund të rrisë ndikimin e saj Turqia, Kina ose Rusia?!

Pasi të kalojë e gjithë kjo, mendoj se struktura në marrëdhëniet ndërkombëtare nuk do të ndryshojë thelbësisht. Organizatat do të vazhdojnë të funksionojnë në interes të shteteve më të fuqishme. Shtetet do të nxiten disi drejt nacionalizmave, do të përpiqen që gjithnjë e më shumë në interesat e tyre kombëtare por pa u shkëputur nga marrëdhëniet e jashtme sepse siç e pamë në rastin e Italisë, vetëm nuk mundt'i dilet.

Le të shpresojmë se koha do të shërojë edhe këtë plagë e do ta bëjë që të mbetet një kujtim i hidhur njëjtë si tërmetet gjatë vitit 2019. Gjithsesi, po koha do ta tregojë.

Demokracia vs Diktatura: Kush e përballoi më mirë Korona Virusin

| Apr 25, 2020 | [Blog-Debati Marlin Muça](#)

Në nëntorin e vitin 2019, provinca e Hubei në Kinë, më konkretisht, qyteti i Wuhanit u përball me një valë misterioze gripi që shkaktonte pneumoni. Qysh prej nëntorit të vitit që lamë pas e deri në ditët e sotme, bota është ngërthyer nën thundrën e masave të rrepta të distancimit social. Këto masa kanë bllokuar prej dy muajsh veprimtarinë ekonomike në shumë vende të botës, duke lënë miliona të papunë dhe rrezikuar falimentimin e miliona biznesve të tjera që e lidhin aktivitetin e tyre posacërisht me lëvizjen e lirë të mallrave brenda apo jashtë vendit. Teksa kostoja ekonomike rritet, një luftë po kaq e egër politike ka nisur mes superfuqive aktuale për të hedhur fajet mbi shperthimin e më pas përhapjes së gjerë së COVID19 në pothuajse të gjitha kontinentet e botës. Kjo luftë, përveçse na tregon pak a shumë krizën e afërt politike në marrëdhëniet ndërkombëtare, nxjerr në pah dhe dallimet që vendet të cilat aplikojnë sisteme politike të ndryshme nga njëri tjetri, kanë shfaqur në trajtimin e përballimin e këtij virusi vdekjeprurës. Sistemet totalitare në ndryshim nga demokracitë liberale kanë mundësinë të mobilizojnë resurse natyrore dhe njerëzore pa patur detyrimin për t'iu përmbajtur ligjit apo ndonjë procedure të caktuar. Në raste të tjera, ky privilegj i ka shërbyer diktaturave për të kryer raprezalje të ashpra për qëllime të caktuara politike. Kina vuri në karantinë rajonë të tëra në territorin e saj, kreu kontrole të imtësishme duke shkelur liritë dhe të drejtat e njeriut. Si rrjedhojë e kësaj specifike që totalitarizmi ju mvesh qeverive, Shteti Kinez arriti në pak pak muaj të ndalte përhapjen e virusit brenda vendit dhe dalëngadalë t'i rikthehej normalitetit ekonomik e shoqëror. Kjo natyrisht, jo para se virusi të kapërcente kufijtë e saj, për të mbërritur fillimisht në shtetet aziatike e më pas në Europë, SHBA e gjetkë. Në kohën kur shtetet europiane filluan të raportnin rastet e para klinike me korona virus, epidemia kishte prekur një numër të lartë njerëzish, pavarësisht se shumica e tyre do ta kalonin virusin pa simptoma. Hallkat ligjore që duheshin ezauruar, një opinion publik i vetëdijshëm për lirië e të drejtat e veta dhe frika për një recesion ekonomik vonoi miratimin e masave për parandalimin e virusit duke i hapur rrugë mijëra viktimave dhe një sistemi shëndetësor në prag kolapsi. Natyra demokratike e shteteve perëndimore u vë atyre përpara një sërë pengesash të një karakteri jo vetëm juridik por edhe politik. Masat e marra duhen miratuar në Parlament e atje patjetër që ka forca politike të cilat në rastin më të mirë vonojnë procesin legjislativ për të dhënë rekomandimet e saj lidhur me mënyren e përballjes me situatën e në rastin më të keq, forca të tjera politike që tentojnë të kapitalizojnë masat drakoniane që duhen të ndërmerren në periudha të tilla në emër të shëndetit dhe sigurisë publike. Kjo është e pamendueshme në një vend si Kina, e cila para pak muajsh zhvendosi në kampe përqëndrimi mbi një milion ujqurë me pretekstin e luftës kundër terrorizmit. Pavarësisht qasjes së ekonomisë së tregut dhe modernizimit, Kina ruan një sistem politik monopartiak ku mendimi ndryshe dhe lëvizjet opozitariste dënohen me burg dhe me masa të tjera të ashpra dënimi. Marrëdhënia me informacionin

Kina apo shtete të tjera si Irani, Korea e Veriut etj kanë mediat e tyre shtetërore të cilat informojnë publikun apo dhe botën e jashtme për zhvillimet e vendeve të tyre. Kur pacientet e parë me virus u hospitalizuan në provincën e Hubeit Kina refuzoi ndihmën e OBSH dhe nuk ngriti alarmin për një virus të ri, shumë ngjithës dhe me efekte të rënda në shëndetin e të moshuarve apo njerëzve me komplikacione të tjera shëndetësore.

Centralizimi mediatik i shoqëruar me terrin informativ mbi çështje që rrezikojnë pushtetin e brendshëm politik shkaktoi përhapjen e shpejtë të virusit jo vetëm brenda Kinës, por edhe jashtë saj. Nëse Kina si shteti i parë i prekur do të bënte transparente situatën me epideminë, masat do të merreshin më shpejt dhe sot nuk do të kishim një numër kaq të lartë të viktimave. Fshehja e informacioni nuk lidhet me qëllimin e mospërhapjes së panikut. Diktaturat fshehin ato informacione që mund të rrezikojnë pushtetin e tyre apo ndikimin e këtij pushteti në shoqëri.

Europa dhe SHBA janë një histori krejt tjetër. Në këto dy qendra të mëdha politike të botës kemi të bejmë me gazetari agresive, media të pavarura nga pushteti të cilat anojnë më shumë kah së vërtetës. Natyrisht që edhe këtu kemi media që iu shërbejnë interesave privatë të pronarëve të mëdhenj, por këta pronarë të mëdhenj janë kaq shumë sa është e pamundur që të gjithë këta të fundit të rreshtohen symbyllazi me pushtetin. Diversiteti i burimeve të informimit i mban njerëzit të informuar dhe më pranë së vërtetës. Përhapja e pandemisë mbikëqyret live nga të gjitha mediat e botës së lirë duke mos lënë dyshime se të dhënat manipulohen apo mbi shkallën e përhapjes së virusit. Transparenca garanton realizmin e trajtimit të virusit në popullsi dhe mbajtjen e qeverisë përgjegjëse për çdo paaftësi apo papërgjegjshmëri në lidhje me situatën.

Sa i përket Shqipërisë, edhe kësaj here ajo përfitoi nga rasti për të treguar se nuk i përket as Lindjes as Perëndimit. Dyshimet se virusi ka qarkulluar që në shkurt u kthyen në hipoteza të forta kur zyrtarë të lartë të Institutit të Shëndetit Publik pohuan se ka gjasa se epidemia ka hyrë më herët se data zyrtare e shpalljes së saj nga institucionet shtetërore. Fshehtësia me të cilën bëhen tesimet, nr i pakët i tyre dhe mosraportimi i rasteve të para të shkurtit shkrin eksperiencën e autokracisë kineze me menaxhimin gjoja europian të krizës, të mbushur me spote televizive një spektakel mediatik cdo mbrëmje dhe postera gjoja motivues në rrugët e Tiranës. Shqipëria vazhdon të mbetet një karikaturë e keqe në mesin e dy qytetërimeve, fisk si pantallonat e arnuara një mijë herë të kohës së Enverit. Pasoja

Trajtimi dhe përballimi i virusit nuk mund të kufizohet vetëm te nr i viktimave të secilit vend. Padyshim që numri i pakët i viktimave është një tregues pozitiv për situatën, por masat e marra kundër pandemisë përbëjnë një proces që ndikon në shumë faktorë përveç jetës së njerëzve dhe pa diskutim që nxjerr në pah një miriadë të tërë problematikash të pazbuluara apo të lëna në hije më parë.

Italia e ka kaluar nr zyrtar të viktimave të Kinës, por askush nuk e di nëse shifrat e dhëna nga Qeveria Kineze janë autentike. Në mungese së një media të pavarur dhe ndalimi i mediave apo autoriteteve botërore për të raportuar situatën nga atje vë në pikpëpyetje të thellë gjithë efektshmërinë e bllokimit. Në një botë globaliste, të lidhur nga vektorë të ndryshëm ekonomikë dhe lëvizjes së lirë të njerëzve, pasojat e veprimeve ose mosvprimeve të një vendi ndikojnë dhe tek vendet e tjera. Ndaj dhe masat e rrepta të marra nga autoritetet kineze nuk na sigurojnë për shifrat reale të viktimave. Mungesa e shkëmbimit të informacionit me OBSH dhe partnerë të tjerë solli përhapjen e shpejtë të epidemisë në pjesën tjetër të botës duke shkaktuar mijëra viktima dhe miliarda euro dëme.

Shtetet demokratike mund të kenë patur probleme me miratimin apo implementimin e masave të karantinës bashkë me mbingarkesën e spitaleve. Mirëpo kjo nuk është pasojë e veprimeve të qëllimshme e as manovrave për të fshehur situatën. Vende si Korea e Jugut apo Tajvani ia dolën me sukses ta mundnin virusin për shkak të zhvillimit ekonomik, teknologjik si dhe mireqënies së qytetarëve. Shtetet perëndimore po dalin nga kriza duke propozuar paketa miliarda eurosh ndihmë për qytetarët e prekur nga kufizimet ekonomike. Ndërkohë Kina asnjëherë nuk i ka kushtuar rëndësi fuqizimit ekonomik të individit për shkak të modelit kolektiv që ajo ndjek në ndërtimin e marrëdhënieve shoqërore. Shanset janë që ekonomia vendasve kineze të pësojë goditje të fortë duke ulur rritjen ekonomike dhe duke përkeqësuar njëkohësisht situatën ekonomike të familjeve e njerëzve të thjeshtë.

Ajo çfarë po jetojmë sot si dhe ajo çfarë do të ndodhë nesër do të vërtetohet se demokracia liberale është parakushti kryesor i një sistemi që garanton mirëqënien, sigurinë dhe shëndetin e të gjithëve. Diktaturat mund t`i fshehin dobësitë e tyre, mund të heshtin njerëzit që denoncojnë por herët apo vonë kriza do t`i gërrejë përbrenda derisa e vërteta të dalë e plotë sy botës. Korona Virus është Cernobili Kinez.

Shoqëria civile, zhvillimi dhe inovacioni

| Apr 25, 2020 | [Blog-Debati](#) – [Nevila Xhindi](#)

Fjala e Prof. Asoc. Dr. Nevila Xhindi në Webinar “Vlera e inovacionit në kohë krize”

Ndërsa jemi futur në rrugën e pasigurive të Covid 19, edhe shoqëria civile dhe organizatat e saj po përballen me krizë dhe po kalojnë tranzicion. Kjo ngre shqetësime dhe pyetje kryesore për veprimtarinë e saj, mundësinë dhe aftësinë për të qëndruar në treg, për të kuptuar dhe për t’iu përgjigjur ndikimit të përdorimit të teknologjisë apo jo në komunitetet ku organizatat e shoqërisë civile punojnë dhe kanë shërbyer tradicionalisht. Disa nga këto transformime nënkuptojnë një rol të zgjeruar për shoqërinë civile, për të sfiduar sektorin duke përcaktuar përgjegjësitë dhe kontributet e tij në kontekstin e një bote të përballur me padijen e saj ndaj këtij transformimi të jetes dhe veprimtarisë normale.

Spektori ka ndërtuar të paktën një dekadë me njohuri dhe angazhim me teknologjinë e informacionit dhe komunikimit (TIK), por dixhitalizimi dhe përhapja në rritje e inteligjencës artificiale, bioteknologjive, shtypjes 3D, blockchain dhe teknologjive të tjera garantojnë një nivel të ri të gatishmërisë, investimeve dhe përshtatjes për shumicën e grupeve civile të sotme. Kjo nuk është thjesht çështje e integritit të inovacioneve dhe kapaciteteve në shërbime, produkte dhe programe. Inovacioni është bërë edhe më kritik në sektorin jofitimprurës vitet e fundit. Kjo vlen për të gjitha kontekstet, nëse është duke krijuar mënyra të reja për të ofruar shërbime, duke iu përshtatur legjislacionit të vështirë, duke krijuar modele të reja partneriteti me sektorin privat, duke vendosur standarde të reja për të drejtat e njeriut në këto periudhe të revolucionit dixhital ose duke rimenduar marrëdhëniet me teknologjitë dhe qeverisjen e tyre.

Përdorimi i gjerë i të dhënave të mëdha nëpër sektorë ka krijuar sfida të reja të lidhura me përgjegjshmërinë, ndershmërinë, besimin dhe transparencën që mund të ndikojnë negativisht në shoqëritë duke krijuar diskriminim, padrejtësi dhe përjashtim të popullatës së prekshme. Spektori duhet të zhvillohet në linjë me revolucionin e Katërt Industrial, implikimet e tij për shoqërinë dhe, rrjedhimisht, ndikimin e tij në atë se si shoqëria civile kampionon të drejtat e njeriut, jep shërbime për zhvillim të qëndrueshëm dhe nxit dialogun për vlerat e shoqërisë.

Përgjegjësitë e reja bien mbi supet e drejtuesve të shoqërisë civile, dhe sektori duhet të tregojë aftësinë e tij për të qëndruar i shkathët dhe adaptues, dhe të jete pionier i qasjeve dhe zgjidhjet e reja për zhvillimin shoqëror përmes inovacionit të përgjegjshëm dhe teknologjisë gjithëpërfshirëse dhe duhet ta bëjë këtë me shume se kurre sot.

Çfarë llojë inovacioni na duhet për t'ia dalë mbanë në post-krizën COVID19?

| Apr 25, 2020 | [Blog-Debati Erjon Curraj](#)

Përfundimet e Webinarit “Vlera e Inovacionit në kohë krize”

Inovacioni luan një rol themelor në një mjedis të ri të karakterizuar nga kriza të herë pas hershme. Mjafton të përmendim këtu dy krizat e mëdha të Shqipërisë: kriza social-ekonomike e shkaktuar nga tërmeti i 26 nëntorit 2019 dhe tanimë një krizë edhe më e thellë nga pandemia COVID19. Këtu nuk po ndalem fare tek krizat politike sepse ato duket sikur janë të përhershme në Shqipëri dhe jo të herë pas hershme. Në këto javë vetë-izolimi, duke diskutuar me kolëgë, miq e mikeshë për sfidat por edhe mundësitë që krijohen prej pandemisë COVID19, vendosëm të organizojmë një forum diskutimi online (webinar) për të bashkëbiseduar me ekspertët lidhur me rolin që inovacioni luan në kohë krizash. Si po përballen me këtë realitet dhe sesi po përgatiten për “normalitetin e ri” në post-krizë? Si bëhet vlerësimi i impaktit në kohë krize? Cili është roli i inovacionit? Cilat janë sfidat për sipërmarrjen? Për arsimin? për Shoqërinë civile? Po mundësitë? Si duhet të përgatitemi për ‘normalitetin e ri’ post-krizë? Cilat janë mësimet e nxjerra? Çfarë do të thotë përdorimi i qasjes “Mësim & Zhvillim”? Në këtë webinar pata kënaqësinë të moderoj diskutimin me pjesëmarrës nga Shqipëria dhe Kosova nga sektori i biznesit, arsimit dhe shoqërisë civile.

E nisëm diskutimin me fokus inovacionin dhe teknologjinë si thelbësor për transformimin dhe përshtatjen e biznesit, por edhe arsimit dhe shoqërisë civile në këtë realitet të ri. Më pas, gjatë diskutimit, folësit e vunë theksin tek: së pari, vlerësimi i situatës në mënyrë rigoroze. Pra matja e saktë dhe mbledhja e të dhënave rreth ndikimit të krizës në sektorë të ndryshëm psh në biznes apo arsim. Vetëm përmes vlerësimit të ndikimit dhe nxjerrës së të dhënave të sakta, mund të ndërtohen politika apo instrumenta lehtësues për të përmirësuar situatën. Eksperti i Zyrës Qendrore të OKB-së në New York për menaxhimin e krizave, Dr.Fabjan Lashi, ndau me pjesëmarrësit përvojën e UNDP në nivel botëror për vlerësimin e impaktit të krizave. Ai theksoi se tashmë për shumë sektorë dilemma është: të bësh inovacion ose të ‘vdesësh’. “Innovate or die” është një metaforë për të simbolizuar ndikimin e madh dhe të gjithëandshëm që inovacioni sidomos ai teknologjik e digjital ka në ekonominë dhe shoqërinë bashkëkohore.

Së dyti, roli i shoqërisë civile për zhvillim e transformim shoqëror është edhe më i rëndësishëm në kohë krize se në situata normale. Prof. Nevila Xhindi, pedagoge në Universitetin Mesdhetar të Shqipërisë, theksoi se “përdorimi i gjerë i të dhënave të mëdha (Big Data) ka krijuar sfida të reja të lidhura me përgjegjshmërinë, ndershmërinë, besimin dhe transparencën që mund të ndikojnë negativisht në shoqëritë duke krijuar diskriminim, padrejtësi dhe përjashtim të populates”. Prandaj, shoqëria civile mund të krijojë instrumente për të krijuar rezistencë ndaj impaktit negativ të inovacionit. Së treti, edukimi i brezave të ardhshëm në kohë krize është sfidues, aq më tepër që universitetet shqiptare nuk ishin të përgatitur për mësimdhënie e procese akademike 100% online. Diana Biba, Administratore e Kolegjit Profesional të Tiranës, nënvizoi se “sfida e mësimdhënies online falë inovacionit dhe teknologjisë duhet parë si një mundësi për t’u shqyrtuar dhe konsideruar për angazhime më efikase, më efektive, më gjithëpërfshirëse edhe në post-krizë”. Mësimet e nxjerra dhe praktikatat e krijuara nuk duhet të humbasin.

Pikërisht duke marrë shkas nga nevoja për të ndërtuar mbi mësimet e nxjerra nga sektorë të ndryshëm sidomos gjatë krizës dhe në përgatitje për post-krizën dhe normalitetin e ri, theksova në diskutim se ajo çka

na duhet në fakt është qendrueshmëria. Pra nuk bëhet më fjalë se a do të inovojnë apo jo bizneset apo sektori arsimit apo shoqëria civile. Çështja është çfarë lloj inovacioni na duhet në këto sektorë. Një inovacion i qendrueshëm ofron zgjidhje të integruara, afatgjata dhe gjithëpërfshirëse. Inovacioni i qendrueshëm është i mundur vetëm nëse mësojmë nga përvoja, shkëmbejmë praktika brenda sektorit apo midis sektorëve dhe fokusohemi në strategji dhe jo vetëm në reagime të shpejta ndaj situatave të krizës. Liderhipi largpamës e mendje hapur ndaj teknologjisë apo të resë në përgjithësi është factor kyç. Ashtu sikurse është edhe ekzistenca e një mjedisi mundësues në nivelin e qeverisë qendrore apo vendore. Organizatat duhet të mësojnë të jenë agile, pra të përshtaten shpejt me ndryshimin dhe të përqafojnë të renë.

A jemi gati për të gjitha këto? Kriza COVID19 tregoi se disa syresh në arsim, shoqëri civile dhe biznes ishim më gati se të tjerët. Disa u përshtatën më shpejt e disa ende jo. Natyrisht që ka këtu element të pabarazisë së mundësive, kompetencave, burimeve apo infrastrukturës. Pabarazitë nuk mund të zhduken me një të rënë të lapsit, ama mund të punojmë në drejtim të zbutjes së tyre edhe përmes ndërtimit të aleancave bashkëpunuese dhe gjetjes së zgjidhjeve të qendrueshme. Kë takim u realizua në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Krijimtarisë dhe Inovacionit. Ky nuk ishte i vetmi takim i joni, ne do të vazhdojmë të ndërjegjësojmë komunitetin, të japim alternativat tona bazuar në ekspertizë dhe pse jo të lobojmë për inovacionin e qendrueshëm.

Ky webinar u organizua nga Tech360 Smart Solutions, Kolegji Profesional i Tiranës, Qendra “Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim”, Qendra për Studime të Krahasuara dhe Ndërkombëtare si dhe Erasmus Student Network në Shqipëri – ESN Tirana.

Një “vaksinë” për infodeminë me tri pyetje bazike

| Apr 28, 2020 | [Blog-Debati Dren Gërguri](#)

Infodemia është ‘sëmundja’ e informacioneve të paverifikuara që plasohen te publiku dhe ky “virus” mund të bartet nga një person te tjetri. “Pastroni duart shpesh”, të kthjellohemi dhe të gjykojmë çdo informacion që marrim dhe para se ta shpërndajmë, t’ia bëjmë vetes së paku tri pyetje, si “vaksinë” kundër infodemisë.

Në këtë periudhë të krizës, është shumë e rëndësishme ta mbrojmë veten nga dezinformatat lidhur me koronavirusin, që në fakt po shpërndahen gjithandej dhe në numër të madh, sidomos në medie sociale. Për të mos u ballafaquar me probleme serioze në të ardhmen, të prodhuara nga ndonjë dezinformate, tani duhet t’i kushtojmë rëndësi të madhe saktësisë së informacioneve që i marrim.

Para disa ditësh, një mik i imi më dërgoi një mesazh në Viber ku thoshte: “Mbaje frymën për më shumë se 10 sekonda. Nëse arrin ta bësh këtë pa u kollitur ose pa shfaqur shenja ankthi apo shtrëngime në gjoks, atëherë nuk je i prekur.” Pyetja e parë që ia bëra mikut tim, ishte se ku e mori këtë informacion. Ai më tha se ishte një familjar i tij që ia kishte dërguar. Ndërkohë, shtoi se, gjithashtu kishte ndëgjuar se kjo është sugjeruar prej ekspertëve nga Japonia. Pasi e verifikova, e pashë se është thjesht një tjetër dezinformate që po shpërndahet këto ditë. Natyrisht, miku im, apo edhe familjari i tij, shpërndarjen e informacionit e bëjnë me qëllimin për të ndihmuar, pa e kuptuar se kanë rënë pre e një dezinformate.

Dezinformatat në media sociale mund të shpërndahen shumë shpejt. Paramendojeni kur dezinformatat po shpërndahen në grupe me dhjetëra e qindra persona, e pastaj, secili prej tyre mund ta shpërndajë te qindra e mijëra të tjerë. Një dezinformate si ajo për përdorimin e hudhrës për të parandaluar infeksionin u shpërnda në Facebook, ndërkohë që Organizata Botërore e Shëndetësisë kishte reaguar duke thënë se nuk ka asnjë provë që përdorimi i tepërt i hudhrës mund t’i mbrojë njerëzit nga koronavirusi. Të supozojmë se kjo dezinformate ishte shpërndarë në një grup me 200 anëtarë në Facebook, pastaj gjysma e tyre e kishte shpërndarë te 100 persona të tjerë. Pra, për pak minuta, dezinformata mbërrin te 10 mijë persona.

Një tjetër dezinformate që u shpërnda shumë ishte ajo për pirje të ujit të nxehtë me limon: “Profesoresha Chen Horin, Drejtoreshë e Përgjithshme e Spitalit Ushtarak të Pekinit, ka thënë: Fetat e limonit në një filxhan me ujë të nxehtë mund të shpëtojnë jetën tuaj. Limoni i nxehtë mund të vrasë përhapjen e këtij virusi në trupin tonë!” Kjo dezinformate u shpërnda shumë nga njerëz të ndryshëm në Facebook, Messenger, e medie të tjera sociale, derisa pas disa ditësh mediet serioze si Euronews, Associated Press, AFP, etj., raportuan se kjo ishte një tjetër dezinformate e shpërndarë në këtë periudhë. Ndërkohë, është e ditur se demanti i dezinformatës asnjëherë nuk mund të arrijë efektin e njëjtë, prandaj është e rëndësishme të ndalojmë infodeminë para se të shpërndahet.

Në raste të tilla është mirë që të jemi skeptik ndaj informacioneve të cilave u ekspozohemi për shkak të një morie dezinformatash që qarkullojnë në internet. Infodemia është ‘sëmundja’ e informacioneve të paverifikuara që plasohen te publiku dhe, ky virus mund të bartet nga një person te tjetri, sa hapë e mbyllë sytë. “Pastroni duart shpesh”, gjithsesi, por edhe të gjykojmë çdo informacion që marrim dhe para se ta shpërndajmë, t’ia bëjmë vetes së paku tri pyetje, që janë “vaksina” më e mirë kundër infodemisë: A është

burimi i besueshëm?, a është raportuar ky lajm edhe në një media tjetër?, dhe, a mbështetet në burime zyrtare?

Për këshilla mjekësore, Organizata Botërore e Shëndetësisë, UNICEF-i si dhe institucionet tona shtetërore, Ministria e Shëndetësisë dhe Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës kanë publikuar udhëzues të ndryshëm dhe shterues që shpjegojnë informacione të shumta për koronavirusin, prandaj duhet të drejtohem te institucionet shtetërore a globale shëndetësore dhe mos të lejojmë veten të mashtrohemi nga dezinformatat që qarkullojnë nëpër medie sociale, pavarësisht se kush i shpërndanë ato. Pra, për pandeminë e koronavirusit ende nuk është gjetur vaksina, mirëpo për infodeminë tashmë e kemi “vaksinën”, mjafton të jemi të kujdesshëm dhe të “vaksinohem” me pyetjet e lartpërmendura për t’u mbrojtur nga infodemia.

Botuar [këtu](#) dhe ribotuar me miratimin e autorit.

Post-Recesioni fitohet nga ato kompani që dinë ta lexojnë mirë Recesionin

| May 18, 2020 | [Blog-Debati Erida Curraj](#)

Markimi është art dhe shkencë. Një kombinim i kreativitetit dhe originalitetit të përfshirë në marketing. Sipas Joep Cornelissen, identiteti i një kompanie përkufizohet si “...ndërtimi i imazhit të kompanisë/koorporatës për të dalluar pozicionin e saj në sytë e grupeve të rëndësishme të interesit.”

Fjalori “i anglishtes aktuale” i Pocket Oxford (1934) shkruan: Markë. Pjesë druri e djegur ose e shkrirë, pishtar, (letrare); pullë hekuri e përdorur e nxehtë për të lënë një shenjë të pashlyeshme, shenjë/markë e lënë prej saj, markë tregtare, lloj malli i veçantë. Pullë (shenjë, objekt, lëkurë), ... Në mënyrë të ngjajshme e shpjegon edhe Fjalori Amerikan i Oksfordit (1980) përmban përkufizimin e mëposhtëm: Markë (emër): një markë tregtare, mallrat të një prodhimi të veçantë, një shenjë identifikimi e bërë me hekur të nxehtë; hekurin e përdorur për një pjesë të drurit të djegur, (folje): të shënuarit me një hekur të nxehtë, ose të etiketohet me një markë tregtare.

Këto dy shpjegime, ilustrojnë se si mbi 50 vjet, përdorimi parësor i fjalës “markë” tani ka një aplikim tregtar.

.....

Por në historinë e markave, sektori që ka patur më pak marka të trashëguara deri sot është industria e shitjes me pakicë. Psh dyqaniet e markës Bang & Olufson (1925) dikur konsideroheshin si një nga markat skandinave më të suksesshme, profesioniste dhe me eksperiencë të përparuar në dyqanet e shitjes me pakicë. Gjithashtu Sportiv Authority (1928), në kulmin e tij kishte mbi 460 dyqane, para se të falimentonte në vitin 2016. KB Toys (1922), dyqane e shitjes me pakicë për lodra femijësh, për pak festonte përvjetorin e tij kur iu desh të mbyllte dyqanet në vitin 2009, si një nga viktimat e recesionit të madh.

.... Një recesion ofron një mundësi për tregtarët që të shqyrtojnë nga afër sa shumë dhe në çfarë mënyre ata po i shpenzojnë paratë e tyre. Rialokimet e buxhetit mund t’i lejojnë tregtarët të provojnë mundësi të reja premtuese dhe të eliminojnë qasjet e dështuara apo me pak të dobishme, që nuk ofrojnë më mjaftueshëm përfitimet e të ardhurave. Tek kjo pikë do të sugjerim edhe kombinimin ndërmjet Biznesit, Akademisë, potencialin vëndas dhe mediave.

[Lexo artikullin e plotë!](#)

Shën Bartolemeu i Teatrit

| May 18, 2020 | [Blog-Debati Marlin Muça](#)

16 maji ishte një ditë si gjithë të tjerat në Sheshin e Teatrit Kombëtar. Qëndrestarët e këtij sheshi, ca më të vjetër dhe më rigorozë se unë e kishin pagëzuar këtë shesh si Sheshin e Lirisë. Vendosa të vija herët për të parë e për të kuptuar se çfarë do të ndodhte atë ditë të tensionuar prej informacioneve ku nenkuptohej se së shpejti do të ndërhyhej me forca të mëdha policie.

Pak orë më vonë skenari ogurzi i prishjes së Teatrit filloi të vihej në jetë me skuadra të vogla policie që bllokuan pikat kyce të komunikimit të Teatrit me Qendrën dhe hapësirat përreth. Njerëzit që donin të vijnin në Teatër bllokoheshin dhe gjobiteshin. Si askurrë më parë, shteti i largonte në mënyrë kaq të hapur qytetarët e tij nga arti dhe kultura. Rreth orës 10-11 u pa qartë se nata dhe mëngjesi i hershëm i ditës tjetër nuk do të ishte i zakonshëm. Nuk do të shoqërohej me atmosferën e zakonshme miqësore të Sheshit të Teatrit, as me monotoninë e këndshme të fund-ditës të Teatrit. Forcat e së keqes do të mblidheshin në skutat më të errëta të Kryeqytetit për të shuar përfundimisht oazin e fundit të lirise dhe demokracisë në vend.

Është ora 2 e 30 ose 3 e mëngjesit, pasi ndahem nga disa miq të mitë, shkoj në dhomën anësore në krahun e majtë të gjirit që kafshon dy godinat e Teatrit dhe marr një sy gjumë. Paralajmërimet për një ndërhyrje të Policisë shndërrohen dalëngadalë në vegulli, teksa gjumi thith avash avash cdo pjesë të vetëdijes tënde. Për dy orë nuk mbaj mend asgjë përveçse bisedat e gëzueshme të grave dhe burrave që kishin zgjedhur të bënin roje nate. E qeshura e tyre këndëlëse depërton perdet e trasha të gjumit, duke më bërë të kuptoj se ekziston një botë e zhurmshme jashtë masës viskoze e të errët me të cilën gjumi vesh krejt ekzistencën tonë. Në një nga këto momente jo fort të qarta, një zë i tmerruar femre gris dhunshëm cohën e perdes time për të rikthyer realitetin e një Teatri të cënuar. “Erdhën, Erdhën, Erdhën“ - përsëriste ai zë. Në atë moment nuk munda dot të lidhja klithmën e këtyre fjalëve me kuptimin e tyre. Gjithsesi kjo nuk më pengoi të brofja në këmbë dhe të shihja siluetat e disa njerëzve që kalonin nxitimthi pragun e portës anësore që të nxirrte në cepin e platesë së sallës. Pas këtyre siluetave, një arradhe e frikshme efektivësh të FNSH përplasat dhunshëm pas portës, me bucima të egera të cilat truri im përsëri nuk kishte vëmendjen e duhur për t’i dekriptuar.

Në këtë moment u kthellova dhe kuptova se përballja e shumëpritur, të cilën me aq ngulm ia kërkoja atë natë vetes por edhe të tjerëve, kishte ardhur më në fund. E keqja na kishtë zënë në gjumë, të pakët, të lodhur dhe të pamundur për të përballuar një makineri lufte të ndërtuar posacërisht për këto situata.

Një prej këtyre policëve që nuk mbanin mjet identifikimi dhe fare kollaj mund të mos e quaje polic më kap prej krahu dhe me shoqëron vrullshëm në furgonin përballë derës kryesore të Teatrit Kombëtar. Në këtë moment më zë syri një skenë që do ta mbaj mend gjithë jetën time. Një lukuni e egër qensh që mbanin uniforma të IKMT shqelmonin egërsisht dyert ballore të Teatrit. Dukej sikur ky operacion nuk drejtohej nga institucione shtetërore por nga kupolat mafioze me pak ose aspak mëshirë për objektivat e tyre të rradhës.

Majtas godinës një tjetër pamje e frikshme një matrapik a turjelë që cante bindshëm fasadën e atij kahu të godinës për c` kushedi arsye djallëzore. Truri im akoma nuk e kishte kuptuar se shumë njerëz kishin mbetur brenda dhe makineria drakoniane donte t` i nxirrte jashtë me kërcënimin se do t` i groposte brenda.

Kundrimit tim i erdhi fundi kur një tjetër efektiv, kësaj rradhe i repartit Shqiponja me vë fashetat dhe më con në një tjetër furgon që priste në cepin e Ministrisë së Brendshme. Përpara realizimit të kësaj zhvendosjeje pa kuptim, nuk më shpëtoi ardhja e përbindëshit prej hekuri të cilit të gjithë i frigohehim: Fadromës. Ajo erdhi rrëshqitazi, anash murit të Ministrisë. E parkuan rrëzë saj vetëm për ta lënë gati për prenë e rradhës. Fati nuk desh i që të dëshmoja këtë proces historik. Furgonit tim final iu bashkuan dhe disa udhëtarë të tjerë, mes tyre dhe regjisorin Robert Budina. Prej këtu u nisëm drejt Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë. Nga këtu drejt Komisaritit NR.5, në Kamëz, atje ku pushteti mendonte se ishte I sigurtë nga presioni i familjarëve dhe qytetarëve të thjeshtë.

Këtu fillon një shtatë orësh i stërgjatë që dukej se do të zgjaste përgjithmonë. Kjo greminë e përljes njerëzore t` i sjell trutë vërdallë kur disa xhaxha të kërkajnë të heqësh lidhëset. Ti nuk e kap menjëherë se pse duhet t` i heqësh lidhëset. Në atë moment mendon se sa i pavlerë je karshi policit, njeriut të lirë, botës...

16 dhe 17 maji ishte dynetëshi më i gjatë i jetës time. Një dukuri e rrallë të cilën vetëm një përzierje emocionesh të forta njerëzore mund ta shënjojë në kalendarin personal të gjithsecilit. Një miku im thotë se ajo ishte Nata e Thikave të Gjata. 16 maji duke u gdhirë 17ta ishte Shën Bartolemeu shqiptar. Dje u masakrua iluzioni i fundit ku Shqipëria renditej si vend demokratik. Një masakër kjo më e rëndë dhe e përgjaktë sa ajo ndaj hugenotëve francezë. Diku, në tryezat plot nur të pushtetit, dy njerëz ngrenë dollinë dhe thonë; Gëzuar 17 majin, Ditën e Shën Bartolemeut.

Që zhvillimi i qytetit të mos barazohet me arbitraritetin

| May 20, 2020 | [Blog-Debati Blerjana Bino](#)

Në ditën e shembjes së Teatrit Kombëtar, por sidomos në vijim në postimet në Twitter / Facebook, si edhe në deklarata publike të zyrtarëve të Qeverisë dhe Bashkisë dhe jo vetëm, kam vërejtur një përpjekje të qartë për ta thjeshtuar dhe minimizuar të gjithë këtë përpjekje (*struggle* në anglisht, por nuk e gjej dot fjalën në shqip që të përshkruaj një gjendje mes luftës dhe përpjekjes) në një narrativë dikotomike.

Nga njëra anë, kinse kemi ata që janë pro emancipimit dhe zhvillimit të qytetit. Kjo shprehet përmes ndërtimit të një teatri të ri, modern, sipas gjitha gjasave shumë të shtrenjtë. Për këtë vetë Kryeministri parashtrori një seri imazhesh krahasuese të disa projekteve të Tiranës me gjasë të kundërshtuara më kot sepse në fakt i shërbenin zhvillimit. Ndërkohë Kryetari i Bashkisë së Tiranës e krahasoi kundërshtimin për shembjen e teatrit, me kundërshtimin e ndërtimit të Kullës Eiffel në Paris në shekullin e XIX.

Sipas kësaj narrative, në anën tjetër gjenden ata që janë kundër emancipimit dhe zhvillimit të qytetit, pra të gjithë ata që kundërshtonin shembjen e teatrit dhe që vazhdojnë të protestojnë. Kjo shprehet përmes qëndrimeve të tilla si: ju po mbronin një godinë të amortizuar, të ndërtuar me materiale jo të mira, që mezi qendronte në këmbë; Pse nuk qenka demokratike prishja e një godine? etj.

Këto e relativizojnë vlerën e ngrehinës së Teatrit Kombëtar (apo tani duhet t'i referohemi si ish-Teatri Kombëtar?!) dhe simbolikën e qëndresës disa vjeçare për mbrojtjen e tij. Asnjëherë Teatri Kombëtar nuk ka qenë "thjesht një godinë". Tanimë, përpjekja nuk ka të bëjë më me ngrehinën, por me simbolin rreth saj: qëndresën për të luftuar abuzimin dhe arbitraritetin e pushtetit dhe për një qeverisje demokratike reale, jo fasadë.

Kjo narrativë pro dhe kundra zhvillimit të qytetit dhe relativizimi i qëndresës si çështje thjesht godine, janë problematike pasi është krijuar një narrativë artificiale që pengon debatin e mirëfilltë lidhur me të gjitha çështjet serioze dhe të rëndësishme rreth shembjes së teatrit. Të tjerë kanë shkruar me detaje dhe pa dashur të përsëris, por duke theksuar se disa nga këto çështje janë: arbitrariteti i pushtetit; mungesa e dialogut vendimarrës – shoqëri civile / artistë; mungesa e respektimit të shtetit ligjor dhe të së drejtës duke mos pritur të shprehen institucionet përkatëse; mungesë e demokracisë vendore përmes shpërfilljes totale të zërit qytetar; mungesa e transparencës, urgjenca e shembjes në kushte pandemia e gjendje të jashtëzakonshme e të tjera.

Natyrisht që diskutimi për teatrin si formë arti dhe për godinën si trashëgimi kulturore e historike ka shumë rëndësi ashtu sikurse ka edhe për ndërtimin e një apo më shumë teatrove të rinj për qytetin apo arenave sportive apo galerive kulturore apo qendrave rinore, apo të inovacionit etj. (ky qytet ka nevojë për shumë!). Krahas tyre personalisht më shqetëson pamasë për të ardhmen çështjet e sipër përmendura që çenojnë demokracinë në vend.

Duhet t'i kundërvihemi narrativës se ndarja lidhur me shembjen e teatrit qenka pro dhe kundra zhvillimit të qytetit, sepse është e stisur dhe nuk reflekton shqetësimin e vërtetë të qytetarëve sot. Guxoj e them me bindje se askush nuk është kundër zhvillimit të qytetit, por ama duhet të ketë dialog se çfarë kuptojmë me

zhvillim të qytetit. Ndaj, nuk mund të na imponohet ‘një drejtim i caktuar i zhvillimit të qytetit’ – Me aq sa shoh si qytetare e Tiranës, zhvillimi i qytetit mesa duket qenkërka ndërtim në çdo cep të mundshëm, çdo hapësirë sado pak e gjelbër rreth e rrotull, sot e shoh në betonizim e sipër. Si duhet të zhvillohet qyteti nuk mund të imponohet sidomos në kushtet e një qeverisje vendore të dalë nga zgjedhje monopartiake apo të një krize të thellë politike ku mekanizmat demokratikë të kontrollit dhe balances nuk funksionojnë. Nëse vazhdojmë kështu rrezikojmë të ndërtojmë një koncept të ‘zhvillimit të qytetit’ sot që nesër do të barazohet me abuzimin dhe arbitraritetin.

Publikuar nga Exit.al

Fadromisti nga Astiri!

| May 20, 2020 | [Blog-Debati Nevila Xhindi](#)

Prolog...

Mëngjes herët, dhe një zile telefoni tringëllon.

Alo? -Fadromën duhet ta bësh gati tani se kemi punë!- u dëgjua zëri gati I mbytur e në ankth nga ana tjetër e receptorit.

Ish mëngjes herët, në të gdhirë të 17 Majit!

Fadroma u drejtua drejt Teatrit Kombëtar, me aq shpejtësi sa mund të marrë një fadromë e rënduar mekanikisht e shpirtërisht. Po gdhinte një ditë e re, një histori e re po lindte!

Vazhdimi....

Teatri u shkatërrua! Është një gjë e vështirë për tu përshkruar, ndjenjë që çuditshëm të lodh, nuk të lë të mendosh, të paralizon pa siguruar një përgjigje të shkurtër nga mendja.

Ndërmend më shfaqen filma të Hollivudit që të tmerrojnë me skenarë apokaliptikë, ku priren të përdorin shkatërrimin e ndërtesave dhe strukturave ikonike si imazhin e tyre. Pamjet në këto filma të krijojnë ndjesinë që Nju Jorku është shndërruar në një djerrinë, jo sepse realisht shohim një djerrinë, por sepse kamera ka fiksuar vetëm pishtarin e mbajtur lart me Statujën e Lirisë që shikon dukshëm nëpër rërërat që tani kanë përmytur qytetin. Efekte të paimagjinueshme, ndjesi frike dhe terrori! Kam pyetur shpesh artiste, kineastë e regjizorë se përse këto imazhe të japin kaq fuqishëm ndjenjën e shkatërrimit, dhe janë shumë më efektive dhe tmerruese sesa imazhet e qenieve njerëzore që vdesin? Përgjigjet që kam marrë kanë qenë që nga ato mbi efektet artistike që luan Hollivudi, deri tek parashikimet shkatërrimtare të njërezimit.

Pamjet e fadromave goditëse të Teatrit Kombëtar, marrë qartazi nga lartësia e tarracës së Ministrisë së Brendëshme flisnin atë mëngjes Maji për shkatërrim, përcillnin efekte apokaliptike: tymnajë pluhuri dhe rëre, njerws qw vraponin mes klithmave. Dikush jo mw kot ish kujdesur për këtë imazh, sepse ato pamje, ashtu si në filmat Hollivudian flasin për shkatërrimin e një qyteti të tërë, një shoqërie, një kombi, një civilizimi dhe një mënyrë jetese. Shkatërrimi nuk I përkiste vec Teatrit, por brezave të tërë që e ndërjuan dhe e ruajtën.

Teatrin e shkatërruan, nuk e shëmbën! Dukej që e kishin me ngut, jo për kullat që do ndërtojnë, por për tu dhënë një mësim “të pabindurve”, që prej muajsh u kthyen në symbol të qendresës, shpërsës e civilizimit të këtij qyteti. Teatri- jo godina, krijoi një kazu politik, shkatërrimi I tij vjedhurazi është symbol I grabitjes tinzare dhe shkatërrimit të cdo vlere lirie e demokracia në këtë vend, tashmë të marrë peng nga timonierët e pushtetit. Por këto të fundit nuk “kanë parë gjë akoma”, sepse teatrin perspektiv atë të së ardhmes, e luajnë bukur një trupë aktorësh të rinj..është rradha e tyre!



Epilog...I dërrmuar nga dhimbja, nga lodhja, nga zgjimi hajdutce ne mes të natës, por edhe nga levizjet e pabindura të fadromës së tij mbi Teatrin që heshtazi rënkonte, fadronisti I kthyer në shtëpi I hodhi një sy asaj dhome të vogël ku kish filluar të jetonte pasi I shkatërruan shtëpinë tek Astiri.

Familja e tij ende flinte gjumë!

Publikuar nga Exit.al

“NE dhe SHQIPja”

| Jun 3, 2020 | [Blog-Debati Erida Curraj](#)

Qendra “Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim” (SCiDEV) organizoi sëbashku me Shoqatën e Gjuhësisë Shqiptare dhe KS Faktor në datën 16 Maj, Webinarin nr 4 “Ne dhe Shqipja”. Në këtë takim virtual u mbledhën kërkues, studiues dhe profesorë të gjuhës shqipe, studentë dhe të tjerë të interesuar, për të diskutuar për gjuhën shqipe, për përdorimin e saj në ligjërimin e shkruar dhe në ligjërimin e folur publik, për evoluimin e saj, si edhe për ruajtjen, lëvrimin dhe pasurimin e gjuhës sonë.

Gjuha në vetvete është një organizëm i gjallë që evoluon në kohë dhe si e tillë i përgjigjet emancipimit të shoqërisë, kulturës e teknologjisë. Platformat digjitale të komunikimit dhe rrjetet sociale kanë sjell një shpërfillje të thellë në përdorimin publik të gjuhës shqipe. Ligjërimi i shkruar nuk kalon në filtrin e redaktimit dhe ligjërimi i folur nuk kalon në filtrin e monitorimit, për pasojë vërehen shmangie nga normat e gjuhës dhe natyrshëm lind shqetësimi – A po tjetëron gjuhën shqipe përdorimi i rrjeteve sociale? A mund të quhen fajtorë vetëm rrjetet sociale për tjetërsimin e gjuhës shqipe? Çfarë ndikon në deformimin e gjuhës shqipe në titrat e lajmeve e filmave, në tekstet e reklamave promovuese, apo edhe në shtypin e përditshëm, në revista e deri në botime shkencore?

Shqetësimet që zgjon, sidomos dy dekadat e fundit, përdorimi publik i gjuhës shqipe nuk mund të kufizohet vetëm me problematikat aq të qenësishme të sistemit arsimor. Një vëmendje e veçantë dhe e merituar i kushtohet zgjerimit të komunikimit me shkrim përmes rrjetit duke mos respektuar rregullat e gramatikës dhe sintaksës. Nisur nga një aktualitet i tillë, gjatë takimit u parashtruan se si, në thelb, gjuha e shkruar gjymtohet pasi, ajo pëson të meta që në zanafillë, që në procesin e leximit. Ky i fundit është shumë i rëndësishëm pasi, në një masë të madhe, prirja e përgjithshme është ajo e përcjelljes së të njëjtave boshllëqe gramatikore, drejtshkrimore e deri semantike nga leximi në shkrim. Shkruhet keq pasi lexohet pak e këtu, debati zgjerohet dhe përfshin industrinë e leximit të librit, shtypin (e shkruar ose virtual), mediat audio-vizuale etj.

Takimi ishte shumë i sukseshëm se jo vetëm nxorri në pah disa nga problemet më emergjente dhe më të rëndësishme që çenojnë cilësinë e gjuhës shqipe por edhe u adresuan disa zgjidhje të tyre, ato janë të disa niveleve, nivel strategji kombëtare, institucional dhe individual.

[Lexoni artikullin e plotë](#)

“Të festojmë për sukseset dhe arritjet, të bashkohemi për kapërcimin e sfidave të vajzave dhe grave në Shqipëri”

| Jun 8, 2020 | [Blog-Debati Erida Curraj](#)

Iniciativa e re “Ne Gratë” —

- **Çfarë është “WE Women” (Ne Gratë)?**

Një iniciativë për krijimin e një platforme për frymëzim, mbështetje, rrjetëzim dhe fuqizim të vajzave dhe grave. Është një rrjet që bashkon vajza dhe gra të suksesshme në akademi, biznes, sektor publik dhe privat për të shkëmbyer përvojat e tyre, për të diskutuar se si të kapërcehen pengesat që ekzistojnë në rrugën e suksesit, që japin këshilla dhe frymëzojnë vajza dhe gra të reja për të ndjekur ëndrrat e tyre. Aktiviteti i parë i këtij rrjeti u lehtësua nga dy organizata jo fitim prurëse (Qendra Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim dhe KS Faktor), por rrjeti është i hapur për organizata, grupime dhe këdo tjetër i interesuar për të fuqizuar vajzat dhe gratë.

- **Si lindi ideja e “WE Women” (Ne Gratë)?**

Iniciativa për këtë platformë buron nga pasioni dhe idealizmi, nuk mbështet aktualisht nga donatorë apo projekte, por vjen si një sipërmarrje e një grupi vajzash të reja, gra në profesion që synojnë të krijojnë hapësira dhe mundësi për vajza dhe gra të tjera.

Filloi nga një bisedim spontan mes mikeshave të mia. Ne shpesh ngremë pyetjet pse gratë paguhen më pak se burrat për të njejtin pozicion pune? Barazia e mundësive a është utopi? Pse ne kemi kaq shumë veprim dhe kaq pak zë? Si të promovojmë modele të suksesit? Si të forcojmë vlera të shëndeshme? E të tjera si këto dhe kështu menduam pse mos ta fillojmë nga vetja për të bërë një ndryshim sado të vogël.

Në eksperiencën time 12 vjeçare në fushën e biznesit midis Azisë dhe Europës dhe 4 vitet e fundit me projektet europiane kam takuar vajza dhe gra me integritet, vendimmarrëse, drejtuese, menaxhuese por zëri i tyre degjohet më pak, ndërkohë që veprat e tyre në shoqëri janë për tu admiruar. Në kuadrin e Ditës Ndërkombëtare të Grave, 8 Mars vendosëm të fillojmë të hedhim hapin tonë, duhet të festonim arritjet dhe aspiratat e grave, pasionin e tyre, udhëheqjen, veprimet dhe integritetin, por edhe të bashkonim forcat për të mbështetur njëra tjetrën për më tej. Si fillim u mbështetëm nga dy organizatat: SCiDEV dhe KS Factor dhe nga Europe House që na mundësoi mjedisin.

- **Cila ishte e veçanta e organizimit?**

Aktiviteti solli sëbashku rreth 60 vajza, gra dhe burra që i përkasin fushave të ndryshme akademike, politike, sociale, bizneset e të tjerë. Vajzat edhe gratë pjesëmarrëse vinin nga qytete të ndryshme të Shqipërisë, me status të ndryshëm social-ekonomik dhe profile e përvoja të larmmishme. Takimi u zhvillua në formën e bashkëbisedimit, ku 8 folëset ndanë përvojën, idetë dhe mesazhet e tyre me tema shumë ngjyrëshe nga: 1)

akademia, 2)të rinjte 3)sociale 4)kulturore 5)biznesi 6) dizajni 7)mbrojtja e kafshëve 8) start up. Prezantimet e tyre shumë të ndjera, të pasura me eksperiencë e mundime, na dergonin mesazhe motivuese dhe frymëzuese dhe u pasuan nga bashkëbisedemi me pjesëmarrësit dhe mesazhe nga të pranishmit. Pjesa e dytë e aktivitetit u zhvillua me takime bilaterale apo në grup për të mundësuar rrjetëzimin dhe u diskutuan ide për aktivitetet e ardhshme.

- **Planet për të ardhmen? Cila është e ardhmja e tij e rrjetëzimit?**

Ky është aktiviteti i parë dhe që synon të bëhet periodik. Ky aktivitet bazohet edhe në përvojat e mëparshme që organizatorët kanë pasur: Psh KS Faktor i përkushtohet mbrotjes së gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare. Ndërsa Qendra Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim ka punuar më shumë me sektorin e arsimit të lartë, kërkimit dhe shoqërisë civile për të fuqizuar dhe zhvilluar kapacitetet e kërkuesve dhe studentëve. Kështu që ne do të vazhdojmë të punojmë në këtë drejtim. Krahas krijimit të rrjetit, shumë shpejt do të dalim edhe me një publikim për promovimin e rasteve të suksesit si frymëzim për vajzat dhe gratë e tjera. Rrjeti do të zgjerohet më tej dhe do të vazhdoj të këshilloj dhe frymëzoj vajza dhe gra të reja për të ndjekur ëndrrat e tyre.

- **Si mendoni se kjo do të ndihmoj në kauzën e të drejtave të grave në Shqipëri?**

Sfidat e vajzave dhe grave janë të shumta dhe jo vetëm në Shqipëri. Natyrisht që ka iniciativa të tjera dhe për tu vlerësuar në këtë drejtim. Në mbështetimi tek arritjet e deri tanishme, tek përvoja e organizatave të tjera dhe synojmë të japim kontributin tonë përmes pozitivitetit, përmes promovimit të modeleve dhe përmes frymëzimit. Kjo është si të thuash pjesa 'soft' e fuqizimit të vajzave dhe grave, por ne besojmë se përmes promovimit të modeleve, përmes bashkëpunimit, mbështetjes së njëra tjetrës, inkurajimit dhe frymëzimit, mund të bëjmë ndryshimin. Nuk jemi vetëm vajza dhe gra, jemi njerëz, pavarësisht gjinisë, që jemi bërë bashkë për këtë kauzë. Mesazhi im është që secili është unik, secila grua është unike, dhe mund t'ia ndali mbanë sa kohë beson tek vetja, punon fort dhe ka rrjet që e mbështet. Mesazhet e pjesëmarrësve ishin të shumta. Psh, Blerjana Bino theksoi rolin e fuqizimit të vajzave dhe grave si pavarësi, emancipim, pjesëmarrje dhe edukim. Ajo theksoi se: "edhe nëse nuk e gjeni rrugën tuaj, bëjeni vetë atë, do të ketë ulje dhe ngritje, por është udhëtimi juaj, me integritet, profesionalizëm dhe duke mbështetur njëra tjetrën mund t'ia dalim. Fuqizimi ka impakt vetëm kur është mundësues edhe për të tjerët, pra ne që jemi më mirë të pozicionuar kemi përgjegjësinë për të ndihmuar dhe krijuar hapësira për të tjerët." Lutjona Lula: "Nisur nga rrugetimi im dhe historia personale e themelimit të ESN Tirana, këshilla që kam për vajzat e reja të cilat ndeshen me vështirësi gjatë rrugës së tyre është të jenë resiliente ndaj këtyre vështirësive. Resilienca është fuqizim jo vetëm për individin, por edhe shoqërinë. Në këtë panel ndihem e nderuar dhe përulem para historive të tilla." Greta Xheka, një vazjë e re në sipërmarrje, e vuri theksin tek puna dhe vullneti për të realizuar qëllimet në jetë. Znj. Breshani theksoi pasionin për të arritur suksesin, ndërsa Dr. Joana Dhiamandi foli për rolin e krijimtarisë në jetën e gruas. Prof. Vera Bushati dha një mesazh të fortë që gratë duhet të vlerësohen për arritjet e tyre dhe jo vetëm për gjininë. Znj. Keti Sula foli gjithashtu për rolin që ka mbështetja reciproke dhe krijimi i marrëdhënieve të shëndosha.



Projekti “Laboratori i debatit mbi integrimin europian në auditorët universitare – Roli i të rinjve”

| Jun 13, 2020 | [Blog-Debati Dorina Gjipali](#)

Pedagoge Mentore e Projektit

Për rolin e rinisë në Shqipëri është shkruar dhe është diskutuar shumë. Janë bërë studime, strategji, plane veprimi por sërisht ndikimi dhe roli që rinia ka në proceset më të rëndësishme që po kalon vendi ynë mbetet i ulët. Të rinjtë në Shqipëri kanë pak ose aspak hapësira ku të shprehin opinionet dhe idetë e tyre mbi tema me interes publik. Sondazhe e studime të ndryshme, tregojnë se të rinjtë shqiptar kanë humbur besimin në institucionet e vendit, ndihen të përdorur vetëm për qëllime politike pa patur mundësi të marrin pjesë në proceset vendimmarrëse e të jenë fokusi i këtyre proceseve.

Sipas studimit të bërë nga Partners Albania: “Kuari institucional dhe ligjor nuk fuqizon pjesëmarrjen e të rinjve në sferën sociale në Shqipëri. Ekziston një kulturë dominuese midis institucioneve publike që të rinjtë nuk do të jenë aktorët kryesorë në krijimin e të ardhmes së këtij vendi, çka është në kontrast me shpërndarjen demografike të popullsisë në Shqipëri – një nga më të rejtat në Europë.”^[2] Por që fatkeqësisht mban dhe një nga vendet e para përsa i përket papunësisë së të rinjve. Janë këta faktorë e shumë të tjerë që kanë shkaktuar një gjendje apatie tek të rinjtë shqiptar deri në pikën që 4 në 5 prej tyre duan të largohen nga Shqipëria.^[3]

Po si ti kthejmë besimin rinisë?

Si ti vendosim ata në kushtet që meritojnë të jenë?

Rinia është forca e ndryshimit. Ajo ka fuqinë të ndryshojë të ardhmen e një vendi, të bëjë bashkë të gjithë, pavarësisht ndasive. Të rinjtë janë liderat e të nesërmes dhe duhet të kenë një rol thelbësor në proceset integruese të vendit.

Por, që ta bëjnë këtë, duhet që ti japim mundësinë që të shprehin e të mbrojnë opinionet e tyre, të jenë aktivë në sferën publike. Pikërisht këtë bëri Qendra “Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim” mbështetur nga Fondacioni për Shoqëri të Hapur në Shqipëri, me projektin “Debati për Integrimin Europian në Auditorët Universitar”.

Sot, të rinjtë dhe studentët janë të ekspozuar ndaj lajmeve dhe opinioneve të shumta në kohë reale rreth procesit të integritimit. Këto lajme shpesh herë përcillen me opinione jo pozitive, prandaj debati u dha studentëve mundësinë të ngrenë pyetje, të thellohen në njohuritë e tyre dhe të sfidojnë opinionet e njerëzve që i rrethojnë për tema të rëndësishme që lidhen me procesin e integritimit.

Më shumë se 100 studentë, nën mentorimin e pedagogëve të tyre, debatuan me entuziazmin dhe idealizmin që vetëm të rinjtë kanë. Ata argumentuan me fakte dhe evidenca, në një debat të strukturuar e me rregulla,

për lëvizjen e lirë në Bashkimin Europian, për ndikimin që integrimi europian do të ketë në demokracinë dhe zhvillimin ekonomik të Shqipërisë por diskutuan edhe mbi të ardhmen e Bashkimit Europian.

Ata, nëpërmjet argumentave të tyre promovuan vlerat europiane: si dinjiteti njerëzor, liria, demokracia, barazia, sundimi i ligjit, respektimi i të drejtave të njeriut, që duhet të respektojë cdo shoqëri që aspiron të jetë pjesë e familjes europiane.

Duke parë këta studentë, sesi u përkushtuan ndaj debatit dhe duke dëgjuar idetë e tyre, ne pedagogët por besoj edhe ideatorët e projektit mendoj se ndihemi optimistë për të ardhmen.

Ky projekt duhet të jetë një fillim i mbarë dhe jo fundi i një procesi. Të rinjtë shqiptar duhet të jenë në qendër të debatit për integrimin e Shqipërisë në BE. Prandaj shpresoj që puna të vazhdojë.

Edhe pse debatet, për shkak të situatës së krijuar nga Pandemia Covid 19, u zhvilluan online në formën e webinareve, studentët debatues dhanë një kontribut të rëndësishëm në rritjen e ndërgjegjësimit të kolegëve të tyre dhe të opinionit publik për ndikimin dhe përfitimet që sjell anëtarësimi i Shqipërisë në BE.

Integrimi i Shqipërisë në Familjen Europiane është një nga qëllimet më të rëndësishme për vendin tonë dhe roli i të rinjve e organizatave rinore në këtë process, duhet të jetë më i fortë, Projektet e ndryshme që synojnë përmirësimin e rolit të të rinjve në procesin e anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Europian janë gjithmonë inkurajuese, shpresëdhënëse dhe për tu përgëzuar, sidomos kur rezultatet janë të dukshme.

Ne si shoqëri, kemi detyrimin të investojmë tek rinia. Të investojmë në dije, të rrisim njohuritë dhe aftësitë e të rinjve tanë ndaj fenomeneve shoqërore dhe rreth Bashkimit Evropian që tu mundësojmë atyre të jenë konkurrues dhe të përfitojnë sa më shumë nga financimet që BE vendos në dispozicion të të rinjve.

Integrimi i vendit tonë në Bashkimin Europian nuk mund të jetë thjesht një program institucional dhe politik, por si një program ambicioz i shoqërisë e ku promotorët kryesor të jenë pikërisht të rinjtë.

Të rinjtë, nga ana e tyre, duhet të përkushtohen intensivisht në edukim, informim, aktivizim publik, për rigjenerimin socio-ekonomik të shoqërisë shqiptare. Janë ata, që duhet ta cojnë Shqipërinë në rrugën e progresit dhe prosperitetit, ta clirojnë vendin nga paragjykimet.

Le të jetë ky projekt i Qendrës “Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim” një iniciativë që do të ndiqet nga projekte të tjerë me në fokus informimin dhe trajnimin e të rinjve, që nga studimet, shihet si një nga problematikat më të rëndësishme për mospërfshirjen e të rinjve në sferën publike.^[4]

Rëndësi të veçantë ka rrejtëzimi i projekteve me fokus angazhimit dhe përfshirjen publike si dhe në proceset vendimmarrëse dhe politikbërëse të të rinjve.

Është momenti që institucionet shtetërore të shikojnë me prioritet hartimin e një strategjie, plani veprimi a politikë të re, (pak rëndësi ka emri) për mbështetjen dhe fuqizimin e të rinjve në Shqipëri duke vendosur në dispozicion fondet e duhura. Kjo edhe në kuadër të përfundimit të afatit kohor të Planit Kombëtar të

Veprimet për Rininë 2015-2020. Parlamenti, në përmbushje të funksionit të tij, duhet të shikoj me prioritet edukimin, punësimin dhe problematikat rinore.

Roli dhe pjesëmarrja e të rinjve është i një rëndësie thelbësore për demokracinë e Shqipërisë dhe anëtarësimin e saj në Bashkimin Europian.

Në përfundim, dëshiroj të citoj Presidentin Ruzvelt, i cili pohonte se: “Ne nuk mund të ndërtojmë të ardhmen për të rinjtë tanë, por mund të ndërtojmë të rinjtë tanë, për të ardhmen.”

[1] Dr. Dorina GJIPALI është Përgjegjëse e Departamentit Publik në Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin “Luarasi”

[2] “Pjesëmarrja Politike, Sociale dhe Ekonomike e të Rinjve në Shqipëri” Raport Vjetor 2017, Partners Albania for change and development https://partnersalbania.org/wp-content/uploads/2017/06/raporti_vjetor_YBH-shqip.pdf

[3] Shoqëria Amerikane ‘Gallup’, në sondazhin e saj mbi migrimin në Botë pohon se 79% e Shiptarëve nga 15 dhe 29 vjec duan të emigrojnë në vende të tjera. <https://news.gallup.com/poll/245255/750-million-worldwide-migrate.aspx>

[4] “Pjesëmarrja Politike, Sociale dhe Ekonomike e të Rinjve në Shqipëri” Raport Vjetor 2017, Partners Albania for change and development https://partnersalbania.org/wp-content/uploads/2017/06/raporti_vjetor_YBH-shqip.pdf

Disinformimi: Një virus pa kurë në epokën e post-së vërtetës?

| Jul 1, 2020 | [Blog-Debati Blerjana Bino](#)

Përfundimet e Webinar #3 nga SCiDEV

Pandemia COVID19 ka shkaktuar ndryshime rrënjësore të ‘normalitet’ që njihnim dhe sipas të gjitha gjasave kjo përbën një nga krizat më të mëdha të shoqërisë bashkëkohore. Një ndër dimensionet e krizës është edhe disinformimi dhe përhapja e lajmeve të rreme. Qendra “Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim” (SCiDEV) organizoi një takim virtual me ekspertë të fushës, studentë, akademikë, përfaqësues të shoqërisë civile dhe të tjerë të interesuar për të diskutuar rreth fenomenit dhe masave kundër tij.

Teknikat e disinformimit: beteja mes gazetarit qytetar dhe atij profesionist

1. **Aleksandër Çipa**, Kryetar i Unionit të Gazetarëve Shqiptarë u fokusua në mënyrat se si krijohet dhe shpërndahet lajmi i rremë dhe nevojën për edukim qytetar. Realiteti mediatik në Shqipëri karakterizohet nga inflacionizmi i numrit të mediave tradicionale dhe mediave online, dhe numëron rreth 800 platforma online të lajmeve dhe zhanreve të tjera si blogje. Sipas tij, në mjedisin mediatik shqiptar ka një beteje mes qytetarit gazetar dhe komunitetit të gazetarëve profesionist, një përballje kjo e lidhur ngushtë me besimin publik ndaj medias. Gazetari qytetar ka një akses thuajse të barabartë me gazetarin profesionist në sajë të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit dhe gjithashtu përfshihet në proces raportimi. Shpesh aktorë politikë apo të tjerë investohen për t’i përdorur gazetaret qytetar për arsye propagande, sidomos në mjedisin mediatik online në mënyrë që të krijohen narrative të caktuara në hapësirën opinion-bërëse online.

Disa nga teknikat e disinformimit dhe lajmit të rremë

Teknika e ‘Ping Pong-ut’: Koordinimi i disa platformave njëkohësisht për të publikuar një lajm të caktuar duke krijuar një narrativë specifike me qëllim ushtrim ndikimi.

Teknik ‘ujku thërret ujkun’ – Një administrator i një portali krijon një lajm për një qëndrim politik apo interes të caktuar dhe përcjell në platforma të ndryshme online dhe krijon perceptimin publik sikur akuza e një individi ose një institucioni është i një interesi të madh publik.

Teknika e përdorimit të titujve bombastikë dhe jo në përputhje më përmbajtjen e lajmit duke sjellë kaos disinformues.

Teknika e përzgjedhjes selektive e fakteve ose qëndrimeve si p.sh. mënyra si paraqiten statistikat për fondet publike, investimet etj.

Teknika e servirjes se fakteve false (binjakërim me lajmet e rreme) – marrja e lajmit të vërtetë dhe shndërrimi në lajm të rremë.

Teknika “e gjitha për një pjesë” – portretizohet një gazetar apo një analist si qëndrim i të gjithë medias dhe merret si referencë për të përforcuar një narrativë të caktuar.

Censura më e rrezikshme se disinformimi

1. **Gjergj Erebara**, gazetar Reporter.al dhe BIRN Albania theksoi problematikën e censurës. Pandemia ka shkaktuar një moment reflektimi si për informimin edhe për disinformimin. Sot ne kemi më shumë mjete informimi se sa më përpara, por gjithashtu, edhe mjetet për disinformim janë përshkallëzuar. Nëse do t’i vendosim në balancë të dyja, duket sikur aftësia jonë për t’u informuar në kohë reale dhe komunikimi i shpeshtuar gjatë shekullit të XX dhe XXI, fal teknologjisë të informacionit, ka bërë që informacioni të jetë një alet i madh në betejën kundër COVID-it në vend të jetë një pengesë e madhe. Sipas Erebarës, problemi i disinformimit apo i lajmeve të rreme duket sikur është i fryrë jashtë proporcionit.

Ai u ndal në rastin e pandemisë në Shqipëri dhe situatën e krijuar mes Kryeministrit dhe medias. Kryeministri Rama i dërgoi një mesazh qytetarëve të vendit ku në vend t’u thoshte ruhuni nga disinformimi, u tha ruhuni nga mediat. Qeveria po përpiqet të përdori pandeminë për të forcuar më tej thuajse monopolin që ka mbi të vërtetën dhe mbi mediat konvencionale dhe dominimi që i bën mediave sociale. Erebara e vuri theksin tek mbizotërimi i informacionit zyrtar dhe pengesat për ta vënë në pikëpyetje atë apo për ta verifikuar për shkak të situatës së gjendjes së jashtëzakonshme nga pandemia. Ai nënvizoi se edhe në kushtet e pandemisë është detyra jonë të kujdesemi dhe të shikojmë se *pandemia është një gjë që luftohet me qytetari dhe jo me dhunë dhe dhuna nuk parandalon virusin*. Rreziku me i madh është censurimi që ka bërë qeveria mbi mjetet e komunikimit dhe pamundësia që kanë gazetarët për të bërë pyetje. Sa është kapaciteti testues i institucioneve të shëndetit publik sot?

A mundet Shqipëria sot të bëj 1000 teste në ditë apo vetëm 300 në ditë? Nqse rast se ka nevojë të rritet ky kapacitet testimi a është e mundur? Të gjitha këto pyetje mbeten pa përgjigje nga dominimi i diskursit që jemi në situatë pandemie dhe çdo pyetje është e padëshirueshme. Ai përfundon duke theksuar: “*Në kuadër të pandemisë neve përveçse faktit që duhet të ruhem nga virusi duhet të ruhem edhe nga censura, keqinformimin apo disinformimin që prodhon drejtpërdrejt i ashtuquajturit kanali zyrtar i informimit*”.

Përhap fjalën, jo virusin

Znj. Nora Kushti, Menaxhere Komunikimi në UNDP Albania prezantoi fushatën [#PërhapFjalënJoVirusin](#), një bashkëpunim i UNDP Shqipëri dhe Telekom Albania. Programi i Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara në Shqipëri dhe Telekom Albania kanë nisur një partneritet për të mbështetur luftën kundër pandemisë së koronavirusit, fushatën e përbashkët “Përhap Fjalën, Jo Virusin.” Në qendër të fushatës është një portal interneti ku secili qytetar gjen informacion të saktë për këtë sëmundje, për mënyrat e parandalimit të saj, si

edhe këshillat për të zbatuar distancimin social. Njëkohësisht kjo [faqe](#) lidhet me burime të besueshme shëndetësore, në mënyrë që publiku të mbrohet nga informacionet e pasakta. Një mjek i disponueshëm 4 herë në javë për tju përgjigjur pyetjeve të qytetarëve. Janë arritur rreth 600,000 njerëz dhe 480 pyetje për mjekun. Znj. Kushti theksoi nevojën për të luftuar lajmin e rremë përmes informacioneve të sakta dhe të bazuara në evidenca dhe kërkim shkencor. Ajo këshilloi përdorimin e mendimit praktik: verifikimi i lajmit në disa burime, identifikimi i autorit, datës së lajmit dhe njohuritë për burimet e besueshme. Gjithashtu ajo theksoi rëndësinë e gazetarisë së bazuar tek të dhënat për të rritur besueshmërinë publike.

Media dhe interesi publik përkundër fabrikimit të lajmit

1. **Zef Preçi**, nga Albanian Center for Economic Research, theksoi edhe pse jetojmë në një kohë kur informacioni ka më shumë rëndësi së kurrë, ai është në fakt më i papërpunuar se kurrë. Media duhet të qëndroj tek interesi publik, jo të fabrikojë çështje që nuk kanë interes për publikun, thjesht për të larguar vëmendjen. Ai parashtroi disa këshilla konkrete:
 - Shkoni në burim të lajmit dhe verifikoni.
 - Shihni disa media për të verifikuar lajmin.
 - Përfshihuni në debat.
 - Rritja e kapaciteteve tek gazetarët e mediave online
 - Një numër çështjesh që kanë interes publik duhet të mbulohe nga analiza të bashkërenduara dhe të mbështeten nga donatorët që të kenë influencë e presion mbi politikën
 - BIRN / Open data të mbështeten më shumë për të qenë më fleksibël me situatat. Ofrimi i informacionit të dobishëm dhe të përshtatshëm për audiencën.

Preçi përfundoi duke theksuar lirinë e medias: “*Më mirë shtypin sikurse është, sesa një shtyp i kontrolluar nga qeveria*”.

Besueshmëria në media dhe edukimi

Dr. Blerjana Bino, bashkëthemeluese e SCiDEV, u ndal tek disa hapa të mundshëm për të luftuar disinformimin dhe censurën dhe rritur besimin në media përmes edukimit. Jo të gjithë qytetarët kanë të njëjtën aftësi për të verifikuar lajmin, ka nevojë për edukim për mënyrën si duhet lexuar, kuptuar, interpretuar lajmin. Ka mungesë motivimi për studentët / të rinjtë të ndjekin karrierën në gazetari për shkak të kushteve të punës dhe trajtimit denigrues ndaj medias. Krahas përfitimeve që sjell teknologjia do të kemi gjithmonë nevojë për gazetarë profesionistë. Vetë-rregullimi dhe kodi etik si qasja që mund të ndiqet nga aktorë për të luftuar disinformimin dhe censurën. Duke e përmbyllur fjalën ajo theksoi nevojën që media vetë duhet të rrisë nivelin e besueshmërisë së saj tek qytetarët.

Xhensila Mirashi, gazetare dhe aktiviste rinore në Korçë gjithashtu nënvizoi rolin e edukimit sidomos tek fëmijët dhe të rinjtë dhe përfshirjen e edukimi mediatic si pjesë e kurrikulës në shkollë sidomos për të rinjtë.

Takimi virtual “Gratë në STEM”

| Jul 8, 2020 | [Blog-Debati](#), [Teuta Xhindi](#)

Faleminderit për ftesën për të marrë pjesë në këtë webinar që lidhet me gratë në STEM – karriera, sfidat dhe përfitimet.

Kam mbaruar FSHN, UT, dega Matematike dhe FE, USH, dega AB. Mgjs zgjedhja ime primare nuk ishte matematika, komisioni që merrej me administrimin e procesit, vendosi për të më dhënë të drejtën e studimit për matematike.

Nëse në atë kohë e mallkova komisionin për zgjedhjen, sot e falenderoj për zgjedhjen që bënë për mua.

Në atë kohë, në FSHN dominonin lektore burra, edhe në nivelin drejtues, të vetmet pedagoge gra ishin: Burbuqe Pepa dhe Pranvera Baholli, të cilat i kujtoj me shumë mirënjohje dhe respekt.

Kam pasur fatin që të edukohem nga profesorë shumë të nderuar, profesionistë të fushës, pasionantë lidhur me matematikën, serioze por njëkohësisht shume kërkues dhe me kujdes të madh ndaj detajeve.

Nuk toleronin mungesën e saktësisë, të shpjegimit të qartë të gjithë hapave në zgjidhjen e një problemi ose të shtjellimit të një teorie, thellësinë e analizës, përgjigjen e pyetjeve “Pse?” etj.

Mendoj se këto kërkesa më kanë pajisur me disa cilësi si qasja racionale, gjetja e zgjidhjeve, vullnetin, modestinë, të parit e problemit 360 gradë etj.

Gjate karrierës dhe jetës time, këto cilësi më kanë ndihmuar për të kaluar vështirësitë dhe pengesat dhe për mos u dorëzuar.

Me kalimin e viteve situata ka ndryshuar, është rritur numri i lektoreve gra mgjs në pozicione drejtuese vazhdojnë të dominojnë burrat.

Në botë rreth 25% e matematikaneve janë gra por gratë përbëjnë më pak se 10% të pozicioneve të lidershipit në matematikë.

Në Shqipëri, sipas UN women, më shumë se 71% e studentëve të diplomuar në fushën e shkencave natyrore dhe matematikës janë vajza ndërsa lidhur me lidershipin në matematikë nuk kemi të dhëna.

Sipas INSTAT, të dhënat lidhur me raportin Burra/Gra në lidership, në universitetet publike, për vitin 2018-2019, janë sipas tabelës më poshtë:

Pozicioni	Burra	Gra
Rektor	90.90%	9.10%

Zv/Rektor	63.60%	36.40%
Anëtarë Senati	64.70%	35.30%
Dekanë	71.70%	28.30%
Zv/Dekan	54.50%	45.50%
Përgjegjës Departamenti	51.30%	48.70%

Ndërsa, lidhur me raportin Burra/Gra sipas titujve dhe gradave në universitetet publike, për vitin 2018-2019, po sipas INSTAT, kemi të dhënat si më poshtë:

Titulli/Grada	Burra	Gra
Profesorë	59.30%	40.70%
Doktorë/PhD	40.20%	59.80%
Docentë dhe Pedagogë pa tituj	39.50%	60.50%

Prej gati 5 vitesh, jam drejtuese e departamentit të informatikës (që përfshin matematikën dhe statistikën), së fundmi në UMSH dhe konstatoj me kënaqësi se pjesa më e madhe e pedagogeve janë vajza që punojnë me përkushtim dhe pasion në fushën e shkencës.

Organizimi i aktiviteteve të tilla, promovimi i punës së grave dhe vajzave është një motivim dhe mbështetje për shumë të reja që të ndjekin rrugën e shkencës qoftë matematikë, fizikë, inxhinieri apo diçka tjetër.

Nga eksperiencia personale po edhe më gjërë, kam konstatuar se që individët të arrijnë rezultate maksimale, dy elemente janë thelbësore: besimi dhe mbështetja e tyre.

Këshilla ime për të rinjtë, në veçanti për vajzat, është që një botë konkurente, përballë sfidave dhe pengesave, gjithmonë të mendojnë se cili është hapi tjetër, pa u dorëzuar. Gjithashtu, mos të bien në kurthin e rutinës dhe përditshmërisë por të gjejnë kohë për realizimin individual.

Inkurajoj fort vajzat që e kanë pasion matematikën, të vijojnë ta studiojnë atë edhe pse mund t'i duket rruga e vështirë, në long term do kenë përfitime si në aspektin profesional ashtu edhe në formimin individual. Përveç kësaj, shoqërisë sonë i duhen mësuese shumë të mira të matematikës që të vijojnë punën për edukimin e brezave të ardhshëm.

Gjithashtu, për vajzat të cilat kanë zgjedhur të studiojnë në fusha që kërkon një përgatitje të mirë matematike si: data science, matematikë financiare, inxhinieri, quantitative finance, t'i kushtohen matematikës sepse do ti ndihmojë që të jenë profesioniste shumë të mira.

Gjej rastin që të bëj një apel për gjithë organet përgjegjëse, MASR, shoqata të ndryshme, në drejtim të ndjekjes së politikave stimuluese të grave në shkencë, sidomos në disa degë të reja por me shumë perspektive si Inteligenca Artificiale, IoT, Machine Learning, Robotika etj.

Tregu i punës po ndryshon me shumë shpejtësi dhe teknologjitë e avancuara dixhitale janë domosdoshmëri për të përballuar sfidat e të ardhmes. Punët që nuk ekzistojnë sot do të jenë të zakonshme brenda 20 viteve të ardhshme.

Mësimet e nxjerra nga debatet universitare dhe disa rekomandime nga studentët

| Jul 26, 2020 | [Blog-Debati SCiDEV](#)

Projekti “Laboratori i debatit mbi integrimin europian në auditorët universitare”, u zbatua nga Qendra Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim (SCiDEV) me mbështetjen e Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (OSFA), arriti që të përforcojë tek studentët:

- mendimin kritik, kjo vihet re edhe në analizat dhe shkrimet e tyre për rubrikën Blog si edhe në nivelin e argumentave që paraqitën në debat;
- tolerancën për mendimin ndryshe që vihej re përgjatë të gjithë debateve;
- përmirësim të etikës së komunikimit dhe elementëve të lidhur me të;
- aftësitë kërkuese që vihet re në shqyrtimin e burimeve dhe raporteve të reja lidhur me COVID19 dhe BE-në.

Projekti tregoi mbi të gjitha është dëshmi e aftësisë së studentëve për tu përshtatur dhe ecur përpara (resilience), për tu treguar solidarë dhe për të mbështetur njëri tjetrin si edhe për të dhënë mesazhe ndërgjegjësuse për të tjetrët duke paraqitur edhe ide dhe zgjidhje inovative.

Debatet treguan që studentët dëshirojnë të angazhohen, të dëgjohen e të jenë pjesëmarrës, por kanë nevojë për mbështetje për akses, burime dhe zhvillim aftësie. Është me rëndësi zhvillimi i mëtejshëm i mendimit kritik, aftësi kërkuese dhe analizuese si edhe përforsimi i etikës së komunikimit dhe tolerimit për mendimin ndryshe. Për ecurinë e demokracisë në vend, nevojiten të rinj të mirë-informuar dhe të angazhuar, ky projekti dha një kontribut, por ka edhe shumë nevoja në këtë drejtim.

Përvoja e SCiDEV me organizimin e debateve online rezultoi pozitive në disa aspekte të rëndësishme:

- fleksibiliteti i mjedisit virtual që studentët të bashkoheshin në debat pavarësisht vendndodhjes së tyre fizike;
- mundësia për të tjerë të interesuar të bëheshin pjesë lehtësisht e debatit;
- angazhim i studentëve në kërkimin e mëtejshëm të temave të debatit me fokus ndikimin nga COVID19 apo implikimet nga situata e re e krijuar në Shqipëri dhe në botë;
- studentët mësuan forma të reja të komunikimit dhe ndërlidhjes si edhe përdorimin e platformave të ndryshme që mundësojnë këtë online;
- studentët dhe pedagogët bashkëpunuan më shumë me njëri tjetrin në një format të ri dhe pedagogët ofruan mbështetje psiko-sociale për studentët që mentoronin.

Megjithatë, debatet online kanë disa mangësi krahasuar me debatet fizike në formatin e parashikuar fillimisht nga projekti:

- kërkohet që studentët të kenë akses në Internet dhe të jenë të pajisur me pajisjet e nevojshme elektronike dhe kjo nuk është gjithmonë e mundur duke rrezikuar përjashtimin e atyre që janë më pak të avantazhuar si në aftësi edhe në akses dhe burime;
- pasiguria e lidhur me situatën e COVID19 rëndoi gjendjen psikologjike të tyre dhe uli interesin për angazhim e tyre;
- shpirti i skuadrës dhe bashkëpunimi shpesh dobësohej përshkak të mungesës së ndërveprimit konkret;
- në kushtet kur studentët duhet të ndiqnin leksione online, të përgatiteshin për provime apo tema diplome / detyra kursi, u kërkohet edhe përgatitja për debatet online me format të ndryshuar.

Edhe përmes formatit online, projekti arriti që të përforcojë tek studentët:

- mendimin kritik, kjo vihet re edhe në analizat dhe shkrimet e tyre për rubrikën Blog si edhe në nivelin e argumentave që paraqitën në debat;
- tolerancën për mendimin ndryshe që vihej re përgjatë të gjithë debateve;
- përmirësim të etikës së komunikimit dhe elementëve të lidhur me të;
- aftësitë kërkuese që vihet re në shqyrtimin e burimeve dhe raporteve të reja lidhur me COVID19 dhe BE-në.

Bazuar në këtë përvojë, rekomandohet për SCiDEV:

- të vazhdojë të mbështesë të rinjtë, studentët si edhe të tjerë grupe rinore me zhvillim aftësish, rritje të kompetencave, ndërgjegjësim dhe përforcim të njohurive të tyre në çështje me rëndësi për zhvillimin social, ekonomik, politik dhe kulturor të vendit;
- të vazhdojë traditën e debatit universitar si një instrument për të nxitur mendimin kritik tek studentët, etikën në komunikim dhe tolerancën për mendimin ndryshe duke zgjeruar rrjetin e universiteteve partnere;
- të sigurohet që aktivitetet të jenë sa më gjithëpërfshirëse duke u kujtësuar për grupet rinore apo të rinjtë më pak të avantazhuar dhe duke lehtësuar hendekun digjital mes atyre që kanë akses, burime, aftësi dhe atyre që nuk i kanë;
- të promovojë modelet positive të të rinjve përmes mbështetjes së tyre, promovimit në universitetet dhe organizatat partnere, në rrjetet sociale, media dhe forma të tjera komunikimi;
- të nxisë të rinjtë që të jenë aktiv duke e zgjeruar rubrikën Blog dhe duke i dhënë zë studentëve dhe duke i pajisur me aftësi për të qenë qytetar aktiv dhe të angazhuar;
- të analizojë impaktin e COVID19 tek edukimi, mobiliteti dhe angazhimi i të rinjve;
- të dizenojë projekte së bashku me të rinjtë;

- të zgjerojë bashkëpunimin me partnerë të tjerë në shoqërinë civile, sektorin publik, media dhe atë privat për të fuqizuar të rinjtë dhe promovuar ata.

Rekomandime për politikëbërësit:

- të realizojnë bashkë-dizenjim të politikave me të rinjtë;
- të vazhdojnë dhe përforcojnë dialogun e strukturuar me të rinjtë sidomos për integrimin europian;
- të zbusin hendekun e botës digjitale mes të rinjve në situata të ndryshme social-ekonomike;
- të krijojnë hapësira pjesëmarrjeje dhe angazhimi për të rinjtë;
- të mbështesin iniciativat dhe nxisin punësimin dhe sipërmarrjen e të rinjve.

[Aksesoj raportin e plotë.](#)